

Dr. Dorian Koçi
Prof.As.Dr. Marenglen Kasmi

Historia e sindikalizmit shqiptar 1905 - 1961



Historia e Sindikalizmit Shqiptar 1905-1961



Dr. Dorian Koçi
Prof.As.Dr. Marenglen Kasmi



BOTIMET TURDIU

Publikimet e fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratimin me shkrim të FES.

Opinionet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të fondacionit Friedrich Ebert ose organizatave për të cilat autorët punojnë.

Titulli:

Historia e Sindikalizimit Shqiptar 1905-1961

Autor:

Dr. Dorian Koçi

Prof. As. Dr. Marenglen Kasmi

ISBN: 978-9928-4691-6-8

Shtypur: **Botimet Turdiu**

Përmbajtja:

Parathënie.....	5
Hyrje.....	7
Piketa të rëndësishme të sindikalizmit shqiptar.....	29
Shoqëria e rrobaqepësve të Korçës.....	48
Shoqëria “Puna” e Korçës (1933–1937).....	51
Shoqëria “Puna” e naftëtarëve (1935–1936).....	53
Sindikalizmi shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore.....	57
Krijimi i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë.....	68
Mbledhja e parë themeluese e Sindikatës.....	69
Kongresi themelues i Bashkimit të Sindikatave të Shqipërisë.....	72
Bashkimi i Sindikatave në vitet 1945-1946.....	73
Bashkimi i Sindikatave si përfaqësuese e Shqipërisë në tribunat ndërkombëtare.....	74
Përfundime.....	102
Portrete sindikalistësh shqiptarë.....	111
Bibliografia.....	132

Parathënie

Sindikatat duhet të kenë një rol themelor në shoqëri dhe ato kanë vepruar në këtë mënyrë për një kohë të gjatë në shumë vende evropiane. Ato organizojnë punëtorët për të mbrojtur interesat dhe për të përmirësuar kushtet e punës së tyre. Në ditët e sotme, kjo bëhet veçanërisht përmes marrëveshjeve kolektive. Megjithatë, sindikatat luajnë, gjithashtu, një rol shoqëror përtej vendit të tyre të punës ose koalicioneve sektoriale, duke kontribuar në ndryshimet politike, përparimin, si dhe në një demokratizim të ekonomisë dhe shoqërisë. Duke bërë këtë, lëvizja evropiane e punës ka një histori të gjatë dhe plot ngjarje ndaj edhe të drejtat e sotme të punës dhe standardet e punësimit janë rezultat i një lufte intensive të kësaj lëvizjeje, fillimet e së cilës datojnë në shekullin XIX.

Po sindikalizmi në Shqipëri? Që kur ekziston dhe çfarë rolesh ka luajtur në vend?

Për historinë e sindikalizmit shqiptar deri tani janë bërë pak kërkime. Ky studim është i pari e për rrjedhojë themelor e gjithëpërfshirës për të eksploruar këtë histori përgjatë periudhës 1905-1961; një periudhë e mbushur me orientime dhe role të ndryshme shoqërore të sindikatave dhe organizatave të punëtorëve shqiptarë. Ky studim na ndihmon të kuptojmë jo vetëm historinë e sindikalizmit në veçanti, por edhe të Shqipërisë në përgjithësi dhe pse forcat demokratike dhe emancipuese në shekullin e kaluar nuk mbizotëruan për një periudhë kaq të gjatë. Studimi gjurmon zhvillimet e lëvizjes punëtore që nga organizata e parë e punëtorëve, e cila edhe pse jo aq e vjetër sa ato në disa vende të tjera evropiane, është krijuar që në fillim të shekullit XX. Ai tregon se si këto suksese të para nuk mund të sillnin një lëvizje më të fortë, edhe pse aktorët dhe idetë përkatëse ekzistonin edhe në Shqipëri, ashtu si në të gjithë kontinentin. Ajo që pasoi më në fund ishte kooptimi i plotë i sindikatave nga regjimi stalinist duke formuar një sindikatë të unifikuar, të instrumentalizuar nga shteti represiv, megjithëse kjo nuk ndodhi pa pasur mosmarrëveshje. Duke qenë se një lëvizje e mirëfilltë punëtore është domosdoshmërisht demokratike dhe emancipuese, ky shfrytëzim nga ana e regjimit asgjësoi idenë dhe funksionin e saj bazë.

Shpresojmë që ky studim të jetë pikënisja për shumë diskutime dhe kërkime të mëtejshme mbi historinë e Shqipërisë në shekullin XX. Megjithatë, historia duhet të shërbejë si udhërrëfyes edhe për ne sot. Duke kuptuar kontekstet historike, si rrodhën zhvillimet dhe çfarë kontribuoi në suksesin dhe dështimet, ne mund të nxjerrim përfundime për të tashmen. Jo vetëm për rëndësinë e sindikatave dhe të drejtave të punës, por më gjerë: për rëndësinë e qytetarisë aktive dhe demokratike, të vetëorganizimit dhe pavarësisë së organizatave shoqërore. Ai mund të kontribuojë në debatin tonë për marrëdhëniet midis ekonomisë dhe demokracisë, si dhe midis shtetit dhe shoqërisë. Një përfundim i parë, që do të doja ta ndaja me ju në fillim të këtij libri, është i qartë për ne: Edhe sot, kemi nevojë për sindikata më të forta dhe të vërteta.

Dëshiroj të përgëzoj Dorian Koçin dhe Marenglen Kasmin për punën e tyre të jashtëzakonshme, bazuar në një studim gjithëpërfshirës të dokumenteve origjinalë, që ndodhen në Arkivin e Shtetit, si dhe në raporte e dokumente të tjera. Falë këtyre autorëve të shkëlqyer, ne tani mund të paraqesim këtë studim të parë mbi historinë e lëvizjes punëtore shqiptare dhe presim me padurim të gjitha diskutimet e ardhshme.

Në solidaritet,

Stine Klapper

Përfaqësuese rezidente e FES-it Tiranë

Hyrje

Shekulli XVIII dhe fillimi i shekullit të XIX ishin shekujt kur Europa, nën ndikimin e iluminizmit dhe romantizmit, filloi procesin e rivlerësimit të së kaluarës antike dhe mesjetare të kontinentit, si dhe epoka kur do të fillonte të ngjizej ideja për të krijuar shtetet kombëtare. Kësisoj është e rëndësishme të bëjmë një vlerësim të disa zhvillimeve të përgjithshme, ku përfshihet jo vetëm Ballkani, por edhe pjesa tjetër e Europës, të cilat do të ushtronin një ndikim të rëndësishëm mbi veprimtaritë revolucionare: së pari, formulimi dhe pranimi në shkallë të gjerë i ideologjive liberale dhe kombëtare; së dyti, kushtet ekonomike në ndryshim dhe së treti, shkallëzimi i ndërhyrjes së fuqive europiane dhe zanafilla e çështjes lindore.¹ Intelektualët dhe udhëheqësit kombëtarë ballkanikë dhe të Europës Lindore të shekullit të XIX do të ndikoheshin nga dy doktrina politike me prejardhje europiano-perëndimore: liberalizmi, që buronte nga idetë e iluminizmit në shekullin e XVIII, si dhe nacionalizmi. Lëvizja Kombëtare Shqiptare gjatë viteve 1830-1912 njihet si Rilindja Kombëtare Shqiptare. Ajo ishte një lëvizje e gjerë politike-kulturore, që synonte :

-në fushën politike - të çlironte atdheun nga robëria e huaj shekullore dhe të formonte shtetin kombëtar shqiptar, të shtrirë në mbarë trojet shqiptare;

në fushën shoqërore - të çlironte vendin nga marrëdhëniet e vjetruara feudale dhe ta shkëpuste nga prapambetja politike, ekonomike dhe shoqërore, duke vendosur rendin demokratik përparimtar, nën shembullin e vendeve të qytetëruara të kohës;

në fushën kulturore - të çlironte masat nga prapambetja mendore dhe të shpejtonte zhvillimin e tyre arsimor, kulturor dhe shkencor me bazë gjuhën shqipe. Si e tillë ajo do të ishte një lëvizje revolucionare kombëtare me karakter çlirimtar, demokratik dhe iluminist.² Pikërisht në një nga synimet e Rilindjes Kombëtare nënkuptohej edhe ndryshimi i vullshëm ekonomik që paraprinte

1. Barbara Jelavich, Historia e Ballkanit, Përpjekja, Tiranë, 1999, fq. 167.

2. Kristo Frashëri, Historia e qytetërimit shqiptar, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2008, fq. 184.

vendosjen e marrëdhënieve kapitaliste në prodhim dhe në shoqëri. Në këtë kontekst historik prioritet për t'u zhvilluar këto marrëdhënie të reja në prodhim, por edhe dukuritë sociale rreth tyre apo dhe fillimi i lëvizjes sindikaliste, kishin qendrat urbane në Shqipëri. Një koncept i ri ishin, natyrisht, idetë socialiste, të së majtës nën idetë e nacionalizmit, të cilat në Ballkan nuk erdhën si rezultat i industrializimit por si rezultat i moszhvillimit ose i modernizimit të pabarabartë midis Ballkanit dhe krahinave të tjera të Perandorisë. Modernizimi i pabarabartë midis këtyre pjesëve të Perandorisë ishte rezultat i prapambetjes ekonomike të Perandorisë Otomane dhe afërsisë së Ballkanit me Perëndimin. Idetë nacionaliste penetruan në fillim tek ato zona dhe grupe, të cilat kishin kontakt të ngushtë me Europën Perëndimore ose Qendrore. Një, nga ideologët e hershëm të nacionalizmit shqiptar, Sami Frashëri, ishte nga të parët që diskutoi në botën intelektuale shqiptare socializmin dhe idetë rreth tij. Në një shkrim të tij të botuar në ditët e themelimit të Lidhjes së Prizrenit (1878) me titull “Socializmi dhe prona e përbashkët”, rezulton se ai kishte një konsideratë të madhe për idetë socialiste, veçse jo për socializmin marksist, por për socializmin demokrat, ose siç quhet sot për socialdemokracinë. Veç kësaj, ai pati një perceptim aq të fuqishëm mbi forcën e ideve socialiste sa parashikoi, që në 1878, atë që ndodhi me të vërtetë më vonë, se një ditë ato do të trondisnin botën.³ Socializmi – shkruante, Sami Frashëri, është një lëvizje e madhe mendore e qytetërimit, e cila do të trondisë Europën, ndoshta një ditë krejt rruzullin tokësor dhe do të ndryshojë fytyrën e shoqërisë njerëzore. Socializmi është një rrugë e madhe që e çon njerëzimin në stacionin e begatisë dhe të lumturisë. Por ky stacion nuk arrihet duke shpallur pronën e përbashkët të pasurisë, domethënë të mjeteve të prodhimit, sepse prona e përbashkët është në kundërshtim me çdo fe dhe për çdo popull, madje ai i tejkalon caqet e atij ligji të shenjtë dhe të paprekshëm që quhet moral.⁴ Parimet e socializmit

3. Kristo Frashëri, Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH-së 1878 – 1941 (vështrim historik me një shtojcë dokumentare), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Ilar, Tiranë 2006, fq. 10-11.

4. Sami Frashëri, Tercuman-i Shark, Istanbul 10 qershor 1294-kalendari osman sipas hixhrit (22 qershor 1878), cituar sipas Kristo Frashëri, Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH-së 1878 – 1941 (vështrim historik me një shtojcë dokumentare), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Ilar, Tiranë 2006, fq. 10-11.

demokratik, ashtu si i ka kuptuar Sami Frashëri, duket se nuk kanë qenë të huaja për një pjesë të elitës nacionaliste shqiptare përderisa së bashku me programin e Lidhjes së Prizrenit kërkoheshin edhe e drejta e votës për të gjithë qytetarët, vendosja e ligjeve nga populli sovran, etj. Ndikimi i mendimit evolucionist të Sami Frashërit mbizotëroi për një periudhë të gjatë kohore në mendimin shqiptar aq sa Musine Kokalari në kujtimet e saj “Si lindi Partia Social-Demokrate”(1972) shkruan :“jam rritur me gjithçka që po rritej, zhvillohej, kërkohesh, ishte mbështetur në botëkuptimin e thellë iluminist dhe në reformizmin e parlamentarizmin që na e ushqeun Sami Frashëri që në bangat e shkollës”.⁵ Përhapja e ideve socialiste në Shqipëri duket se ka ndodhur në rrethe të ngushta në fillim të shekullit të XX. Gazeta “Shpresa e Shqypnisë” që dilte në Raguzë flet për përkthimin shqip të librit të Maxinit⁶ “Detyrat e Njeriut”. Ajo i drejtohej rinisë për të formuar shoqëri të fshehta, sipas ideve të Maxinit, duke i rekomanduar që mbledhjet t’i bënin në pyll ose pranë vatrave në dimër, etj. Vetë drejtori i gazetës Nikollë Ivanaj⁷ bënte pjesë në një organizatë maxiniane në Itali.⁸ Gjenezja e parë

5. Musine Kokalari, Si lindi Partia Social-Demokrate (1972), Vepra II, përgatitur nga N. XH. Shehu, Tiranë: Geer, 2009, fq. 403.

6. Giuseppe Mazzini (22 qershor 1805 - 10 mars 1872) gazetar dhe aktivist për bashkimin e Italisë dhe kryetar i lëvizjes revolucionare italiane. Përpjekjet e tij ndihmuan në krijimin e Italisë së pavarur dhe të bashkuar në vend të disa shteteve të veçanta, shumë të dominuara nga fuqitë e huaja, që ekzistonin deri në shekullin e 19-të. Një nacionalist italian në traditën radikale historike dhe një ihtar i republikanizmit social-demokrat, Mazzini ndihmoi në përcaktimin e lëvizjes moderne Europiane për demokracinë popullore në një shtet republikan.

7. Nikollë Ivanaj i njohur edhe si Nikollë bej Ivanaj (1879 - 1951) ka qenë një gazetar, botues dhe shkrimtar shqiptar. Konsiderohej një nga “personalitetet më të dalluara i nacionalizmit shqiptar më të ndërgjegjshëm” dhe u përfshi në stafin e kryengritësve shqiptarë gjatë 1911. Në vitet 1905-08 ai botoi gazetën “Shpnesa e Shqypnisë” në Dubrovnik, Trieste dhe Romë, duke marrë ndihmë financiare nga anë të ndryshme. Për veprimtarinë e tij si botues Ivanaj arriti të fitonte mbështetjen financiare të Albert Ghicës, një anëtar i familjes fisnike Ghica që mëtonte fronin shqiptar. Ai ishte një nga liderët e Komitetit Kombëtar që u themelua në Podgoricë, në fillim të 1911 dhe ka marrë pjesë në organizimin e kryengritjes shqiptare. Fjalimi e tij mbajtur për Shoqërinë Italiane të Shtypit më 26 janar, 1911 çmohet nga disa burime si “një dokument historik me rëndësi jetike”. Ivanaj ishte edhe një nga pjesëmarrësit e Kongresit të Trieshtës të mbajtur në 1913, po atë vit ktheu në Shkodër, ku mori pjesë në klubin Lidhja Kombëtare të formuar rishtazi. Në janar të vitit 1919, filloi botimin e një tjetër gazete Koha e Re në Shkodër. Gjatë Konferencës së Paqes më 1919, përfaqësoi Partinë Politike nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në vitin 1923 së bashku me kushërinë e tij Mirash Ivanaj, botoi gazetën Bashkimi në Shqipëri, dhe të përjavshmen Republika nga 1923 deri më 1925, po në Shkodër. Gjendej në Paris me mërgimtarët antizogistë kohën kur shkoi Mbreti Zog dhe iu thur atentati dhe pas dësimit të mërgimtarëve shqiptarë në sajë të atentatit, shkoi në Paris po me antizogistët prillin e atij viti. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Ivanaj botoi një libër autobiografik “Historia e Shqipënisë së re”. “Vuejtjet e veprimet e mija” në dy pjesë, në vitin 1943 dhe 1945 përkatësisht, ku përqendrohet në rolin e klerit katolik. Pas marrjes së pushtetit nga Fronti Nacional-Çlirimtar, u mor me përkthime dokumentesh nga sllavishtja në shërbim të Institutit të Historisë. Gjithashtu la një vëllim me poezi para se të vdiste më 1951 në Tiranë.

8. Gazeta “Shpresa e Shqypnisë”, nr 41, nëntor 1905; Kristaq Misha. Lëvizja punëtore në Shqipëri. Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1971, f. 37.

e lëvizjes sindikaliste në Shqipëri filloi në qytetin e Shkodrës në vitin 1902. Shfaqja e ekonomisë kapitaliste në Shqipëri ndodhi relativisht vonë, krahasuar me vendet e Europës Perëndimore apo edhe me vendet fqinje të Ballkanit. Dominimi i zgjatur i strukturave feudale dhe esnafi deri në mesin e shekullit të XIX lidhet me faktin se vendi ynë ishte pjesë e Perandorisë Osmane, e cila duke filluar nga shekulli i XVII ishte në dekadencë të plotë. Shkodra në atë kohë ishte qendra më e madhe ekonomike e vendit. Atje në qytet kishte disa mullinj të vegjël bluarjeje dhe një në fshat të cilët punonin me motora me vajguri, një fabrikë sapuni e duhani, fabrikë makaronash, një shtypshkronjë, një fabrikë tekstili dhe një fabrikë brezash. Një kantier i vogël ndërtonte barka. Më 1911 ky kantier eksportoi 18 barka për në Mal të Zi.⁹ Ky zhvillim ekonomik kishte bërë të mundur formimin e bërthamës së parë të klasës punëtore në Shqipëri, si dhe format e para modeste të organizimit të saj. Në vitin 1902 me nismën e Shtjefën Ingridit, u formua një shoqëri ndihmëtare, e cila për shkak të vështirësive që hasi u shpërnda pa filluar nga aktiviteti.¹⁰ Gjithsesi përpjekjet për t'u organizuar nuk rreshtën. Në mars të vitit 1905, me nismën e Kol Dikës, një ambulant i njohur edhe si studiues i letërsisë perëndimore, në Shkodër u krijua një grup i vogël ilegal, ku përfshiheshin zejtarë e punëtorë, si dhe intelektualë (mjekë e farmacistë). Me nismën e tyre u krijua një Kompani e Ndihmës së Ndërsjellë. Po atë vit 1905, në Shkodër shpërtheu greva e këpucarëve. Për të kapërcyer vështirësitë e tyre, që vinin nga konkurrenca e produkteve të huaja dhe nga kriza ekonomike, zejtarët ulën pagat dhe shtuan orarin e punës, duke i detyruar punëtorët të punonin edhe natën me qirinj. Kompania e Ndihmës së Ndërsjellë për këtë arsye formoi një komision që paraqiti kërkesën për rritjen e pagave dhe uljen e orarit të punës.¹¹ Ky organizim i parë reflekton nga pikëpamja teorike e historisë së sindikalizmit në Shqipëri, krijimin dhe organizimin e shoqatave të para, ashtu si kishte ndodhur më herët në Europë, të cilat u krijuan për të mbrojtur zhvillimin që filluan të merrnin disa

9. Kristaq Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1971, f. 12.

10. Kristaq Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1971, f. 34.

11. Anelmo Spahija, "Në fillimet e lëvizjes sindikaliste shqiptare", Teza 11, 3 shtator 2016, vizituar site-in në 25 maj 2022. <https://teza11.org/ne-fillimet-e-levizjes-sindikaliste-shqiptare/>.

profesione të veçanta. Edhe pse nuk mund të thuhet se marrëdhënia midis këtyre organizimeve dhe sindikatave është lineare, këto shoqata mund të konsiderohen si paraardhëse të sindikatave. Kjo për faktin se, ato kanë qenë organizimet e para të punëtorëve të bazuara në rregullat e tyre dhe jo të punëdhënësve. Këta punëtorë kishin nevojë të përfaqësoheshin, sepse shumë njerëz e lanë bujqësinë si një angazhim pune i përhapur në atë kohë, dhe filluan të punësoheshin te persona të tjerë (punëdhënës). Shpeshherë ata punonin në kushte të vështira dhe me pagesa shumë të ulta. Punohej 12-14 orë në ditë për një pagë mesatare prej 5-6 grosh në ditë. Mund të përmendim rastin e grave përpunuese të mëndafshit në Shkodër, të cilat punonin 16 orë për 6 grosh në ditë. Madje, në dimër kur dita ishte e shkurtër detyroheshin që me shpenzimet e tyre të mbanin kandilin për të vazhduar punën. Në një gjendje të tillë ishin edhe punëtorët hamej, elhakçitë (vjen nga fjala hak-pagë) që punonin në punishte të ndryshme, larëset e leshit, etj. Një gjendje e tillë varfërimi gradual u shoqërua me reagimin që vinte nga njëra anë nga intelektualë të caktuar, dhe nga ana tjetër nga vetë vegjëlja, e përbërë nga këta artizanë dhe fshatarë të rrënuar që shkonin drejt varfërimit.¹²

Lëvizja e punëtorëve erdhi si rrjedhojë e pabarazisë së prodhuar nga pushteti i punëdhënësve dhe pamundësia për t'u mbrojtur nga arroganca e tyre. Nga materialet që kemi deri më sot del se dita e 1 majit është festuar për herë të parë më 1905 në Shkodër nga një grup punëtorësh të ngarkim-shkarkimit. E festuan për herë të parë ditën e 1 Majit, si ditë të punëtorisë, gjithashtu, dhe një grup zejtarësh, kallfësh, arsimtarësh të Shkodrës, që organizoi këtë ditë një piknik jashtë qytetit.¹³ Më 1 prill 1907 në Shkodër u krijua Shoqëria Ndihmëtare, që sipas një lajmërimi të publikuar në gazetën "Drita" kishte për qëllim të ndihmonte të varfërit dhe të sëmurët duke u dërguar mjekun dhe barnat pa të holla. Lajmërimi u bënte thirrje patriotëve të ndihmonin këtë

12. Anelmo Spahija, "Në fillimet e lëvizjes sindikaliste shqiptare", Teza 11, 3 shtator 2016, vizituar site-in në 25 Maj 2022. <https://teza11.org/ne-fillimet-e-levizjes-sindikaliste-shqiptare/>.

13. Kristaq Misha, Lëvizja punëtoare në Shqipëri, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1971, f. 42.



Presidencë
 Angelini Jule

Biblioteka e Shoqërisë
 Nr. 2399
 Shkoderi A-IV-1

Kryesia e Shoqërisë Punë e nntet 1924
 mbyllje vepa legjimit i shpirt

1. Lohë Dukagjini Presidencë
2. Gëll Camëllari propagandist
3. Jusufi bashkëpunues Propagandist
4. N. J. J. bashkëpunues Propagandist
5. Pashko Zoska bashkëpunues
6. I. Kadri bashkëpunues
7. Balta Gjergj bashkëpunues
8. Gëll Camëllari bashkëpunues
9. Sed Musliu bashkëpunues
10. Zef Jule bashkëpunues (Kryetar)
11. L. bashkëpunues bashkëpunues (Kryetar)
12. Hil bashkëpunues bashkëpunues
13. Val bashkëpunues bashkëpunues (Kryetar)
14. bashkëpunues bashkëpunues
15. bashkëpunues bashkëpunues

Anëtare të kryesisë së shoqërisë
 "Puna" në Shkodër

shoqëri.¹⁴ Organizator i saj ishte Shtjefën Ingridi. Një muaj më vonë pas themelimit të saj në Shkodër u festua dita e 1 Majit. Me shumë gjasa, idetë socialiste në Shqipëri depërtuan në fillim të shekullit XX, fillimisht në Shkodër, ku u organizua edhe greva e parë e punëtorëve. Fillimisht shekulli i XX karakterizohet nga një varfëri e tejskajshme në Shqipëri, ku përfshihej padyshim edhe qyteti i Shkodrës. Zejet filluan të falimentonin njëri pas tjetrit, punëtorët mbetën pa punë dhe pa asnjë mbështetje. Tokën e kishin çifligarët, pra elementët e pasuruar gjatë regjimit osman. Po ashtu, edhe tregtia ishte konsoliduar në duart e borgjezisë së re tregtare, si myslimane, ashtu edhe katolike. Pikërisht ky ishte shtrati, ku u shtri edhe organizimi i grevës së parë, e cila u organizua nga Kol Dika, Gjon Gajtani, Shtjefën Ingridi dhe Kel Lika, e cila u udhëhoq nga Loro Lleshi, Lush Tafroku, Gjon Gajtani, Salo Uruçi dhe Pjetër Dema.¹⁵ Festimi i 1 Majit në Shkodër u pasqyrua dhe në shtypin shqiptar të Rilindjes Kombëtare. Korrespondenti i gazetës “Shpresa e Shqypnisë”, shkrimet e të cilit botoheshin me pseudonimin “I mjeri” shkruante: Sot në të parën ditë të Majit, si asht zakoni në të gjithë botën punëtorija me shumë të tjerë dalin për më e përgzumun pranverën. Kështu pra u ba dhe këtu në Shkodër sivjet. U mblodhëm në nadje herët të gjithë së bashkut punëtorë, shegertë e të tjerë pa numër-e duellëm tue kënduemën valle (si zakoni që asht ndër ne) ndër qytet me do vegla muzikore shumë të bukura...¹⁶ Artikulli mbyllet me thirrjet “Rnoftë Shqypnia e lirueme”! “Rnoftë vllaznia e bashkënia”!, “Rnoftë e para ditë e 1 Majit”.¹⁷ Këto thirrje përfaqësonin edhe qëllimin e dyfishtë të këtyre shoqërive gjysmë të fshehta sindikaliste: qëllimin politik për të fituar pavarësinë e Shqipërisë dhe qëllimin shoqëror për të përmirësuar jetesën e klasës punëtore në Shkodër. Një nga dëshmitarët dhe pjesëmarrësit e këtij manifestimi, Abdulla Jashari shkruan: ... bukur mirë e kaluem ditën e 1 Majit në Shirokë. Të tanë shegertat kundraxhinj, zdrukthtarë, hamenj, akcinj, etj, të veshun me rrobe të reja, me do vegla muzikore, në mbramje pasi u kthyem andej hymë në qytet ,

14. Gazeta “Drita”, Sofje, Nr 90, dt. 15.06.1907.

15. Nikollë Loka, Tuk Jakova – Jeta dhe vepra, Botime “Grand Prind”, Tiranë 2017, f. 34.

16. Gazeta “Shpresa e Shqypnisë”, Nr 9, dt. 22.5.1907.

17. Gazeta “Shpresa e Shqypnisë”, Nr 9, dt. 22.5.1907

ashtu të radhiturn tue këndu e brohoritë, për liri e përparim. Një puntuer na printe tue mbajtë në duer një pankartë të shkrueme me lule me fjalët “1 Maj”. Kaluem nga Pazari, nga rruga e Parrucës e gjer te Dugajat e reja.¹⁸Pas rithemelimit të shtetit kombëtar shqiptar në Kongresin e Lushnjës, anëtarësimit në Organizatën botërore të Punës filluan edhe organizimet sindikaliste në Shqipëri. Më 1920, me nismën e një grupi zejtarësh e punëtorësh, u formua në Shkodër “Shoqëria Ndihmëtare e Punëtorisë”. Në rregulloren e botuar shpallehin qëllimet e shoqërisë, ku përfshihej: shërbimi mjekësor falas për punëtorët, krijimi i një zyre pune, krijimi i një kase huaje për të ndihmuar punëtorët në vështirësi, etj. Shoqëria bëri një hap përparimtar me ngritjen e organizatave të veçanta sipas profesioneve. Të tilla ishin 17. Në krye të secilës organizatë profesionale caktohej nga një kujdestar. Nga përfaqësuesit e këtyre organizatave ngrihej këshilli i Shoqërisë Ndihmëtare të Punëtorisë. Shoqëria kishte një kryetar, një sekretar dhe një arkëtar. Në sajë të këtij organizimi dhe të veprimtarisë që zhvilloi, shoqëria arriti të përfshinte në radhët e saj deri në 800 anëtarë. Nën drejtimin e kësaj shoqërie u organizuan greva e demonstrata, ku mund të veçojmë demonstratën e 1 Majit 1922, në të cilën punëtorët të ndarë sipas profesioneve parakaluan nëpër rrugët e qytetit, si dhe u mbajtën fjalime.¹⁹

Vitet ‘20 janë dhe fillimet e demokracisë parlamentare në Shqiptare. Grupet politike dhe partitë që do të rreshtohen në parlament, shpeshherë do të kenë ngjyra lokaliste, krahinore por ndonjëherë do të ndikohen dhe nga shoqatat e grupimet që i kanë votuar. Organizimet e para sindikaliste do të fillojnë në qendrat urbane që kishin hyrë furishëm në zhvillimin kapitalist duke bërë të mundur që në mos të kishin një proletariat të organizuar në bërthamat e tyre sociale të kishin një stratum intelektual të së majtës që do të përpiqen të emancipojnë shoqërinë shqiptare. Kështu psh në Gjirokastër u themelua shoqëria “Drita” që ishte klub demokratik, arsimor, kulturor e politik. Përndryshe u quajt

18. Gazeta “Puna”, dt. 30.04.1957.

19. Anelmo Spahija, “Në fillimet e lëvizjes sindikaliste shqiptare”, Teza 11, 3 shtator 2016, vizituar site-in në 25 maj 2022. <https://teza11.org/ne-fillimet-e-levizjes-sindikaliste-shqiptare/>.

edhe klubi i “Opingarëve”, meqë kishte për simbol një palë opinga, që personifikonin njerëzit e thjeshtë. Organi i tyre ishte gazeta “Drita” që drejtohej nga intelektual i demokrat Veli Hashorva. Shoqëria “Drita” duket se ishte frymëzuar nga ide socialiste që kishin filluar dhe kishin zënë rrënjë në mjedisin shqiptar. Ka shumë të ngjarë që, ashtu si dhe studentë të tjerë në Stamboll, Veli Hashorva të lexonte idetë socialiste në gazetën Turk Huku (Drejtësia turke) që propagandonte ide socialiste. Për këtë arsye gazeta u kthye në zëdhënësen e zërit të esnafëve dhe çirakëve të qytetit duke arritur rezultate të mira gjatë fushatave të zgjedhjeve për organet e larta të pushtetit më 1921 dhe më 1923.²⁰ Në korrik 1921, me nismën e patriotit Avni Rustemi formohet në Gjirokastrë “Lidhja e mësuesve”, në programin e së cilës përfshihej mbrojtja e të drejtave të mësuesve. Përveç problemit të pagave të ulëta, shumë prej mësuesve nuk u paguhej rroga me rregull. Pikërisht një problem i tillë u trajtua në Kongresin e Arsimitarëve që u mbajt në Tiranë në gusht të vitit 1923. Në fillim të vitit 1924, në qytete të ndryshme si Shkodër, Korçë, Tiranë, Vlorë, etj, filluan të organizoheshin protesta e greva nga ana e arsimtarëve. Vlen të përmendet sidomos greva e mësuesve të Korçës, të cilët kërkonin dhënien e rrogave të prapambetura. Lëvizja mori shkallë të gjerë pasi me mësuesit e qytetit u bashkuan edhe ata të fshatit, gjë që çoi në mbylljen e pjesës më të madhe të shkollave në të gjithë rrethin. Gazeta “Shqiptari i Amerikës”, duke përshkruar situatën e krijuar, shkruante: “Populli shpirtërisht është i lidhur me mësonjësit. Ai tregon simpati të madhe për përçapjen e mësonjëseve të vendosur për një durim të gjatë e shembullor”. Prandaj, përpara një situatë të tillë, qeveria u detyrua të tërhiqej dhe të paguante rrogat e prapambetura.²¹

Një tjetër zhvillim erdhi nga Selenica po në të njëjtin vit, vend ku nxirrej bitum në Shqipëri. Në tetor 1923 punëtorët nisën një grevë të përgjithshme, e cila bashkoi njëri pas tjetrit punëtorët e

20. Dorian Koçi, Patrioti liberal Veli Hashorva dhe Gazeta “Drita” e Gjirokastrës 1920-1924, Gazeta “Dita”, viti 2020, f. 9.

21. Anelmo Spahija, “Në fillimet e lëvizjes sindikaliste shqiptare”, Teza 11, 3 shtator 2016, vizituar site-in në 25 Maj 2022. <https://teza11.org/ne-fillimet-e-levizjes-sindikaliste-shqiptare/>.

galerive, punonjësit e pastrimit të fabrikës së bitumit dhe transportit. Komisioni i punonjësve që u ngrit i paraqiti shoqërisë një peticion me shkrim, ku kërkohej rritja e pagave, pakësimi i orëve të punës, përmirësimi i kushteve të punës, sigurimi i punëtorëve që sëmureshin ose aksidentoheshin, si dhe largimi i disa kryepunëtorëve italianë e shqiptarë që silleshin keq me punëtorët. Fillimisht këto kërkesa nuk u pranuan nga shoqëria, e cila kërcënoi se do të punësonte punëtorë të tjerë. Me gjithë vështirësitë e krijuara, greva pati sukses për shkak se me punëtorët u bashkuan edhe banorët e fshatrave përreth. Pas një muaji shoqëria u detyrua të pranonte shtimin e pagave me 30-50%, pushimin nga puna dhe transferimin e disa inspektorëve dhe sigurimin e shërbimit mjekësor për punëtorët në rast nevojë.²²

Për shumë arsye të njohura tipi i kapitalizmit që ishte zhvilluar në Shqipëri kishte zhvilluar marrëdhënie të pabarabarta midis punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe si i tillë reflektonte pabarazi, shfrytëzim dhe mirëqenie të pakët për klasën punëtore. Për këtë arsye në gjirin e fuqisë punëtore nisi shumë herët aktiviteti sindikalist dhe fermentimi i ideve të së majtës që përkrahnin barazinë sociale dhe organizimin sindikalist. Sindikatat janë konsideruar ndër vite si një nga instrumentet më të njohur të punonjësve, të cilët kërkojnë të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre nga shfrytëzimi ekonomik dhe abuzimi i “dinjitetit të punës” nga ana e punëdhënësve. Pra, është një instrument thelbësor i punonjësve për të kërkuar marrëveshje dhe për të influencuar vendimmarrjen e punëdhënësve, që mund të jetë në kundërshtim me kërkesat e kontratave të punës.²³ Drejtësia sociale qëndron në thelb të lëvizjes sindikaliste. Si e tillë ajo është e lidhur shumë ngushtë me zhvillimet e së majtës dhe të tipareve të saj si rrymë politike. E majta vetëpërkrahëhet si progresiste dhe është në thelb internacionaliste. Eliminimi i barrierave sociale dhe ekonomike është një tjetër tipar identifikues i së majtës moderne dhe synimi është arritja e barazisë

22. Anelmo Spahija, “Në fillimet e lëvizjes sindikaliste shqiptare”, Teza 11, 3 shtator 2016, vizituar site-in në 25 Maj 2022. <https://teza11.org/ne-fillimet-e-levizjes-sindikaliste-shqiptare/>.

23. Klodian Gega, Studim – Perceptimi i publikut dhe i sindikalistëve mbi performancën e sindikatave në Shqipëri, Qendra për shërbime dhe Praktika Ligjore të Integruara – Fondacioni “Friedrich Ebert”, 2018, f. 12.

së të ardhurave ose, së paku, zvogëlimi i hendekut mes të pasurve dhe të varfërve në shoqëri.²⁴ Në Shqipëri për shkak të zhvillimeve të vrullshme për urbanizimin e shpejtë të shoqërisë shqiptare dhe shkëputjes nga prapambetja e së kaluarës, nuk është rastësi që konceptet e së majtës, qoftë asaj socialdemokrate, qoftë asaj komuniste, zunë vend që me krijimin e shtetit. Në fillim të viteve '20, në faqet e shtypit dhe në diskutimet në qarqet intelektuale qarkullonin mjaft nga parimet themelore të së majtës, të tilla si: barazia sociale, rishpërndarja e pasurisë kombëtare, veçanërisht rregullimi i pronësisë së tokës, etj. Me Lëvizjen e Qershorit 1924, konceptet e së majtës liberale u përmblohdën së bashku në një program qeverisës, i cili, duhet pranuar, kishte doza utopie dhe radikalizmi për gjendjen politike dhe shoqërore të Shqipërisë së asaj kohe.²⁵ Mes përplasjes ideologjike midis së majtës socialdemokrate dhe ideve komuniste, që po fitonin terren në Shqipëri pas dështimit të Lëvizjes së Qershorit në 1924, mbizotëruan këto të fundit. Përhapja e ideve komuniste dhe të së majtës favorizoheshin dhe nga fakti që kriza e madhe ekonomike 1929-1933 falimentoi shumë biznese të vogla dhe dyqanxhij të profesioneve të lira dhe rriti papunësinë. Si një vend i prapambetur bujqësor, Shqipëria varej nga tregu i jashtëm. Me fillimin e krizës ekonomike, shtetet me të cilat Shqipëria zhvillonte tregti si Italia, Greqia, Turqia, SHBA, etj, ndoqën politika proteksioniste që ndikuan në rënien drastike të eksporteve shqiptare. Pakësimi i eksporteve krijoi një kontigjent prodhimesh të tepërta, gjë që çoi në rënien e çmimeve. Kjo krijoi vështirësi për prodhuesit vendas, që nga industrialistët e paktë e deri te prodhuesit e vegjël të fshatit dhe qytetit, dhe shumë prej tyre shkuan drejt rrënimit. Rënia e çmimeve dhe pakësimi i fuqisë blerëse çoi në falimentimin e tyre dhe u shoqërua me rritjen e papunësisë, përhapjen në mënyrë masive të varfërisë, etj. Këtë situatë të vështirë e vuajtën kryesisht prodhuesit e vegjël të fshatit për shkak se prodhimet e tyre blegtorale, që përbënin 60-70% të eksportimeve të Shqipërisë, duke mos gjetur tregje shitjeje

24. Ilir Kalemaj, Hyrje në "E majta – Mendimi politik/ profile biografike", Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë 2020, f.10.

25. Ilir Kalemaj, Hyrje në "E majta – Mendimi politik/ profile biografike", Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë 2020, f.11.

jashtë vendit, pësuan një ulje të ndjeshme të çmimeve. Gjithashtu, shumica dërrmuese e zejtarëve u rrënuan ekonomikisht, ndërkohë që shumë fabrika si SCALA, dega e STAMLES në Shkodër, etj, e ndërprejnë prodhimin, gjë që çoi në rrënimin e disa degëve të industrisë si e çimentos, duhanit, alkoolit, blojës, etj. Rritja e papunësisë në vendet e zhvilluara kapitaliste ndikoi në pakësimin e të ardhurave të siguruara nga dërgesat në të holla të emigrantëve. Edhe kreditë e SVEA-s pësuan rënie.²⁶ Kjo gjendje e rënduar e shtresave punonjëse reflektohej edhe në shtypin e kohës. Gazeta “Ora” evidentonte faktin që nuk kishte asnjë rregullore që të përcaktonte marrëdhëniet mes pronarit dhe punëtorit: “Nuk ka kontrato të shkruar, nuk ka kontrato kolektive, nuk ka ligje, nuk ka rregullore...”. Ndërkohë, te “Shqipëria e Re”, në një artikull të janarit 1930 vihej në dukje se në fabrikën Stamles punonin edhe të mitur: “Këtu më hoqi vëmendjen një tok 7-8 çupash prej 6 deri 8 vjeç, të cilat shumë të bindura, me doçkat e tyre të vogla, po thyenin anët e kutive të cigareve me një shpejtësi të madhe. Të thyhet zemra duke parë këto foshnja të marrin përsipër që sot gajlen e ekzistencës dhe të jetës...”. Në një gjendje të tillë të rritjes së papunësisë, të rënies së fuqisë blerëse dhe të varfërimit të përgjithshëm rifillon organizimi nga ana e punëtorëve dhe krijimi i shoqërive me karakter profesional.²⁷

Ky është momenti kur lëvizja komuniste ndikoi edhe në organizimin e lëvizjes sindikaliste në qendrat urbane, ku gjithsesi mbijetonin ende strukturat esnafore. Kështu në janar 1934 në Korçë u themelua “Shoqëria e Rrobaqepësve të Korçës”, që ishte nën ndikimin organizativ të Grupit Komunist të Korçës. Programi i saj përfshinte: punën për grumbullimin e të gjithë rrobaqepësve dhe punëtorëve të tekstitit në organizatë, ndihmën morale dhe materiale për të gjithë anëtarët, për të luftuar në fazën e parë që të mos ulen rrogat dhe të mos pushohen nga puna punëtorët dhe më shumë pasi të bëhen kërkesa për rritje rrogash, gjetje pune për të papunët, ulje të orarit të punës, etj. Shoqëria zhvilloi një aktivitet

26. Anelmo Spahija, “Në fillimet e lëvizjes sindikaliste shqiptare”, Teza 11, 3 shtator 2016, vizituar site-in në 25 Maj 2022. <https://teza11.org/ne-fillimet-e-levizjes-sindikaliste-shqiptare/>.

27. Anelmo Spahija, “Në fillimet e lëvizjes sindikaliste shqiptare”, Teza 11, 3 shtator 2016, vizituar site-in në 25 Maj 2022. <https://teza11.org/ne-fillimet-e-levizjes-sindikaliste-shqiptare/>.

intensiv në luftën kundër abuzimit me të miturit në punë dhe arriti marrëveshje me punëdhënësit për vendosjen e një kufiri moshe. Shoqëria, gjithashtu, pengoi përpjekjet e disa pronarëve për të rritur orarin e punës, por ajo nuk kishte një organizim të mirëfilltë sindikalist, sepse nuk kishte një anëtarësi të plotë të klasës punëtore në Korçë dhe kësaj nuk mund të organizonte greva për të arritur synimet e saj. Në një farë mënyre organizimi i shoqërisë reflektonte organizimet para sindikaliste, ku mbizotëronin kompromiset dhe marrëveshjet e drejtpërdrejta duke munguar fermentimi i nevojshëm ideologjik për t'u shtrirë si lëvizje në të gjithë vendin. Sindikalizmi i përshtatet më shumë karakterit të lëvizjeve punëtore reformuese. Pavarësisht se e konsideron kapitalizmin si sistem ekonomik, ku të drejtat dhe interesat e punëtorëve nëpërkëmben, sindikalizmi i qëndron idesë se përmes formave të larmishme të organizimeve dhe të rezistencës kapitalizmi është i reformueshëm në të mirë të klasës punëtore. Njëlloj si partitë reformuese, sindikalizmi nuk e konsideron zhvishjen e punëtorëve nga pronësia mbi mjetet e prodhimit si kusht të emancipimit punëtor. Ndryshe nga partitë reformuese, fushëbeteja e sindikalizmit nuk është sfera politike (zgjedhjet politike, parlamenti, etj), por sfera ekonomike. Po ndryshe nga të mësipërmet, sindikalizmi i grupon punëtorët në bazë të qendrës së punës, profesioneve apo edhe më gjerë duke përfshirë krejt klasën punëtore, por pa përfaqësuar interesat e grupeve të tjera shoqërore afër vetes.²⁸

Patronazhi i lëvizjes komuniste ndaj lëvizjes sindikaliste do të sillte frytet e duhura jo në Korçë por në Kuçovë, në qytetin ku lulëzonte industria e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës në Shqipëri. Në gjirin e lëvizjes komuniste që kishte fillimet e saj në 1929²⁹ u shqua më së tepërmi për organizimin sindikalist grupi komunist i sapoformuar në Berat por me peshë kryesisht në Kuçovë. Një nga militantët më të shquar të këtij grupimi ishte Mafuz Laze, më parë

28. Arlind Qorri, "Vendi i sindikalizmit në lëvizjet punëtore dhe format kryesore të lëvizjeve sindikale", Teza 11, 22 Mars 2013, vizituar site-in në 25 maj 2022. <https://teza11.org/vendi-sindikalizmit-ne-levizjet-punetore-dhe-format-kryesore-te-levizjeve-sindikale/>.

29. Shih për më tepër Kristo Frashëri, Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH-së 1878 – 1941 (vështrim historik me një shtojcë dokumentare), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Ilar, Tiranë 2006, f. 62-76; Kastriot Dervishi, Lëvizja komuniste në vitet 1924-1944 dhe formimi i PKSH-së, Tiranë, 2016, Shtëpia Botuese 55, f. 95-103.

punëtor emigrant në Francë dhe që andej në Moskë, ku ndoqi kursin leninist të marksizmit dhe të lëvizjes punëtore (Leniniski kurs). Së bashku me të në Berat bënë pjesë në këtë grupim revolucionar të majtë: Thanas Ziko, Sterjo Gjokoreci, Memo Meto, Adem Haxhiu, Muhamet Gjollësja, Rexhep Luga. Grupi i Kuçovës kishte dhe dy celula të tjera, një në Patos dhe një në Vlorë, të cilat veprimtarinë e tyre e ushtronin, ashtu si në Kuçovë, në ambientet e punëtorëve të shoqërisë vajguore italiane AIPA. Ishte i vetmi grup komunist që punonte në gjirin e punëtorëve, kryesisht të punëtorëve naftëtarë dhe të sektorëve ndihmës të shoqërisë AIPA. Grupi kishte arritur një sukses të madh, më 18 tetor 1935: kishte krijuar shoqërinë e punëtorëve naftëtarë me emrin “Puna”, në fillim me 500 e ca anëtarë. Ndryshe nga shoqëria “Puna” në Korçë, e cila kishte në gjirin e saj punëdhënës e punëtorë bashkë, shoqëria “Puna” e Kuçovës ishte e para organizatë profesionale e mirëfilltë punëtore, mbasi në gjirin e saj kishte vetëm punëtorë, që kishin si synim luftën për të mbrojtur interesat e tyre ekonomikë, shoqërorë, qytetarë, përballë pronarit kapitalist që ishin koncesionarë kapitalistë italianë. Statuti i shoqërisë “Puna” të Kuçovës ishte hartuar, jo sipas statutit të shoqërisë “Puna” të Korçës, por sipas përmbajtjes së statuteve të sindikatave punëtore socialiste franceze – sigurimin e punës tetëorëshe, klasifikimin e pagave sipas kualifikimit, përmirësimi i kushteve të jetesës së punëtorëve, masat paraprake higjienike për ta, sigurimin e asistencës sociale së tyre gjatë sëmundjeve, etj.³⁰ Parë në këtë aspekt ky grupim përbën formën e parë moderne të organizimit sindikalist në shoqërinë shqiptare duke vendosur qytetin naftëtar të Kuçovës si kryeqendrën e lëvizjes së organizuar së klasës punëtore në Shqipëri dhe jo qytetin e Korçës si është nënvizuar deri më tani në historiografinë zyrtare shqiptare. Edhe në këndvështrimin teorik ky grupim përbente sindikatën e parë moderne në Shqipëri. Sindikatat, nënvizojnë studiuesit Buchmüller, Di Nardo & Valetta, konsiderohen si organizata të formuara nga punëtorë të cilët bashkohen për të arritur qëllime të përbashkëta siç janë kushtet e punës. Ose sindikata mund të konsiderohet si një organizatë,

30. Kristo Frashëri, Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH-së 1878 – 1941 (vështrim historik me një shtojcë dokumentare), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Ilar, Tiranë 2006, f.121.

ku anëtarët i përkasin të njëjtës fushë angazhimi dhe ngrenë shqetësime të përbashkëta. Pra një sindikatë mund të konsiderohet si bashkimi i një numri punonjësish, të cilët grupohen nën një çadër për të luftuar për qëllime të përbashkëta siç janë kushtet e punës, pagat, etj³¹ Veç këtyre karakteristikave sindikaliste, si organizatë profesionale socialiste, shoqëria “Puna” kaloi shumë shpejt në fushën e veprimit sindikal: kërcënoi me grevë punëdhënësin në rast se kërkesat e tyre minimale nuk do të merreshin parasysh. Ajo e tregoi forcën e saj sidomos në mitingun që organizoi më 28 nëntor 1935, në mbrojtje të kërkesave të saj. Përballë refuzimit të pronarëve koncesionarë italianë, ajo organizoi një cikël grevash, të cilat u shtrinë edhe në kantieret vajguore të Patosit, madje edhe në punëtorët që ajo shoqëri kishte në Vlorë.³² Në këtë mënyrë përmes aksionit të organizuar sindikalist, Shoqëria “Puna” në Kuçovë plotësonte të gjitha kriteret për t’u konsideruar nga pikëpamja teorike çka përbën një sindikatë të vërtetë punëtoare. Studiuesi sociolog, J. E. Budd e konsideron sindikatën si një organizatë të përbërë nga punëtorë dhe udhëheqës, që ka si qëllim kryesor të negociojë pagën, kushtet e punës, të lehtësojë marrëdhënien midis anëtarëve të saj dhe punëdhënësit, të nënshkruaj kontrata kolektive, të ngrejë çështje në interes të anëtarëve dhe të mbrojë punonjësit nga trajtimi i padrejtë. Një sindikatë është një organizatë e përbërë nga punonjës me qëllime të përbashkëta në lidhje me pagesat dhe kushtet e punës. Sindikata negocion kontratat me punëdhënësit, duke rritur në të njëjtën kohë sadoisfaksionin e punonjësve dhe duke i mbrojtur ata nga kushtet e papërshtatshme apo të rrezikshme të punës.³³

Ndikimi i organizimit sindikalist të Kuçovës u shtri edhe në Korçë, përpos pretendimeve të historiografisë zyrtare shqiptare

31. Buchmueller, Th. C., J. Di Nardo & Valetta, R.G. (2002). Union Effects on Health Insurance Provision and Coverage in the United States. *Sage Journals*, 55, 4. <https://doi.org/10.1177/001979390205500403> cituar sipas Klodian Gega, Studim – Perceptimi i publikut dhe i sindikalistëve mbi performancën e sindikatave në Shqipëri, Qendra për shërbime dhe Praktika Ligjore të Integruara – Fondacioni Friedrich Ebert, 2018, fq. 11.

32. Kristo Frashëri, Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH-së 1878 – 1941 (vështrim historik me një shtojcë dokumentare), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Ilar, Tiranë 2006, f. 122

33. J. W. Budd. Employment èith a Human Face: Balancing Efficiency, Equity, and Voice, Cornell University Press. 2004. Gjendet tek <https://digitalcommons.ilr.cornell.edu/books/3/>, cituar sipas Klodian Gega, Studim – Perceptimi i publikut dhe i sindikalistëve mbi performancën e sindikatave në Shqipëri, Qendra për shërbime dhe Praktika Ligjore të Integruara – Fondacioni Friedrich Ebert, 2018, f. 11.



*Demonstratë e shoqërisë
“Puna”.*

që pretendonte para viteve 90' që qytetin e Korçës e konsideronte si kryeqendra e lëvizjes sindikaliste shqiptare. Krerët e Grupit Komunist të Korçës kishin pikëpamje konfuze në lidhje me lëvizjen sindikale. Kjo u duk haptas, kur krerët e Grupit të Korçës për të mos mbetur prapa lëvizjes sindikale të Kuçovës, organizuan një lëvizje greviste në qytetin e tyre. Ata arritën që të bashkonin në këtë grevë jo vetëm shoqërinë “Puna” të Korçës, por edhe organizatat e tjera profesionale që nuk bënë pjesë në këtë shoqëri, gjë që ishte një hap përpara. Por motivi kryesor që paraqitën këto shoqata të përgatitura nga komunistët e Korçës si kërkesa për grevë, ishte i gabuar. Më 20 shkurt 1936 ata kërcënuan organet shtetërore të prefekturës se të nesërmen do të fillonin grevën në rast se qeveria nuk do të plotësonte këto dy kërkesa. E para, po të mos mbyllte fabrikën “Stik” të këpucëve, që kishte filluar prodhimin në Korçë dhe e dyta, po të mos anulonte lejen që kishte dhënë për hapjen e një fabrike këpucësh në Tiranë, për arsye se me prodhimin e tyre

po rrënoheshin zejtarët-këpucarë, pra rrënoheshin si punëdhënësit, ashtu dhe punëtorët.³⁴ Nga pikëpamja teorike e lëvizjes sindikaliste ishte një hap i gabuar. Në vend që të ngulnin këmbë për një zgjidhje ekonomike për punëtorët që do të mbeteshin pa punë, kërkonin mbylljen e fabrikave. Pra kërkonin të pengonin zhvillimin e industrisë moderne, duke e mbajtur vendin në nivelin e ekonomisë së prapambetur artizanale. Siç dihet, greva, e cila u zhvillua më 21 shkurt 1936, la përshtypje të thellë në opinionin publik. Ajo shpejt u kthye në një demonstratë masive me thirrjen “Bukë-bukë”, e cila u bë shumë shpejt popullore, mbasi me grevistët u bashkuan mjaft qytetarë korçarë, së bashku me ta edhe një pjesë e mirë e nxënësve të liceut të Korçës. Protesta, e cila ka marrë emrin “demonstrata e bukës”, e tronditi administratën qeveritare, e cila për shpërndarjen e saj vuri në përdorim xhandarmërinë shtetërore. Ajo ishte përlëshja e parë, por edhe e fundit e Grupit Komunist të Korçës me administratën qeveritare zogiste.³⁵ Në këtë mënyrë Grupi Komunist i Korçës dhe lëvizja sindikaliste hyri në fazën e “hegjemontetit kulturor” gramshian (Antonio Gramsci) një lloj formulë e së majtës së shekullit XX, ku shpjegohet sesi e majta mund të vijë në pushtet, jo domosdoshmërisht nëpërmjet revolucionit marksist apo përmbysjeve me dhunë. Shembull i këtij modifikimi ishte pjesëmarrja masive në zgjedhjet lokale më 26 qershor të vitit 1938 e Grupit Komunist të Korçës dhe Shoqërisë “Puna”, ku u arrit që Koçi Xoxe, Pilo Peristeri, Stefo Grabocka dhe Niko Ceta udhëheqës të kryesisë të Shoqërisë “Puna” të zgjidheshin anëtarë të këshillit bashkiak të qytetit të Korçës, detyrë të cilën e ushtruan për disa vjet me radhë.³⁶ Në vitin 1935, Kongresi VII i Internacionales Komuniste miratoi udhëzimet e reja të Kominternit që e vinin theksin mbi organizimin e luftës popullore kundër rrezikut fashist dhe krijimin e fronteve popullore. Këto udhëzime i solli në Shqipëri, Koço Tashko në vitin 1937 dhe

34. Kristo Frashëri, Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH-së 1878 – 1941 (vështrim historik me një shtojcë dokumentare), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Ilar, Tiranë 2006, f.125.

35. Kristo Frashëri, Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH-së 1878 – 1941 (vështrim historik me një shtojcë dokumentare), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Ilar, Tiranë 2006, f.125-126.

36. Kastriot Dervishi, Lëvizja komuniste në vitet 1924-1944 dhe formimi i PKSH-së, Tiranë, 2016, Shtëpia Botuese 55, f.136.

filluan të propagandoheshin nga Grupi Komunist i Korçës.³⁷ Shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore dhe hyrja në të e demokracive perëndimore i vuri shqiptarët para dilemës së orientimit: ose me Boshtin fashist, ose me “plutokracinë”, siç i kishte cilësuar Musolini, Francën dhe Britaninë e Madhe. Një klikë mercenare e kolaboracioniste, me pak segmente të zgjatura të saj, u bashkua me fashizmin. Fytyra e këtij regjimi në publik ishin gazeta “Fashizmi” e më vonë “Tomorri”, emisionet e Radio-Tiranës dhe gjithë propaganda figurative filmike. Kjo ishte “Shqipëria fashiste”³⁸. Kufijtë moralë midis atyre që nisën bashkëpunimin me italianët dhe atyre që ishin neutralë, apo filluan paksa më vonë rezistencën nuk ishin kaq të ndarë. Shqipëria ishte një nga viktimat e para të të ashtuquajturit rend i ri fashist dhe i konfigurimit të hartës gjeopolitike që Fuqitë e Boshtit dëshironin t’i jepnin botës. Ky fakt nxiti një reflektim nacionalist të shtrirë në të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare të kohës, sidomos pas disfatës italiane në Luftën Italo-Greke dhe gjeti një përkrahje e mbështetje veçanërisht te të rinjtë e shkollave, një pjesë e mësuesve të tyre, pra tek intelektualë atdhetarë. Ata ndjenë nevojën e organizimit, të manifestimit e të veprimit antifashist. Në Shqipëri ende në vitin 1939 nuk kishte organizata të mirëfillta politike antifashiste. Kishte vetëm disa grupe të vogla komuniste në Korçë, Shkodër e Tiranë, si dhe individë e bërthama me bindje republikane, monarkiste dhe antifashiste.³⁹ Pikërisht mes këtyre grupimeve dhe organizimeve të së majtës do të lindnin dhe grevat e para të organizuara të klasës punëtore që kishte filluar të shtohet në numër si pasojë e investimeve italiane në infrastrukturë dhe në ndërmarrjet sipërmarrëse. Që në ditët e para të pushtimit A. Ca. I (Azienda Carboni Italiani) mori në koncesion monopolin e zbulimit dhe të shfrytëzimit të qymyrgurit (me përjashtim të nëntokës të 7 koncesioneve të akorduara që më parë); AMMI monopolin e kërkimit dhe të shfrytëzimit të hekurit, kromit dhe nikelit, shoqëria Kave di San Vitore (Cave di San

37. Dorian Koçi, Jeta e një ish-anëtari të Grupit Komunist të të Rinjve nën regjimin totalitar, në “E majta – Mendimi politik/ profile biografike”, Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë, 2020, f. 183.

38. Paskal Milo, Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore, Toena, Tiranë, 2014, f. 176.

39. Paskal Milo, Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore, Toena, Tiranë 2014, f. 177.

Vittore) atë të kërkimit dhe të shfrytëzimit të amiantit. Shoqëria automobilistike e monopolit FIAT, me emrin SATA, monopolizoi trafikun automobilistik në dëm të shoqërive kapitaliste shqiptare. Ndërmarrje të mëdha sipërmarrëse ndërtime si Marinucci, Simoncini, Tudini e Talenti, Ferrobeton, etj. morën në sipërmarrje ndërtime rrugësh, kazermash, fortifikimesh ushtarake, etj. Që më 7 prill deri më 12 dhjetor 1939 vetëm në Odën e tregtisë së Durrësit u regjistruan 20 shoqëri tregtare, transporti dhe ndërtime me kapitale thjesht italiane⁴⁰.

Gjatë kësaj kohe do të shihet edhe një ndarje në këndvështrimin që do të kishin komunistët shqiptarë të organizuar në PKSH dhe rrymës socialdemokrate të përfaqësuar nga Partia Socialdemokrate përsa i përket botëkuptimit teorik dhe lëvizjes sindikaliste. Komunistët shqiptarë të organizuar në PKSH, një parti e tipit stalinist shihnin më tepër të zbatonin udhëzimet e Kominternit për shpërthimin e luftës së armatosur për të lehtësuar frontin e Ushtrisë së Kuqe,⁴¹ ndërsa socialdemokratët të organizuar në një tip partie perëndimore shihnin për të drejtat dhe format e organizimit sindikalist të klasës punëtore. Kështu në shtypin komunist të kohës peshën më të madhe të lajmeve do ta zinin aksionet luftarakë, si dhe polemikat me kundërshtarët politikë, ndërsa në shtypin socialdemokrat trajtoheshin si çështje të sindikalizmit si në artikujt “Punëtorija e shtypshkronjave” dhe “Klasa dhe kolektivitetet në vendin tonë”. Gazeta “Lirija”, organ i Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, kishte si moto të vet në krye të ballinës devizën “Drejtësi shoqërore dhe liri politike”. Këto dy synime që ishin të pasqyruar dhe gjerësisht në programin e Partisë Socialdemokrate, në fakt konkurronin si ide me atë çfarë propagandonte dhe PKSH si forca më e madhe e rezistencës antifashiste e organizuar jo vetëm politikisht duke udhëhequr Frontin Nacionalçlirimtar, por edhe ushtarakisht në formën e

40. AQ i RPSH, Fondi i M. Ekonomisë, Raport i Odës së tregtisë së Durrësit, dt. 12.12.1939 cituar sipas K. Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Tiranë, 1970, f. 326.

41. Në një thirrje drejtuar popullit, në prill të vitit 1942, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare i tërhiqte vëmendjen në mënyrë të veçantë, punëtorëve duke u thënë: Ju punëtorë dhe punëtore të Shqipërisë, duhet të merrni vendin e parë në radhët e para luftarake në luftën e sotme të shenjtë të popullit tonë për çlirimin kombëtar. Me këtë pjesëmarrje kryeni detyrën kundrejt popullit tuaj dhe kundrejt Bashkimit Sovjetik. K. Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Tiranë, 1970, f. 354.

batalioneve dhe brigadave partizane.⁴² Megjithëse PKSH e shihte veten si përfaqësuese e klasës punëtore në Shqipëri, organizimi sindikal brenda kësaj kohe mbeti i dobët dhe spontan. Mungesa e traditës sindikaliste, si dhe karakteri mikrofshtar i klasës së porsaformuar punëtore nga zhvillimi i kapitalizmit në Shqipëri ishin dy faktorë që mbizotëruan mbi ecurinë e lëvizjes sindikaliste. Vetëm disa muaj pas çlirimit më 11.2.1945 u thirr Konferenca Nacionale e Punëtorëve dhe e Nëpunësve që themeloi Bashkimet Profesionale të Shqipërisë, sipas modelit të organizimit sovjetik të sindikatave. Në Kongresin e Dytë të Sindikatave, në vitin 1949 ato u shndërruan në Bashkime Profesionale. Sipas statutit të Bashkimeve Profesionale ato zhvillonin një punë të gjithanshme për edukimin ideopolitik, klasor dhe revolucionar të anëtarëve që të armatosnin punonjësit me bindje të qëndrueshme për vitalitetin dhe epërsinë e rendit tonë socialist, të edukoheshin me frymën e patriotizmit socialist dhe të internacionalizmit proletar, të bëheshin sa më të aftë nga ana profesionale, të pajiseshin me kulturë të gjerë e virtyte të larta komuniste. BPSH punonin që të ngrihej më tej vetëdija e klasës punëtore, për rolin dhe misionin e saj në shoqërinë socialiste si klasë në fuqi. BPSH i kushtojnin kujdes të veçantë mobilizimit të gjerë dhe pjesëmarrjes aktive të punëtorëve dhe punonjësve të tjerë në zhvillimin e ekonomisë, në hartimin e plotësimin e planeve ekonomike e shoqërore të shtetit, në zgjidhjen e problemeve të prodhimit.⁴³

Në këtë mënyrë lëvizja sindikaliste në Shqipëri humbi karakterin e saj polemist për të siguruar të drejtat klasike të klasës punëtore, pasi tashmë organizata konsiderohej si rryp transmesioni për të përcjellë e zbatuar të ashtuquajturën vijën e masave të PPSH. Për më tepër me amendimet që iu bënë në vitin 1950, Kushtetutës së vitit 1946, sipas modelit të Kushtetutës sovjetike, si:

42. Dorian Koçi, Profili i një shkrimtareje socialdemokrate, në “E majta – Mendimi politik/ profile biografike”, Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë, 2020, f. 94.

43. Akademia e Shkencave e RPSSH. Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985. f.70

- 1- Republika Popullore e Shqipërisë është shtet i punëtorëve dhe i fshatarëve.
- 2- Gjithë pushteti i Republikës u përket punëtorëve të qytetit dhe të fshatit, përfaqësuar nga Këshillat Popullore.
- 3- Shteti rregullon dhe kontrollon gjithë tregtinë e brendshme në vend;⁴⁴ shuajtën frymën sindikaliste në vend pasi presupozohej se klasa punëtore ishte një klasë që zotëronte pushtetin politik në Shqipëri dhe marrëdhëniet e saj me punëdhënësit ishin të garantuara.

Në përgjithësi, ndryshimet kushtetuese të vitit 1950, shërbyen si një heqje dorë përfundimisht nga parimet e së drejtës, për të ndërtuar një shtet e shoqëri demokratike dhe si veshje e plotë për sovjetizimin e të gjithë institucioneve ligjorë, legjislativë, ekzekutivë, politikë, shoqërorë, ekonomikë, ushtarakë, arsimore e kulturorë të vendit⁴⁵, përfshi dhe sindikatat. Duke ndjekur dogmën staliniste të zhvillimit ekonomik, udhëheqja komuniste shqiptare zhvilloi industrinë e rëndë, dhe u mundua që ndihmën sovjetike ta kanalizonte pikërisht në ndërtimin e bazave të industrisë, që mungonte pothuajse fare në Shqipëri. Sigurisht që në rastin e Shqipërisë nuk mund të flitej për industri të rëndë, por për ndërtimin e disa fabrikave, apo edhe të ndonjë hidrocentrali. Hartës industriale të Shqipërisë iu shtuan disa objekte prodhuese, ku për t'u përmendur janë dy a tri fabrika trikotazhi, më e rëndësishmja prej tyre, kombinati i tekstileve në Tiranë, disa fabrika për lëkurët, një fabrikë gome dhe dy fabrika këpucësh, disa fabrika vaji, një fabrikë sheqeri, një fabrikë konservash dhe punishte për reçel e marmelatë, disa fabrika bloje, dy fabrika për kompensatë mobilie, dy a tri ofiçina mekanike dhe po aq fabrika tullash, si dhe një rafineri naftë e një fabrikë çimentoje. U ndërtua, gjithashtu, një hidrocentral në Tiranë, disa rrugë automobilistike, si dhe 125 km hekurudhë.⁴⁶ Historia e Shqipërisë komuniste nuk mund të reduktohet në qëndresën e shoqërisë ndaj një sistemi politiko-ekonomik të imponuar nga Partia e Punës. Sigurisht që terrori, kampet e punës,

44. Lisen Bashkurti, Diplomacia shqiptare në fillimet e "Luftës së Ftohtë", Tiranë, Geer, 2003, f.183.

45. Lisen Bashkurti, Diplomacia shqiptare në fillimet e "Luftës së Ftohtë", Tiranë, Geer, 2003, f. 184.

46. Ana Lalaj, Pranverë e rrejtshme e '56, Tiranë, Infoborues, 2015, f. 22.

burgjet, spiunët e Sigurimi të Shtetit, “puna vullnetare”, varfëria materiale e kulturore e karakterizuan komunizmin shqiptar, por historia e tij nuk do të ishte e plotë pa kreditë e shteteve socialiste, industrializimin, makineritë, planet urbane, bursat e studimit, filmat sovjetikë, specialistët e huaj, “metodën sovjetike” të punës, “stakhanovët”, dhe pa mijëra huazime të tjera nga Bashkimi Sovjetik e vendet e tjera të kampit socialist. Tharja e kënetave, kooperativat e Stacionet e Makinerive dhe Traktorëve, ndërtimi i kombineve dhe projektimi i qytezave industriale ishin aspekti material i qytetërimit socialist, aq sa “kantieret e ndërtimit u bënë “simbolikë e ndërtimit të socializmit”.⁴⁷

Ky zhvillim industrial që filloi të rritej nga viti në vit solli si pasojë edhe rritjen në numër të klasës punëtore, por jo lirinë e saj për të marrë vendime dhe për t’u organizuar në sindikata të pavarura dhe jo të kontrolluara. Revolucioni social që ndodhi në këto vite në Shqipëri i përngjet fillimeve të Revolucionit Industrial në vendet e zhvilluara Europiane, ku shumicën e proletariatit e përbënte fshatarësia e rrënuar dhe pa tokë që largohej drejt qendrave urbane për një jetë më të mirë dhe me shërbime sociale. Te shtresa e fshatarëve të shndërruar në punëtorë dhe që shihnin te sistemi i ri perspektivën e ngritjes së mëtejshme shoqërore, regjimi komunist siguroi shumë prej mbështetësve të vet. Me gjithë vështirësitë dhe privimet e jetës së përditshme, kjo shtresë i ishte mirënjohëse revolucionit që kishte ndodhur në Shqipërinë e pasluftës dhe nuk kishte ndonjë interes në kthimin në pushtet të të shpronësuarve.⁴⁸

Në këtë vëllim përfshihet një skicë historike e sindikalizmit shqiptar që nga viti 1905 deri në vitin 1961, vit ky, kur Shqipëria shkëputet nga Blloku Lindor e rrjedhimisht humbet kontaktin dhe me organizimet e mëdha masive të lëvizjes sindikaliste në vendet e Bllokut Komunist. Kjo lloj tipologjie do të ndihmojë plotësimin e një narrative historike, e cila do të synojë:

47. Enis Sulstarova, Nga Magnitogorski në Maliq: Shënime për “qytetërimin stalinist”, Revista “Shenja”, korrik 2022; E. Mëhilli, “From Stalin to Mao”, Ithaca, Cornell University Press, 2017, f. 15.

48. Enis Sulstarova, Nga Magnitogorski në Maliq: Shënime për “qytetërimin stalinist”, Revista “Shenja”, korrik 2022.

1. Skicimin e historikut të sindikalizimit shqiptar, në lidhje me lëvizjen sindikaliste botërore.
2. Dhënien e një panorame ideologjike, në mënyrë që të kuptohen më mirë rrymat e mendimit politik të së majtës, që qarkulluan në Shqipëri përgjatë shekullit XX, si dhe ndikimin e tyre mbi lëvizjen sindikaliste.
3. Evidentimin e sfidave me të cilat përballej lëvizja sindikaliste në fillimet e saj, si dhe në periudhën midis dy luftërave dhe vështirësitë e saj për t'u organizuar në organizata të mirrëfillta sindikaliste.
4. Analizimin e arsyeve dhe rrethanave historike/politike dhe ekonomike, që lejuan konsolidimin e lëvizjes sindikaliste në Shqipëri të mbështetur në modelin e bashkimeve profesionale të tipit leninist.
5. T'i japë mundësi brezit të ri të shqiptarëve të mësojë më shumë për fatin e individëve dhe lëvizjes sindikaliste në Shqipëri dhe sesi kjo lëvizje ndikoi në hartimin e vlerave progresiste të së majtës.
6. Të evidentojë faktin se lëvizja e sotme sindikaliste në Shqipëri ka si pjesë të trashëgimisë së saj historike një periudhë të gjatë historike, që korrespondon nga shtetformimi i shtetit shqiptar deri në vitet '60 të shekullit të kaluar. Duke qenë se brenda lëvizjes sindikaliste u mbajtën marrëdhënie pas vitit 1961, vetëm me vendet e botës së tretë, ajo do të analizohet me kujdes në një projekt të mëvonshëm.

Piketa të rëndësishme të sindikalizimit shqiptar⁴⁹:

Shek. XVIII

Në qytetet kryesore shqiptare, si në Shkodër, Voskopojë, Korçë e Elbasan, me zejtarët ishin të organizuar sipas zejeve në “esnafet”⁵⁰,

49. Nxjerrë sipas: Stilian Adhami: Kronikë e lëvizjes punëtore e sindikale në Shqipëri, Tiranë, 1969.

50. Nga regjistrat e gjyqit të Sherias në Elbasan del se nga fillimi i shekullit të XVII në qytetin e Elbasanit kishte mbi 30 lloj zejesh si psh. hekurpunues, qeleshepunues, samarpunues, saraçë, rrobaqepës, etj. Gjithë zejtarët e të njëjtit zanat ishin mbledhur në „esnafë“ me organet përkatëse si psh. me mytevelin (kryetarin), qehajajin (zbatuesin e vendimeve të esnafit“, pasvanët me në krye bylykbashin, që ruanin dyqanet, kondikun, dmth librin e llogarive dhe bajrakun (flamurin) e esnafit. Esnafi më i shquar ishte ai i tabakëve, ku përfshiheshin edhe shumë beqarë mbi 20 vjeç. Shumë esnafë, për të mbrojtur më mirë interesat e tyre u bashkuan më vonë në „esnafi i lartë“, me në krye Shehër Qehajasin, ose reizin (kryetarin), me po ato detyra që kishte më vonë beldieja (bashkia).

me statutet, rregulloret dhe emblemat e tyre. Të gjithë këta së bashku, janë paraardhësit e sindikalizmit shqiptar.

Shek. XIX

Prej fillimit të shekullit, në disa qytete të mëdha si Shkodra, Gjirokastra, Tirana, Berati, Elbasani dhe Korça, filluan të krijoheshin punishte e ndërmarrje pak a shumë më të mëdha se deri asokohe, si punishtet e punimit të pëlhurave dhe artikujve të mëndafshit, poçeritë dhe furrat e tjegullave, punishtet e rrobaqepësisë, opingarëve, këpucarëve, etj.

Po në këtë periudhë, në Shkodër u krijua përherë të parë një shoqatë e çirakëve, e cila për kohën luajti një rol përparimtar.

1850:

Rreth këtij viti në Shkodër u shfaqën shenjat e para të përpjekjeve për t'u bashkuar. Me nismën e Zef Jubanit u ngrit një shoqëri e kallfenjve, çirakëve e shegertëve të zejtarive për ndihmë reciproke. Kjo “shoqni ndihmëtare” u përpoq të luftojë kundër pengesave për dhënien e zanatit dhe përpirësimin e pagave, por u luftua ashpër nga esnafët.

1870:

U hap në Shkodër shtypshkronja e parë, një nga ndërmarrjet e para industriale në Shqipëri.

1871:

U hap miniera e serës në Selenicë.

1879:

Bankierët e Galatës (Stamboll) morën në sipërmarrje prodhimin e kripës, duke përdorur vetëm në Vlorë rreth 100 punëtorë.

1885:

Në Korçë u ngrit një fabrikë mielli.

1891:

Shoqëria franceze e minierave të Selenicës filloi shfrytëzimin kapitalist të minierës, duke nxjerrë me vegla dore mesatarisht 35.000 kv. serë në vit.

1896:

U ndërtua në Durrës një mulli me avull.

1879:

U ngrit në Tiranë makina e parë për prodhimin e vajit.

Shek. XX:

Në vitet e para të këtij shekulli, në vendin tonë kishte rreth 25 ndërmarrje të ndryshme me karakter industrial, ku punonin një numër i madh punëtorësh me mëditje. Po ashtu, në dhjetë vitet e para të tij, kapitali i huaj filloi të interesohej për shfrytëzimin e pasurive natyrore të vendit. Shoqëri kapitaliste italiane blenë sipërfaqe të mëdha pyjesh dhe filluan të nxjerrin lëndë druri në sasi të mëdha, duke punësuar një numër të madh punëtorësh shqiptarë.

1902:

Nga Shtjefën Ingrizi me disa shokë të tij të kthyer nga vendet e Austro-Hungarisë u krijua në Shkodër “Shoqnia e Punëtorëve”, që mori edhe disa tipare të shoqërive ndihmëtare të punëtorëve.

mars 1904:

Punëtorët e ngarkim - shkarkimit në Durrës shpallën grevë. Ata kërkonin ngritjen e mëditjes për punën.

1906:

Në Shkodër u krijua kooperativa e parë punëtore e konsumit. Gjatë kësaj periudhe u bënë përpjekje për të krijuar disa kooperativa prodhimi nga punëtorë, zejtarë, zdrukthtarë e berberë.

1907:

U themelua nga punëtorët detarë në Shkodër “klubi i detarëve”, që ishte një formë më e përparuar organizimi nga “esnafi”. Qëllimi i tij ishte që t’u vinte në ndihmë barkaxhinjve të varfër. Ky klub veproi deri në 1912, kur u prish për shkak të ngjarjeve të luftës.

1 prill 1907:

Sipas traditës së krijuar nga lëvizjet e shëgertëve të shekullit XIX, punëtorë e çirakë të mjeshtërive të ndryshme në Shkodër formuan “Shoqinë ndihmëtare të punëtorëve”⁵¹, që kishte për qëllim ndihmën reciproke të anëtarëve dhe mbrojtjen e interesave të tyre ekonomike. Kjo shoqni hapi një punishte në Serreq dhe mbi derën e saj u vendos një tabelë për herë të parë në gjuhën shqipe.

1908:

Në Shkodër u ngritën manufakturat e duhanit dhe cigareve “Tarabosh” me rreth 100 punëtorë.

1913:

Në Shkodër u krijua një shoqëri tjetër ndihmëtare, e cila gjatë Luftës së Parë Botërore u shpërnda nga pushtuesit austro-hungarezë.

1918:

Në Gjirokastër u formua një komision i arsimitarëve për të krijuar “Lidhjen e Mësuesve”.

1919:

Mësuesit e Tiranës përpiqen të krijojnë organizatën e tyre profesionale, por pa sukses. Ky organizim u pengua nga qeveria e Durrësit.

51. Në programin e kësaj shoqërie shkruhej: „punëtorët e Shkodrës, tue pa se nevojat e tyne bahen përdit ma të mëdhaja e se gjithnji si zanatet si punëtorët janë në tëposhtë, njohin punët fare njerëzore e qytetnore meu mbledhë në nji shoqni ndihmëtare të punëtorisë për me u ba ballë së bashkut të vështirave të jetës e me përmirësue gjendjen e vet si ekonomikisht si moralisht, tue i dhanë dorën shoqishoijt në tana mjetet e mënyrat qi të munden“.

Mars 1920:

Në Rexhepaj të Vlorës u krijua një shoqëri punëtore me emrin “Shoqëria Punëtore Gorishti”, që përmbliidhte një numër argatësh të bujqësisë së krahinës së Gorishtit. Nismëtar i saj ishte mësuesi Rexhep Dizdari.

Shtator 1920:

Nëpunësit e Durrësit në shenjë proteste ndaj pagave të ulta shpallën fillimisht grevën dhe më pas dhanë dorëheqje kolektive. Në Shkodër, me nismën e disa punëtorëve dhe zejtarëve të kthyer nga emigrimi, u formua “Shoqëria Ndihmëtare e Punëtorisë”, rreth saj u grumbulluan 400 anëtarë, përfaqësues të zejeve të ndryshme të këtij qyteti. Në vitin 1922 kjo shoqëri u zgjerua më tej, duke dyfishuar numrin e anëtarëve të saj. Programi i saj ishte në plan të parë ekonomik dhe bazohej mbi dhënien e ndihmës reciproke të anëtarëve me njëri-tjetrin.

21 Janar 1921:

Punëtorët tipografë të Gjirokastrës u hodhën në grevë duke parashtruar kërkesa ekonomike. Shkak u bë pushimi pa shkak nga puna i një kolegu të tyre. Greva zgjati gati dy javë dhe në shenjë solidariteti me ta u bashkuan edhe punëtorët rrobaqepës e këpucarë. Punëdhënësit u detyruan të bëjnë disa lëshime.

7 Gusht 1921:

Me nismën e Avni Rustemit, në Gjirokastrë u formua “Lidhja e mësuesve”. Qëllimi i saj ishte përpjekja për të përmirësuar kushtet ekonomike të arsimtarëve. Të tilla organizata u krijuan më 1922-1923 edhe në Korçë, Shkodër, Vlorë, etj.

Dhjetor 1921:

Punëtorët e fabrikës së duhanit “Tarabosh” u hodhën në grevë. Me qëllim mbylljen e grevës, punëdhënësi shpalli mbylljen e ndërmarrjes dhe i pushoi në masë punëtorët, me qëllim shtyrjen e grevës.

1921:

Në shtypin e kohës u bënë botime, ku parashtrohej nevoja e hartimit të një legjislacioni në favor të punëtorëve, uljen e orëve të punës, hapjen e shkollave profesionale dhe kurseve të analfabetizmit.

Shtator 1922:

Punëtorët e manifakturës së cigareve “Tarabosh” në Shkodër shpërthyen një grevë në shenjë proteste kundër dëbimit të një pjese të punëtorëve, të cilët u hodhën në rrugë për shkak të futjes së makinerive në fabrikë.

1922:

Edhe në Shkodër u krijua “Lidhja e Mësuesve”.

11 Shkurt 1923:

Punëtorët e Korçës në një mbledhje të gjerë formuan shoqërinë “Bashkimi i Gjithë Punëtorëve” me një program të përcaktuar mirë përsa i përket kërkesave ekonomike, si pakësimin e orëve të punës, shtimin e mëditjeve, sigurimin e një dite pushimi në javë, etj.

Mars 1923:

Punëtorët mirditorë që punonin në Pukë në një shoqëri italiane për kërkime të mineralit të bakrit, shpallën grevën. Ata kërkonin t’u rritej mëditja nga 5 korona në ditë, në 20 korona. Greva ia arriti qëllimit.

Qershor 1923:

Në Korçë u tentua pa sukses formimi i një partie socialiste, e cila do të organizonte punëtorët për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e tyre.

1923:

Një grup tregtarësh durrsakë, tiranas dhe elbasanas formuan shoqërinë e parë me kapitale anonime: shoqërinë “Stamles” dhe ngritën një fabrikë cigaresh, ku do të angazhoheshin shumë punëtorë. Po në këtë vit, punëtorët e fabrikës së duhanit “Tarabosh”

në Shkodër, u hodhën në grevë për shtimin e mëditjes. Greva dështoi që në ditët e para, pasi grevistët u zëvendësuan me grevëthyes.

Janar 1924:

Mësuesit e Korçës shpallën grevë, pasi kishin prej mëse pesë muaj që nuk u paguhej paga. Me ta u bashkuan edhe 60 mësues të fshatrave. Greva zgjati një muaj dhe qeveria u detyrua të paguante rrogat e prapambetura. Me grevën e mësuesve u sensibilizuan të gjithë nëpunësit e shtetit, të cilët ishin të gatshëm të kalonin në grevë të përgjithshme, nëse mësuesit nuk do të paguheshin. Kjo veprimtari drejtohej nga shoqëria “Vatra” dhe nga “Lidhja shoqërore e arsimitarëve të Korçës e të qarkut”.

8 shkurt 1924:

Një grup nëpunësish të prefekturës së Korçës formuan shoqërinë e nëpunësve me emrin “Lidhja e Nëpunësve”, me qendër në qytetin e Korçës. Qëllimi kryesor i saj ishte përmirësimi i jetesës së nëpunësve moralisht dhe materialisht, zhvillimi i përgjithshëm, plotësimi i mësimeve të tyre speciale, etj.

Shkurt 1924:

Bazuar në përvojën e grevës së mësuesve të Korçës, meqenëse edhe mësues të rretheve të tjerë nuk ishin paguar, u hodhën në grevë edhe mësuesit e Kavajës, më 4 shkurt, të Tiranës më 9 shkurt dhe të Gjirokastrës më 24 shkurt.

Mars 1925:

Punëtorët mirditorë që punonin në një minierë bakri në Pukë për llogari të një shoqërie italiane zhvilluan një grevë të organizuar.

10 Maj 1925:

Formohet “Shoqëria e këpucëbërësve të Korçës”. Në të bënin pjesë ustallarë, kallfenj dhe çirakë këpucarë. Qëllimi i krijimit të saj ishte “zhvillimi moral dhe material i mjeshtërisë së tyre, si edhe dhënia e ndihmës dhe mbarëvajtja e të gjithë anëtarëve të saj”.

Maj 1925:

Në Gjirokastrë formohet “Lidhja e Punëtorëve”. E veçanta e kësaj lidhjeje ishte që ajo nuk ishte e ndarë sipas profesioneve, por mbliidhte në të të gjithë mjeshtëritë.

27 Maj 1926:

Në vazhdimësi të grevës që punëtorët e Selenicës kishin zhvilluar në tetor të vitit 1923, ata i paraqitën drejtorisë së ndërmarrjes një kërkesë për shtimin e mëditjes dhe përmirësimin e kushteve të punës, çka drejtoria nuk e mori në konsideratë. Si rrjedhim, punëtorët e Selenicës shpallën grevën e përgjithshme, e cila ishte më e organizuara në ato vite. Për shtypjen e saj u desh ndërhyrja e reparteve të xhandarmërisë. Greva zgjati katër ditë.

13 Qershor 1926:

Punëtorët e punishteve të rrobaqepësisë në Tiranë formuan shoqërinë e tyre, e cila u quajt “Përparimi”. Në programin e saj parashikohej mbrojtja e punëtorëve nga shkeljet e të drejtave nga punëdhënësi, dhënia e ndihmës reciproke mes anëtarëve, edukimi i punëtorëve dhe çelja e kurseve të analfabetizmit. Aktiviteti i saj zgjati rreth dy vjet. Duke qenë se shërbeu si model organizimi, ditën kur edhe punëtorët këpucarë u mblodhën për të zhvilluar një organizim të ngjashëm, shoqëria “Përparimi” u shpërnda, me akuzën e zhvillimit të propagandës komuniste.

Pranverë 1927:

Me qëllim që të pakësoheshin orët e punës dhe të ngrihej pagesa, e cila ishte shumë e vogël, punëtorët që punonin në pusët e Ardenicës shpallën grevë. E trembur nga shndërrimi i saj në një greve të përgjithshme, shoqëria “Anglo-Persiane” u detyrua të pranonte pjesërisht kërkesat e punëtorëve.

27 Nëntor 1927:

Punëtorët e punishteve të rrobaqepësisë së Korçës formuan “Lidhjen e Punëtorëve Rrobaqepës të Korçës”. Qëllimi kryesor i formimit të saj ishte plotësimi i disa kërkesave ekonomike.

Nëntor 1927:

Punëtorët e ndërtimit në Kashar, Tiranë u hodhën në grevë, për të kërkuar të drejtat e mohuara të tyre. Ata u nisën në këmbë drejt Tiranës dhe demonstuan përballë zyrave të qeverisë shqiptare.

Dhjetor 1927:

Në drejtimin e “Lidhjes”, punëtorët rrobaqepës korçarë, shpallën një grevë, me qëllim uljen e orarit të punës në 10 orë në ditë dhe kufizimin e punës gjatë natës për të miturit. Greva zgjati dy javë dhe përfundoi vetëm pasi u plotësuan kushtet e tyre. Gjithsesi, pas një kohe të shkurtër, punëdhënësit u kthyen përsëri në kushtet e vjetra të punës.

1927:

U intensifikua organizimi i grevave të punëtorëve, në kërkim të të drejtave të mohuara të tyre. Kësisoj, u ngritën në grevë punëtorët e shtypshkronjës “Nikaj” në Tiranë, punëtorët e shtypshkronjës “Gurakuqi”, etj. nga këto greva, punëtorët arritën të fitojnë disa të drejta, siç ishte shkurtimi i ditës së punës nga 14 në 10-12 orë dhe u shtuan pagat.

Po ashtu, punëtorët e fabrikave të cigareve në Shkodër bënë një protestë kundër spekulimit që bënte shoqëria “Stamles”, e cila mbante të mbyllura bobinat, për të konkurruar fabrikat e Shkodrës. Gjatë demonstratës punëtorët sulmuan edhe zyrat e financës së Shkodrës, ku ruheshin bobinat. Në grevë u hodhën edhe punëtorët që punonin në shoqërinë “Anglo-Iraniane OIL CO” në Kuçovë.

Maj 1928:

Punëtorët detarë të Portit të Durrësit shpallën grevë dhe nëpërmjet një komisioni përfaqësues kërkuar rritjen e pagave dhe përmirësimin e kushteve të punës. Pas gjashtë ditë grevë, punëdhënësit u detyruan të plotësojnë kërkesat e tyre. Disa muaj më vonë, më 16 shtator, punëtorët e këtij porti që punonin për shoqërinë sipërmarrëse italiane “Maxorana” u hodhën përsëri në grevë. Ata punonin 12 orë në ditë dhe paguheshin shumë pak.

Drejtuesit e sipërmarrjes jo vetëm që nuk pranuan ta ulnin orarin e punës në tetë orë, por pushuan menjëherë nga puna dy anëtarë të komisionit. Në shenjë proteste të gjithë punëtorët u hodhën në një grevë tre ditore. Shoqëria italiane pranoi të rriste pagat vetëm për punëtorët e kualifikuar.

25 Janar 1929:

U themelua në Korçë shoqëria profesionale e shoferëve me emrin “shoqëria profesionale e shoferëve të Korçës dhe të qarkut Përparimi”. Shoqëria kishte vulën dhe statutin e saj, ku statuti përcaktonte ruajtjen e dinjitetit dhe mbrojtjen e ndihmën profesionale të anëtarëve të saj e profesionistëve në përgjithësi.

Korrik 1929:

Punëtorët shqiptarë të Kantierit të Portit të Shëngjinit, që punonin për llogari të firmës italiane “Maxorana” lanë punën në shenjë proteste, sepse paguheshin më pak, sesa u ishte premtuar. Greva dështoi sepse punëdhënësi i zëvendësoi punëtorët grevistë me punëtorë të tjerë.

Janar 1930:

Punëtorët e ndërtimit të ndërtesave të ministrive në Tiranë ngritën krye dhe u përleshën me drejtuesit e shoqërisë sipërmarrëse. Arsyeja ishte shkelja e marrëveshjes nga punëdhënësi për pagesën ditore, e cila ishte mjaft e ulët.

26 Gusht 1930:

Rreth 100 punëtorë të ndërtimit të rrugës Krujë-Burrel lanë punën të revoltuar nga trajtimi që u bënte firma sipërmarrëse. Punëtorët e këtij kantieri bënë disa greva të përsëritura në shtator e tetor. Arsyeja kryesore ishte mëditja e ulët.

Shkurt 1932:

Në Tiranë u formua “Sindikata e Përgjithshme e Zanatçinjve dhe

Punëtorëve Shqiptarë”. Kjo organizatë kishte si qëllim të luftonte konkurrencën e punëtorëve dhe zanatçinjve italianë në Shqipëri.

24 Shtator 1933:

U aprovua “Statuti i shoqërisë profesionale të mjeshtëreve për ndërtime godinash «Puna» me qendër në Korçë”. Themelimi i kësaj shoqërie ishte një shtysë e fuqishme për organizimin e mëtejshëm të punëtorëve të të gjithë profesioneve. Ajo arriti të mbledhë rreth saj të gjithë punëtorët e ndërtimit në Korçë, duke arritur një anëtarësi prej mëse 500 punëtorësh.

1 shtator 1934:

Përsëri në Korçë, u themelua “Shoqëria e Punëtorëve Rrobaqepës” të Korçës. Kjo shoqëri kishte këshillin e saj administrues, statutin dhe vulën e saj. Qëllimi i krijimit të kësaj shoqërie ishte “mbrojtja dhe ndihma profesionale e mirëbërëse e anëtarëve të saj”.

1934:

Arsimtarët e Tiranës u mbledhën dhe krijuan shoqatën e tyre “Lidhja e Arsimitarëve”. Përveç bashkimit të të gjithë arsimtarëve të Shqipërisë rreth saj, Lidhja mori angazhimin të botonte edhe dy revista. Lidhja pati jetë të shkurtër, pasi qeveria e shpërndau atë. Po në këtë vit, në Korçë u krijua me nismën e disa punëtorëve këpucarë edhe “Shoqëria e Punëtorëve Këpucarë”.

18 Tetor 1935:

Me nismën e punëtorit komunist Mafuz Laze dhe sipas udhëzimeve të Halim Xhelos dhe “Komitetit të Çlirimit Nacional” në Francë, u krijua bashkimi i parë profesional i punëtorëve të naftës në Kuçovë, që mori emrin shoqëria “Puna”. Fillimisht ajo kishte në radhët e saj 680 anëtarë, por duke përfshirë edhe punëtorët e tjerë të shoqërisë AIPA që punonin në Peqishtë dhe në Ujë të Ftohtë të Vlorës, ajo arriti në 3000 anëtarë.

Nëntor 1935:

Në emër të shoqërisë “Puna”⁵², një komision punëtorësh i përbërë nga pesë vetë i dërgoi qeverisë një peticion, me qëllim njohjen e shoqërisë dhe aprovimin e projektstatutit të saj. Po ashtu, në peticion u paraqitën edhe disa kërkesa ekonomike dhe politike. Disa ditë më vonë, qeveria dërgoi në Kuçovë një përfaqësues, i cili deklaroi se kërkesat e paraqitura në peticion nuk merreshin parasysh. Si pasojë, rreth 800 punëtorë organizuan në shenjë proteste një demonstratë përpara zyrave të AIPA-s. Si rrjedhim, AIPA pushoi nga puna gjithë nismëtarët e shoqërisë dhe aktivistë të saj.

15 Dhjetor 1935:

Në Korçë u krijua “Lidhja e Nëpunësve Privatë”. Numri i anëtarëve arriti në 180 punonjës të tregtisë, hoteleve, restoranteve, etj. qëllimi i krijimit të kësaj shoqërie ishte zhvillimi ekonomik dhe mendor i anëtarëve të saj dhe nxitja e solidaritetit mes tyre.

Po gjatë vitit 1935, në Tiranë u organizua edhe “Shoqata e Punëtorëve të Shtypshkronjave”. Qëllimi i këtij organizimi ishte nxitja e ndjenjave revolucionare të tyre.

5 Janar 1936:

Në vazhdimësi të grevave të para, që u organizuan pas krijimit të bashkimit profesional “Puna” të Kuçovës, 600 punëtorë që punonin për ndërtimin e depozitave të vajgursjellësit Kuçovë-Vlorë te Uji i ftohtë në Vlorë, kërkuan shtimin e pagës, shkurtimin e orarit të punës, përmirësimin e kushteve të punës e të banimit, dmth. ndërtimin e barakave të fjetjes dhe mbi të gjitha heqjen dorë nga imponimi i ideologjisë fashiste. AIPA nuk i mori në konsideratë kërkesat e punëtorëve dhe ata u hodhën në protestë. AIPA tentoi

52. Nga Statuti i Shoqërisë „Puna” të Kuçovës: Art. 2 caktonte si qëllim të shoqërisë „...mbrojtjen e dinjitetit, mbrojtjen e interesave dhe ndihmën morale e materiale të anëtarëve të saj. Për t'i arritur këto qëllime shoqëria do të përpiqet: 1. Të formojë një arkë për ndihmë shokëve të sëmurë dhe për ata që do të mbeten përkohësisht pa punë. Formimi dhe funksionimi i kësja arke do të rregullohet me një rregullore të posaçme të këshillit; 2. Të kërkohen nga autoritetet masa legjislative dhe administrative në favor të punëtorit; 3. Të vendosen lidhje kolegjinale edhe me shoqëri të tjera të këtij lloji në Shqipëri. Art. 3., në Shoqëri duhet të marrin pjesë të gjithë punëtorët shqiptarë të prefekturës së Beratit dhe të rretheve të tjera pranë ndërmarrjeve koncesionare të vajgurit ose sipërmarrësve, enteve, organizatave që punojnë për llogari të ndërmarrjeve të sipërpërmendura”. (Stilian Adhami: Kronikë e lëvizjes punëtores e sindikale në Shqipëri, f. 128-129).

nëpërmjet grevëthyesve të mbyllte protestën, por pa sukses. Si rrjedhim, ajo u detyrua disa ditë më vonë të pranonte kërkesat e punëtorëve.

11 Shkurt 1936:

Meqenëse punëtorët drejtues të shoqërisë “Puna” përndiqeshin, të gjithë punëtorët e naftës në Kuçovë edhe ata të reparteve ndihmëse, u hodhën në grevë. Greva u shtyp me forcën e xhandarmërisë, nën drejtimin e Ministrit të Brendshëm Ethem Toto. Punëtorët drejtues të grevës u burgosën dhe pasi u liruan nuk u lejuan më të ktheheshin në Kuçovë. Kësisoj, shoqëria pushoi së ekzistuari.

10 Mars 1936:

Punëtorët bojaxhinj të Tiranës formuan shoqërinë e tyre “Drita”.

25 Shkurt 1937:

Ministria e Punëve të Brendshme dha urdhër për shkatërrimin e shoqërisë “Puna” të Korçës, e cila, sipas njoftimeve zyrtare të prefekturës së Korçës, u shpërnda më 27 shkurt të vitit 1937.

1937:

Në Përmet u krijua Shoqëria Punëtore e Muratorëve me emrin “Vëllazëria”. Në rregulloren që ajo miratoi parashikohej lufta e përbashkët për të ruajtur mëditjet, solidaritetin midis kolektivave për të mënjanuar konkurrencën, krijimin e një arke të sigurimeve shoqërore, etj. Kjo shoqëri përfshiu rreth 30 punëtorë dhe pati një jetëgjatësi prej shtatë muajsh, sepse u sabotua nga qarqet drejtuese të vendit, të cilët sollën kolektiva muratorësh nga krahinat e veriut.

15 Maj 1938:

Të pakënaqur nga mëditjet e ulta, oraret e gjata të punës dhe sjellja e ashpër e drejtuesve të shoqërisë SIMSA dhe për shkak të gjobave, punëtorët e Rubikut u hodhën në grevë. Greva zgjati katër ditë dhe si rrjedhim, atyre iu ngrit mëditja nga 5 në 6 lekë dhe iu ul orari i punës në 10 orë.

3 Prill 1939:

Në Tiranë, por edhe në qytete të tjera, filluan demonstratat e mëdha popullore kundër pushtimit italian që kërcënonte vendin, në krye të të cilave qëndronin punëtorët. Ata kërkonin armë për të mbrojtur vendin.

6 Prill 1939:

Rreth 500 punëtorë të ardhur nga Kuçova demonstruan me popullin e Beratit dhe kërkuan armë për të luftuar kundër pushtuesve italianë.

Maj 1939:

Punëtorët tipografë të Tiranës, të cilët punonin deri në 13 orë në ditë, u hodhën në grevë dhe kërkuan respektimin e tetë orarëshit të punës dhe ngritjen e mëditjes. Pronari u detyrua të bëjë lëshime.

19 Maj 1939:

Punëtorët, që punonin në ndërtimin e urës së Bënçës në Tepelenë, kundërshtuan të merrnin pjesë në pritjen që po organizohej me rastin e ardhjes së Ministrit Italian të Punëve Botore dhe të revoltuar, pasi një nga shokët e tyre u arrestua si nxitës i revoltës, shpërthyen në një demonstratë për lirin e tij.

Qershor 1939:

37 punëtorë të ngarkim-shkarkimit në skelën e Vlorës shpallën grevë me qëllim rritjen e pagave. Greva paralizoi shkarkimin e materialeve ushtarake të pushtuesve italianë dhe si pasojë, kundër grevistëve ndërhyri me dhunë karabinieria. Udhëheqësit e grevës u dënuan nga gjyqi ushtarak italian.

13 Korrik 1939:

Të gjitha kamerierët e lokaleve dhe të hoteleve në Tiranë parashtruan një kërkesë për ngritjen e pagave. Me qëllim që greva të mos përshkallëzohej, qeveria udhëzoi pronarët që t'i pranonin kërkesat e tyre.

7 Tetor 1939:

Shoqëria italiane “Provera e Carassa” në Gjirokastrë hodhi në gjyq shtatë punëtorë shqiptarë, të cilët u arrestuan me akuzën si grevënxitës.

25 Tetor 1939:

Mbi 200 punëtorë të minierës së Selenicës shpallën grevë për të protestuar kundër pagave të ulëta dhe taksave të reja që ishin shtuar dhe ishin baras me vlerën e tri ditëve punë. Shembullin e tyre e ndoqën edhe punëtorët e minierës së Rubikut. Lëvizja greviste u shtri edhe në fabrikat e pronarëve shqiptarë në Durrës, Shkodër, Gjirokastrë, etj.

13 Dhjetor 1939:

60 punëtorë që punonin për llogari të firmës italiane “Federici Elia”, në Milot, pasi kërkuan më kot që të merrej prapë në punë një kryepunëtor shqiptar, i cili ishte pushuar padrejtësisht, shpallën një grevë solidariteti që vazhdoi gjatë, pavarësisht se karabinieria ushtri dhunë ndaj tyre. Punëdhënësit u detyruan të marrin përsëri në punë kryepunëtorin shqiptar.

Janar 1940:

Punëtorët që punonin në fortifikimet e Shkëmbit të Kavajës u hodhën në grevë. Shoqëria italiane SICAM u detyrua të pezullonte punimet. Katër grevistët më të vendosur u arrestuan dhe u internuan.

Mars 1940:

Punëtorët e Fabrikës së Çimentos në Shkodër u hodhën në grevë për shtimin e rrogës dhe pakësimin e orëve të punës. Greva zgjati 10 ditë. Punëdhënësit u detyruan të shtojnë rrogat por, po ashtu kërkuan ndihmën e karabinierisë, e cila arrestoi 11 punëtorë prej grupit nismëtar të grevës, të cilët kaluan në Gjyqin Ushtarak.

26 Mars 1940:

30 punëtorë që punonin për llogari të shoqërisë italiane “Puriceli”

për ndërtimin e rrugës së Përmetit, lanë punën në shenjë proteste për pagën e ulët prej tetë lekësh, të caktuar me dekret mbretëror.

11 Prill 1940:

Të vendosur përpara presionit me grevat e shumta dhe të demonstratave të punëtorëve shqiptarë, çka dëmtonte përgatitjet ushtarake për sulmin ndaj Greqisë dhe me qëllim forcimin e disiplinës së punës, italianët nxorrën një dekret kundër organizimit të demonstratave, manifestimeve, kortezheve dhe mbledhjeve. Ky dekret parashikonte dënimet më të rrepta kundër shkelësve, madje edhe pushkatim.

16 Maj 1940:

Punëtorët që punonin për ndërtimin e aerodromit të Ura Vajgurore shpallën grevë dhe kërkuan nga firma italiane që t'u paguheshin orët suplementare që kishin bërë dhe të shkurtohej orari i punës.

21 Maj 1940:

Greva e 150 punëtorëve shqiptarë që punonin për llogari të shoqërisë italiane SICAN, e cila kishte marrë përsipër bonifikimin e kënetës së Durrësit, u shndërrua në një demonstratë nëpër rrugët e Durrësit dhe para zyrave të shoqërisë, për shkak të vonesës në pagimin e mëditjeve.

Qershor 1940:

Me nxitjen e punëtorit Vaso Kadia, një grup punëtorësh të fabrikës së çimentos në Shkodër organizuan një grevë për shtimin e pagës dhe pakësimin e orëve të ditës së punës. Greva u përkrah edhe nga punëtorët e tjerë të fabrikës por drejtuesit e fabrikës nuk i morën parasysh kërkesat e tyre. Kundrejt organizatorëve u morën masa arrestimi e burgimi, kurse për grevistët e tjerë masa ndëshkuese nga më të rëndat. Pavarësisht kësaj, punëtorët e vazhduan grevën dhe fabrika pezulloi prodhimin për javë të tëra. Punëtorët pranuan të vazhdojnë punën vetëm pasi u rritën pagat.

11 Qershor 1940:

Doli dekreti për mobilizimin civil, sipas të cilit të gjithë punonjësit i nënshtroheshin disiplinës, ligjeve ndëshkimore dhe juridiksionit të tyre.

12 Korrik 1940:

Punëtorët e fabrikës së cigareve “Stamles” në Durrës, për shkak të mospranimit të kërkesës së tyre për vendosjen e 8-orëshit dhe shtimin e pagave, në shenjë proteste u hodhën në grevë. Greva u organizua dhe u drejtua nga komunistët. 18 punëtorë u arrestuan nga karabinieria dhe u pushuan nga puna 182 të tjerë. Greva të ngjashme u zhvilluan edhe në Fabrikën e Tullave të Anastasiadhit në Durrës, në Fabrikën e Lëkurëve në Gjirokastrë, në Fabrikën e Birra Korçës në Korçë, etj.

Gusht 1940:

Punëtorët e Minierës së Hekurit në Memëlisht të Pogradecit shpallën një grevë për shkak të mëditjeve të ulta dhe kushteve të rënduara të punës. Karabinieria arrestoi dy punëtorë, të akuzuar si nxitës të grevës.

7 Shtator 1940:

Për shkak të grevave të punëtorëve të ndërtimit në Elbasan e Labinot, u arrestuan në Elbasan 7 punëtorë që punonin te Shoqëria Italiane “Puriceli”, të cilët dolën para gjyqit ushtarak si organizues grevash.

24 Nëntor 1940:

Të akuzuar për organizim grevash dhe fyerje të hierarkëve italianë, arrestuan një grup punëtorësh në fermën EIAA në Shijak, një grup tjetër në Labinot, si edhe punëtorë në kantierë të ndryshëm. Ata iu përcollën gjyqit ushtarak.

1940:

Mëse 600 punëtorë të minierës së Selenicës shpallën grevë për ngritjen e mëditjeve. Greva u shtyp me forcë. Mbi 60 punëtorë u arrestuan dhe u burgosën, kurse të tjerët u detyruan të fillojnë punën.

7-15 Shkurt 1941:

Punëtorë të naftës në shoqërinë italiane “AIPA” në Kuçovë, në një mbledhje të fshehtë, vendosën t’i paraqisnin drejtorisë kërkesa për pakësimin e orëve të punës, shtimin e pagës, heqjen dorë nga gjrobat e vazhdueshme dhe për t’u dhënë bukë gruri e ushqime njësoj si punëtorëve italianë. Kërkesat e tyre nuk u morën parasysh dhe disa ditë më vonë punëtorët u hodhën në grevë, e cila përfundoi në përleshje me karabinierët. Si pasojë e qëndresës, u liruan 16 të arrestuarit dhe u pranuan tri nga kërkesat e tyre.

1, Mars 1941:

Punëtorët e sektorit të dytë të shpimit, që punonin në shoqërinë italiane AIPA, në Kuçovë, shpërthyen një grevë të përgjakshme, për të arritur plotësimin e kërkesave ekonomike.

Qershor 1941:

Punëtorët e Fabrikës së Çimentos në Shkodër organizuan një grevë për kërkesa ekonomike dhe politike. Po ashtu, u zhvillua edhe një nga grevat më të rëndësishme nga punëtorët e Kuçovës, në mbështetje të kërkesës për paga të njëjta me punëtorët italianë dhe për zhdukjen e diskriminimit kolonialist.

1941:

Nëpunësit e PTT-së së Tiranës shpallën një grevë për të protestuar kundër sjelljeve brutale të drejtorit të përgjithshëm dhe për ngritjen e rrogave. Një pjesë e tyre u arrestuan, disa u detyruan të fillonin punën, kurse ata që nuk pranuan, u burgosën.

6 Mars 1942:

Punëtorët e Vlorës, të bashkuar me fshatarët, bënë grevën e bukës, e cila, në sajë të bashkimit të tyre përfundoi me sukses. Autoritetet u shtrënguan të plotësonin kërkesat e grevistëve.

17 Gusht 1942:

Pas një mbledhjeje ilegale, të organizuar me nismën e organizatës së partisë të qytetit të Korçës, nga punëtorët më të mirë të “Shoqërisë gjeneralë elektrike”, që përfshinte Centralin Elektrik të Korçës dhe Fabrikën e Miellit, u krijua organizata e parë sindikale e Korçës gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, veprimtaria e së cilës përqendrohej në dy drejtime kryesore: 1. Në luftën për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve kundër padronëve dhe 2. Në ndihmën për luftën.

Tetor 1942:

Nën ndikimin e punëtorëve komunistë, në punishtet primitive të lëkurëve në Korçë, u organizua një grevë për të vendosur 8-orarëshin e punës dhe për një shtesë rroge prej 20 përqind. Greva pati sukses.

3 Dhjetor 1942:

U zhvillua greva e punonjësve praktikantë të Drejtorisë së Përgjithshme të PTT-së Tiranë, të cilët në shenjë proteste për mospagimin e pagave të prapambetura dhe të mosnjohjes së të drejtës së nëpunësisë, megjithëse kishin kaluar periudhën e provës, organizuan një demonstratë përpara zyrave të Mëkëmbësisë. Edhe pse u kërcënuan nga kuestura fashiste, ata pezulluan komunikacionin postar e telegrafik, deri sa iu njohën të gjitha të drejtat e tyre.

Dhjetor 1942:

Me nismën e një grupi punëtorësh komunistë, në Tiranë u bënë përgatitje për formimin e një organizate sindikale ilegale të punëtorëve rrobaqepës. Por, disa nga organizatorët u internuan në Mauthausen dhe organizata nuk u krijua.

29 Qershor 1943:

Këshilltarët, përfaqësues të 11 sindikatave të para të Korçës, të mbledhur ilegalisht, vendosën krijimin e një organi drejtues për qytetin me emrin “Këshilli Administrativ i Sindikatave Punëtore për Korçën”. Të nesërmen, ky këshill aprovoi rregulloren dhe statutin.

30 Prill 1944:

Duke qenë se disa punëdhënës nuk pranonin ngritjen e pagave, “Këshilli Administrativ i Sindikatave Punëtore të Korçës”, në mbledhjen e tij vendosi që në mbështetje të rregullores, të lejonte sindikatat të zhvillonin greva për të mbështetur kërkesat, që u ishin parashtruar punëdhënësve, në fabrika e punishte. Punëtorët fituan, atyre iu ngrit mjaft paga.

Qershor 1944:

Në Korçë u bë një nga grevat më të rëndësishme, ajo e punëtorëve të fabrikave të cigareve “Tomorri” dhe “Morava”. Ata fituan një shtesë të pagës prej 50-60 përqind.

Gusht 1944:

Punëtorët e fabrikës “Birra Korça” u hodhën në grevë. Si pasojë, koha e punës së tyre u reduktua në tetë orë në ditë. Gjithashtu, edhe punëtorët bukëpjekës, me anë të një greve, fituan një shtese page prej 30 përqind.

Shoqëria e rrobaqepësve të Korçës

“Rrobaqepësit e Korçës 90 në numër duke parë se Isnafi kish nevojë për një lidhje, mbasi mbajtnë mëshimin e përvitshme sipas zakonit, ditën e djelë 13 Gusht 1927 në Kishën e Shën-Ilisë këtu, të gjithë sa u ndodhën me një zë, vendosnë formimin e shoqërisë së tyre, duke zgjedhur një komision për të përgatitur organizimin për një kuvent të Isnafi”, shkruhet në hyrje të Statutit të Shoqërisë së Rrobaqepësve të qytetit të Korçës, hartuar më 11 shtator 1927.⁵³

53. AQSH, Statuti i Shoqëris së rrobaqepësve, qyteti Korçë, nr 5, viti 1927, d.1, f.1-7.

Në komision u zgjodhën Ilo Nuke, Vasil Nani, Kristaq Daçolli, Ligor Çani, Nikolla Peleshi dhe Mitkë Dishnica. Qëllimi kryesor i kësaj shoqërie ishte përkrahja e çdo anëtari në nevojë ose raste aksidentesh, si edhe përmirësimi i “*gjendjes*” dhe i *çpagimit të mjeshhtësisë së tyre*”.⁵⁴ Po ashtu, shoqëria nuk do të përzihej në çështje politike. Përveç faktit që ky duhej të ngelej një organizim profesional, pra apolitike, po ashtu ky kusht ishte shumë i rëndësishëm, sepse në të kundërt qeveria nuk do ta lejonte regjistrimin e kësaj shoqate. Emri zyrtar i kësaj shoqërie u vendos “Lidhja e Robaqepësve të Korçës”⁵⁵, me qendër në Korçë. Në vulën e saj u skalit imazhi i një gërshëre dhe një gome të bashkuara së bashku. Për t’i dhënë një karakter kombëtar, ngjyrat zyrtare të Lidhjes ishin e kuqja, e zeza dhe e arta.

Organizimi i shoqërisë/ Lidhjes

Sipas statutit të Lidhjes, çdo anëtar i saj kishte të drejtë të ishte cilido rrobaqepës i qytetit të qarkut të Korçës, qoftë usta rrobaqepës, qoftë punëtor. Për t’u anëtarësuar duhet të paguheshin fillimisht dy korona, çka ishte edhe kuota mujore e anëtarësisë.

Në pikëpamje organizative, Lidhja kishte një këshill prej pesë personash, një sekretar dhe një arkëtar, të cilët mbledheshin rregullisht për të shqyrtuar çdo kërkesë dhe ankim të anëtarëve. Po ashtu, edhe anëtarësia mbledhej çdo muaj. Takimi shfrytëzohej për të diskutuar për çështje të caktuara që ishin shfaqur gjatë muajit, si edhe për të paguar kuotën mujore të anëtarësisë. Në statut vërehet se çështja e mënyrës dhe rregullimit të pagesave të anëtarësisë është sanksionuar në mënyrë shumë të rreptë dhe të detajuar, si në pikëpamje të transparencës së pagesave, ashtu edhe në atë financiare: “Arkëtari porsa të mbledhë këstet detyrohet t’i depozitojë në bankë. Asnjë e drejtë vonimi nuk i jepet”, shkruhet në Nyjen 10 të këtij Statuti.⁵⁶

Të hollat e mbledhura nga anëtarësia nuk duhet të prekeshin për të paktën një vit, pas krijimit të shoqërisë, me qëllim që të

54. AQSH, Statuti i Shoqërisë së rrobaqepësve, qyteti Korçë, nr 5, viti 1927, d.1, f.1-7

55. AQSH, Statuti i Shoqërisë së rrobaqepësve, qyteti Korçë, nr 5, viti 1927, d.1, f.1-7

56. AQSH, Statuti i Shoqërisë së rrobaqepësve, qyteti Korçë, nr 5, viti 1927, d.1, f.1-7

arrihej një shumë e caktuar të hollash. Qëllimi ishte që me paratë e mbledhura të ndihmoheshin anëtarët në rast nevoje, por ama “jo fët me kërkimin e tij të parë”, thuhet në Nyjen 16 të Statutit, por atëherë kur anëtari i ndodhte një aksident i madh, si për shembull raste kur binte zjarri dhe shkaktonte dëme të mëdha ose çfarëdo aksidenti tjetër, përmasat e të cilit ia bënin të pamundur anëtarit vazhdimin e punës. Ndhimesa jepej në formën e huasë. Pasi anëtari i ndihmuar e kalonte emergjencën dhe fillonte aktivitetin e tij të zakonshëm, duhej që të kthente në rastin më të parë shumën e e parave që kishte marrë nga Lidhja: *“Moskthimi i kësaj huaje do të shtrëngojë shoqërinë ta bisedojë çështjen më mbledhje extra-ordinare dhe mbasi, të marrë vendim do kujdeset t’ia marrë me çdo mënyrë paratë e ndihmës huadhënësit”, vazhdon më tej ky Statut.*⁵⁷

Statuti, gjithashtu, rregullonte edhe marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve. Ai i detyronte anëtarët të respektonin njëri-tjetrin, të mos konfliktoheshin dhe të mbronin nderin e Shoqërisë. Po ashtu, në Shoqëri nuk mund të anëtarësohej një person me “sjellje të ligë” ose i korruptuar. Shoqata ishte kundër përdorimit të alkolit, të përfaqësonte të renë dhe të luftonte “sistemin prapanik”. Përveç karakterit shoqëror, shoqata kujdesej edhe për identitetin kombëtar: “në çdo festim kombëtar shoqëria do zërë vënt e grup në radhën e paradës me flamurin e saj në krye” thuhet në Nyjen 30 të Statutit.⁵⁸ Po me kaq kujdes parashikohej në këtë Statut edhe çështja e mjedisit dhe e kujdesit ndaj tij duke caktuar “një ditë kremtimi, në të cilën do t’i bëjë thirrje gjithë popullit që të marrë secili një filis peme e t’a mbjellë në një vënt të pa-pemësime e në një brek të qytetit. Kjo ditë do caktohet që në muajin Tetor në kohën që mbillen pemë”.⁵⁹ Shoqëria e rrobaqepësve të Korçës përveç faktit që vjen si një ndër organizimet më të hershme profesionale, më tepër më pikëpamje të organizimit të zejeve sesa atij sindikalist, bie në sy për karakterin e përgjithshëm social, profesional dhe apolitik të saj. Po ashtu, mund të themi se në këtë organizim dominon karakteri perëndimor

57. AQSH, Statuti i Shoqërisë së rrobaqepësve, qyteti Korçë, nr 5, viti 1927,d.1, f.1-7.

58. AQSH, Statuti i Shoqërisë së rrobaqepësve, qyteti Korçë, nr 5, viti 1927,d.1, f.1-7.

59. AQSH, Statuti i Shoqërisë së rrobaqepësve, qyteti Korçë, nr 5, viti 1927,d.1, f.1-7.



Anëtarë të shoqërisë Puna në Korçë

i saj. Fakti që në fund të Statutit, kryetari i Kuvendit, Naum Face, nënshkruan si “Çairman i Kuvendit”, tregon që nismëtarët e këtij organizimi vinin me një përvojë jetësore dhe profesionale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sa më sipër, prefekti i Korçës Zef Kadareja, në shkresën e tij nr. 2880, datë 8 nëntor 1927 lëshon një dëftesë, ku zyrtarizon ushtrimin e veprimtarisë së kësaj Lidhjeje: “Për lutjen e paraqitur në këtë prefekturë mbi pranimin e Statutit të Shoqërisë tyre, në bazë të nenit 6 të “Ligjit të Shoqërive” në fuqi, u lëshohet kjo dëftesë si leje me ushtrime veprimet e veta mbrenda Njave që përmban Statuti relativ”.⁶⁰

Shoqëria “Puna” e Korçës (1933–1937)

Shoqëria “Puna” e Korçës u themelua më 24 shtator 1933.⁶¹ Numri i anëtarëve të saj arriti në rreth 500 punëtorë e mjeshtër ndërtimi si, muratorë, karpentierë, suvatues, gëlqerebërës, punëtorë të tullave e të tjegullave, marangozë, teneqepunues, elektrikistë, etj. Duke

60. AQSH, Dëftesë, Shoqërisë së Robaqepësvet, 8/XI/1927. nr 5, viti 1927,d.1, f.1-7.

61. Shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 2009, fq. 2512-2513.



Kuçovë

qenë se në të u përfshinë thuajse të gjithë profesionet aktive në fushën e ndërtimit, ajo u quajt Shoqëria profesionale e mjeshtërve për ndërtime godinash “Puna”. Kryetar i Shoqërisë u caktua Petro Papi, i cili ishte anëtar i Grupit Komunist të Korçës. Gjithsesi, në statut theksohej se Shoqëria nuk do të merrej me veprimtari politike. Qëllimi i saj, sipas statutit legal, ishte mbrojtja, ndihma morale e materiale e anëtarëve të saj dhe ruajtja e dinjitetit njerëzor të punëtorëve.⁶²

Në pikëpamje organizative, kjo shoqëri drejtohej nga Këshilli Drejtues, me kryetar Pilo Peristerin. Shoqëria “Puna” zhvilloi një veprimtari të gjerë e të gjallë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe mori pjesë aktive në organizimin e drejtimin e lëvizjes greviste në Korçë. Veprimtaria e saj ishte e gjerë, që nga ndërhyrjet për rastet kur anëtarëve të saj nuk u paguhej paga ose u paguhej më pak nga sa ishte marrëveshja e deri tek organizimi i grevave për përmirësimin e kushteve të punës dhe të nivelit të jetesës së tyre. Kërkesat e vazhdueshme të saj kundër papunësisë,

62. Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 2009, fq. 2512-2513.

kundër arbitraritetit të punëdhënësve, që i hidhnin punëtorët në rrugë, për kontrollin e tregtisë së drithit, të blojës dhe të çmimeve të bukës, për uljen e orëve të punës, përmirësimin e kushteve të punës, për zëvendësimin e sistemit angari në mirëmbajtjen e rrugëve me taksa progresive në të holla, për hapjen e punimeve botore me leverdi për ekonominë e vendit, etj., e vinin qeverinë në pozita të vështira. Shoqëria “Puna” mori pjesë edhe në luftën për demokratizimin e këshillit bashkiak, të atij të Dhomës së Tregtisë, në zgjedhjet e kryepleqve dhe deputetëve, etj. Qeveria, duke e konsideruar të dëmshme dhe me rrezik veprimtarinë e shoqërisë, e shpërndau atë me 27 shkurt 1937.

Shoqëria “Puna” e naftëtarëve (1935–1936)

Shoqëria “Puna” filloi të organizohet në fillim ilegalisht më 1934. Nismën për krijimin e saj e morën disa punëtorë që kishin njohuri për organizimin e jetës sindikaliste në vendet e Europës Perëndimore, si pasojë edhe e eksperiencave të tyre si punëtorë në këto vende. Kushtet e punës dhe të jetesës së punëtorëve ishin të vështira. Mungonin tërësisht banesat dhe mensat për punëtorët. Po ashtu, pagesa ditore prej 5-6 lekësh ishte shumë e ulët, ndërkohë që punohej 12 orë në ditë. Më tej, punëtorët shqiptarë i nënshtroheshin edhe një farë presioni ideologjik nga drejtuesit e tyre italianë të shoqërisë AIPA⁶³, sikurse ishte detyrimi për të përshëndetur në mënyrë “alla fashiste”, mosrespektimi i ditëve të pushimit për festat kombëtare, etj.

Duke jetuar e punuar në këtë situatë të vështirë punëtorët e Kuçovës e ndienin dhe kërkonin të organizoheshin për të mbrojtur të drejtat e tyre të nevojshme dhe të domosdoshme, çka u konkretizua në ngritjen e këshillave të punëtorëve.⁶⁴ Në tetor të vitit 1935 u zhvillua një mbledhje e gjithë këshillave, ku merrnin

63. AIPA (Azienda Italiana Petroli Albania - Ndërmarrja Italiane e Naftës Shqiptare, 1925–1945). Shoqëri koncesionare e krijuar me kapital shtetëror italian në vitin 1925. Kishte mision zbulimin dhe shfrytëzimin e naftës shqiptare. Zhvilloi veprimtari relativisht të gjerë. Zbuloi dhe vuri në shfrytëzim pellgun naftëmbajtës të Kuçovës, bëri investime për ndërtimin e naftësjellësit Kuçovë–Vlorë, nëpërmjet të cilit eksportoi naftën shqiptare në Itali. Me marrëveshje zyrtare mori përsipër të ndërtonte në vend edhe një fabrikë të përpunimit të naftës, por nuk e bëri. (Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 2009, f. 29.

64. AQSH.Nga historia e lëvizjes të punëtorisë s’ onë. F.Koleksioni i Partisë, Organizatave dhe Shoqërive, nr 447, viti 1936,d.77.f.1-4



Kuçovë

pjesë rreth 60 vetë. Aty u vendos që “të bëheshin kërkesa me anë lutjesh Parlamentit, Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme; si u përpiluan kërkesat, u bë një agjitacion i madh me punëtorët për organizimin e tyre në një shoqëri punëtorësh me një program të caktuar”.⁶⁵ Si rrjedhim, më 1 nëntor 1935, me nënshkrimin e 5 punëtorëve, që ishin autorizuar nga 1600 punëtorët e tjerë, u dërgua në Parlament kërkesa për lejimin e themelimit të shoqërisë “Puna”.

Si datë e themelimit të kësaj shoqërie njihet data 18 tetor 1935, kur u mbajt edhe mbledhja themeluese. Fillimisht ajo përfshiu në gjirin e saj 680 anëtarë, më vonë i zgjeroi radhët në gjithë territorin e shoqërisë AIPA, duke përfshirë dhe punëtorët e

65. AQSH.Nga historia e lëvizjes të punëtorisë s'onë. F.Koleksioni i Partisë, Organizatave dhe Shoqërive, nr 447, viti 1936,d.77.f.1-4

Ujit të Ftohtë të Vlorës e gjetkë, duke e rritur numrin e punëtorëve të organizuar deri në 3000 veta.⁶⁶

Kjo shoqëri, e cila në statutin e vet u emërtua “Shoqëria punëtore e Kuçovës dhe e qarkut “Puna”, hartoi një program të gjerë që i mobilizoi naftëtarët në kërkimin e të drejtave themelore të tyre. Menjëherë pas krijimit të saj, Shoqëria organizoi më 18 nëntor 1935 grevën e parë njëditore kundër shfrytëzimit e arbitraritetit të sipërmarrësve, për shtimin e mëditjes e përmirësimit e kushteve të punës e të jetesës së punëtorëve. Shkak i organizimit të saj ishte pushimi nga puna pa arsye i disa punëtorëve. Greva përfundoi me fitore. Të gjithë punëtorët e pushuar nga puna u morën përsëri në punë, u shtua paga e tyre dhe u pakësua orari i punës. Por veprimtaria e naftëtarëve i zemëroi shumë sipërmarrësit dhe autoritetet, të cilët nuk linin rast pa goditur punëtorët e sidomos udhëheqësit e shoqërisë “Puna”, një pjesë të mirë të të cilëve i nxorrën nga puna. Nga organet qeveritare u kërkua largimi nga Kuçova i më se 50 punëtorëve, më aktivët e shoqërisë “Puna”. Kundër këtyre masave, më 11 shkurt 1936, punëtorët u hodhën në grevë të përgjithshme, që zgjati tri ditë. Kjo grevë përbën kulmin e veprimtarisë së kësaj shoqërie. Shoqëria AIPA alarmoi Romën se punëtorët shqiptarë përbënin një rrezik serioz për të. Qeveria Shqiptare vuri në lëvizje xhandarë e funksionarë. Vetë Ministri i Punëve të Brendshme Ethem Toto urdhëroi shpërndarjen e punëtorëve, arrestimin e 60 prej tyre dhe largimin nga qyteti të më se 30 të tjerëve.⁶⁷ Pas këtyre masave ekstreme praktikisht edhe shoqëria pushoi së vepruari.

Statuti

Në nenin 2 të statutit shprehet qartë se Shoqëria “Puna” është apolitike dhe ka për qëllim ruajtjen e dinjitetit dhe mbrojtjen

66. Në vitin 1925 qeveria e A. Zogut u dha në koncesion shoqërive italiane, franceze, angleze dhe amerikane një sipërfaqe prej rreth 380 mijë ha për kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës. Më 1926 filloi shpimi i puseve të kërkimit. Pusi i parë në Kuçovë dha naftë në vitin 1928; në vitin 1929 u nxorën 750 ton. Më 1930 koncesionet mbetën vetëm në duart e shoqërive të ndryshme italiane (AGIP, AIPA). Në vitin 1934 në vendburimin e Kuçovës u nxorën 9240 ton naftë, çka shënoi edhe fillimin e industrisë së naftës në Shqipëri. Me përfundimin e naftësjellësit Kuçovë–Vlorë (Uji i Ftohtë), në dhjetor 1935, filloi eksporti i naftës shqiptare për në Itali. Në vitin 1940 u nxorrën 144,306 ton naftë, ndërsa në vitin 1941 prodhimi arriti në 148 mijë ton. Filluan edhe shpimet pranë fshatit Patos për vënien në shfrytëzim të këtij vendburimi, por pa ia arritur qëllimit. Ushtria gjermane gjatë largimit nga qendrat naftëmbajtëse të Kuçovës dhe Patosit hodhi në erë shumë instalime të industrisë së naftës, duke e nxjerrë praktikisht jashtë përdorimit. Rimëkëmbja e industrisë së naftës ishte një ndër masat e para të qeverisë së pas luftës.

67. Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 2009, f. 2513.

morale dhe materiale të anëtarëve të saj. Pra, ky organizim nuk kishte asnjë qëllim politik, ndonëse në përbërje të shoqërisë kishte elementë komunistë.

Për të arritur qëllimin e themelimit të saj, shoqëria vendosi krijimin e një fondi financiar për t'i ardhur në ndihmë anëtarëve të sëmurë të saj, si edhe ata anëtarë që mbeteshin përkohësisht pa punë. Sigurisht që kjo nismë tepër solidarizuese ishte e vështirë për t'u realizuar, duke pasur parasysh kohën e shkurtër që kjo shoqëri funksionoi sikurse edhe vështirësitë financiare të anëtarëve të saj. Në këtë shoqëri duhej të përfshiheshin gjithë punëtorët shqiptarë të Prefekturës së Beratit dhe të viseve të tjera pranë shoqërive koncensionare të Vajgurit që *“punojnë në dipendencë të Shoqërive të nalt-përmendura”* thuhet më tej në pikën tre të këtij statuti.⁶⁸

Për t'u regjistruar në shoqëri nevojitej pagesa e një tarife fikse, prej 0.40 franga ari. Anëtari pajisej me një librezë anëtarësie. Më tej, anëtari i shoqërisë duhej të paguante edhe një kontribut mujor, i cili ishte 1% i pagës mujore.

Në pikëpamje organizative, organi më i lartë i shoqërisë ishte Kuvendi i Përgjithshëm, i cili përbëhej nga të gjithë anëtarët e saj. Kuvendi mblidhej një herë në vit, çdo fillimviti. Por, Kuvendi mund të mblidhej edhe në raste të jashtëzakonshme, kur e kërkonte Këshilli ose kur e kërkonin të paktën 100 anëtarë. Në Statut dominonte fryma kolegjiale. Kësisoj, për ndryshimet statutores duheshin të paktën $\frac{3}{4}$ e votave të të gjithë anëtarësisë që merrnin pjesë në mbledhje. Por, neni dy i këtij statuti, ku sanksionohej se *“Shoqëria Puna është apolitike dhe ka për qëllim ruajtjen e dinjitetit, mbrojtjen dhe ndihmën morale dhe materiale të anëtarëve të saj”*, ishte i pandryshueshëm dhe i panegociueshëm.⁶⁹

Shoqëria administrohej prej një këshilli të përbërë prej 20 punëtorësh, të cilët zgjidheshin nga Kuvendi. Kuvendi mund të zgjidhte si këshilltarë edhe persona që nuk ishin anëtarë të shoqërisë. Gjithsesi numri i tyre ishte i kufizuar, jo më shumë se

68. AQSH, Statuti i Shoqërisë “Puna” – Kuçovë. Nga historia e lëvizjes të punëtorisë s'onë. F.Koleksioni i Partisë, Organizatave dhe Shoqërive, nr 447, viti 1936, d.77. f.1-4.

69. AQSH, Statuti i Shoqërisë “Puna” – Kuçovë. Nga historia e lëvizjes të punëtorisë s'onë. F.Koleksioni i Partisë, Organizatave dhe Shoqërive, nr 447, viti 1936, d.77. f.1-4

katër të tillë. Më tej, Këshilli mblidhej një herë në dy muaj. Detyra e tij ishte përcaktimi i aktivitetit të shoqërisë, pranimi i anëtarëve të rinj, përjashtimi i anëtarëve që nuk paguanin të paktën tre muaj rresht kontributin mujor, që nuk u bindeshin vendimeve të Kuvendit apo këshillit, ose që më sjelljen e tyre përgjithësisht nuk e meritonin mbetjen anëtarë të shoqërisë.

Këshilli zgjidhte çdo vit një kryetar, një sekretar, një arkëtar dhe tre anëtarë, të cilët së bashku formonin “Komitetin Dirigjues të Shoqërisë”. Ky Komitet mblidhej çdo javë dhe në fund të vitit hartonte një raport për Këshillin, për të dhënë llogari për shpenzimin e të ardhurave të shoqërisë.

Sindikalizmi shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore

Shqipëria ishte një nga viktimat e para të të ashtuquajturit rend i ri fashist dhe konfigurimit të hartës gjeopolitike që Fuqitë e Boshtit dëshironin t’i jepnin botës. Menjëherë pas pushtimit filluan masat për fashistizimin e shpejtë të vendit. Motoja e regjimit fashist në Shqipëri ishte: “Besim, bindje, luftë”. Ajo u përhap në mënyrë kapilare në shoqërinë shqiptare të kohës në të gjitha format e organizimit fashist, si, organizatat “Bijtë dhe Bijat e Shqiptarëve», që përfshinte moshën nga 6 deri në 8 vjeç, “Balilla” nga 8 deri në 13 vjeç (kishte vetëm djem), ndërsa vajzat e po kësaj moshe quheshin “Shqiptarkat e Vogla”. Grupmosha e tretë, 13-17 vjeç, quheshin “Avanguardistë” për djem dhe “Shqiptaret e reja” për vajzat. Grupmosha e katërt, nga 17-21 vjeç, quheshin “Fashistët e rinj” ose “Fashistet e reja”. Të rinjtë shqiptarë që studionin në universitetet italiane ishin të organizuar në “Grupet universitare fashiste”. Pranimi në organizatat fashiste bëhej pas betimit “Në emër të Zotit e të Italisë betohem se do të ndjek urdhrat e Duçes për t’i shërbyer me të gjitha forcat e mia, po të jetë nevoja, edhe me gjakun tim çështjes së Revolucionit.”⁷⁰ Ekonomia shqiptare dominohej kryesisht prej italianëve dhe vendi kishte hyrë në të ashtuquajturin progres kolonial. Shfrytëzimi i burimeve minerale,

70. Paskal Milo, Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore, Toena, Tiranë, 2014, f. 70.

ndërtimi i rrugëve strategjike, krijimi i një habitati social, ku ndihej dora e shtetit krijoi përshtypjen e gabuar se Shqipëria duke falur pavarësinë e saj po hynte në rrugën e progresit. Kapitali italian pati dominuar për shumë vite me radhë dhe në të gjitha fushat në Shqipëri, por pas 7 prillit ai vendosi sistemin e monopolit në ekonominë shqiptare. Nëse para pushtimit në Shqipëri ishin të pranishme 15 shoqëri të mëdha italiane, një vit më vonë numri i ndërmarrjeve italiane arriti në 140 dhe në mars të vitit 1942 në 366.⁷¹ Italianët nisën të bënin shumë investime. Ata investuan në ndërtimin e godinave, të rrugëve, të zgjerimit dhe modernizimit të porteve dhe aeroporteve, veçanërisht në atë të Durrësit. U projektua dhe filloi nga puna ndërtimi i hekurudhave Tiranë-Durrës e Durrës-Elbasan. U shtua prodhimi i energjisë termoelektrike dhe u bënë studime për shfrytëzimin e burimeve të pasura hidroenergjitike të vendit. Kështu, u hapën 160 kantiere ndërtimi, 450 km rrugë të asfaltuara, ujësjellës të rinj në Tiranë, Korçë, Durrës, Vlorë e Berat e së shpejti, shkruante Çiano, edhe në Fier e në Shkodër. Interesi ekonomik italian, pavarësisht nga motivet, përkohësisht u përputh me një zhvillim e gjallërim edhe të ekonomisë shqiptare e për rrjedhojë ndikoi edhe në përmirësimin e nivelit të jetesës së shqiptarëve. Investimet e gjithanshme që u bënë, hapën shumë fronte pune dhe u punësua krahu i lirë i punës jo vetëm në qytete por edhe në zonat rurale.⁷² Për rrjedhojë u rrit dhe numri i fuqisë punëtore në Shqipëri të përfshirë në këto sipërmarrje industriale, baza e së cilës vinte kryesisht nga zonat rurale. Radhët e saj filluan të mbushen dhe me zejtarë të rrënuar nga konkurrenca e mallrave italiane që filluan të mbushin tregun. Vetëm në Elbasan, që më 7 prill 1939 deri më 8 shkurt 1940, u mbyllën 25 dyqane këpucëbërësish, 23 -rrobaqepësish, 16 -bakërpunuesish, 5 - çorapepunuesish. 24 kovaçësh, 6 -argjendarësh. 15 punishte marangozash. 2 punishte sapuni, etj. ⁷³ Më 1943, sipas një statistike të Bankës Kombëtare të

71. Galeazzo Çiano di Cortellazo, Misioni historik i Shqipërisë së Madhe, Botime "Distapur", Tiranë 1942, f. 5-6; Paskal Milo, Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore, Toena, Tiranë 2014, f. 62-63.

72. Paskal Milo, Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore, Toena, Tiranë, 2014, f. 65.

73. AQ i RPSH, Fondi i Ministrisë së Ekonomisë, Raport i Odës së tregëtisë në Elbasan, dt. 8.2.1940.

Shqipërisë, në të 203 ndërmarrjet industriale të Shqipërisë me një fuqi motorike prej rreth 3000 Hp. kishte 12.906 punëtorë të ndarë si vijon:

Dega e industrisë	Numri i ndërmarrjeve	Numri i punëtorëve e nënpunësve
Industria të lidhura me bujqësinë	4	3760
“ Ekstraktive	25	5339
“ ushqimore, etj	39	854
“ e drurit, etj.	42	790
“ lëkure, etj.	12	190
“ metalurgji, siderurgji	2	27
“ mekanike	12	316
“ minerale jo metalike	16	615
“ tekstile	6	230
“ kimike	31	618
“ prodhim e shpërndarje drite	14	167
Gjithsej:	203	12.906

Në këtë numër nuk figuronin punëtorët e ndërtimit, të transportit, të tregtisë, si dhe nëpunësit e administratës e të institucioneve bankare, etj. Po kështu nuk dihet saktë sesa ishte numri i fuqisë punëtore i përfshirë në punimet botore (rrugë, aerodrome, porte, etj).⁷⁴ Ndërkohë përpos rritjes në numër të kësaj fuqie punëtore dolën në dritë dhe protestat dhe organizimet e para sindikaliste në Shqipëri. Këto organizime dhe protesta kishin karakter të dyfishtë: sindikalist dhe antifashist. Në maj 1939 punëtorët tipografë të Tiranës, që punonin nga 13 orë në ditë bënë greva për të kërkuar uljen e kohës së punës në 8 orë në ditë. Greva zgjati 3 ditë. Në qershor, 1939,

74. Kristaq Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1970, f. 333.

37 punëtorë të ngarkim-shkarkimit në skelën e Vlorës shpallën grevë për të mbështetur kërkesën e tyre për ngritjen e pagave. Greva pengoi shkarkimin e armatimeve dhe të mjeteve të tjera të nevojshme për makinën e luftës, prandaj kundër grevistëve ndërhyri me forcë karabineria. Mbas greva nuk mori fund, udhëheqësit e grevës u arrestuan dhe u proceduan në gjyqin ushtarak. Më 24 tetor 1939, mbi 200 punëtorë të Minierës së Selenicës shpallën grevë për të protestuar kundër taksës së re, që ishte baraz me pagën e tri ditëve, dhe kundër pagave të ulëta. Pasi autoritetet fashiste nuk i bindën dot, punëtorët, për të rifilluar punën, karabineria arrestoi 12 punëtorë nga udhëheqësit e grevës. Megjithatë greva vazhdoi edhe dy ditë derisa shoqëria kapitaliste pranoi pjesërisht kërkesën e punëtorëve. Kundër kësaj takse pati edhe greva të tjera më të vogla. Dy-tri ditë më vonë shpallën grevë, kundër pagave të ulëta punëtorët e Minierës së Rubikut.⁷⁵ Regjimi i ri fashist që u instalua në Shqipëri për të ruajtur monopolin e kontrollit të zhvillimit ekonomik të vendit ndërmori dhe rregullime ligjore për të mbrojtur kapitalin italian. Me dekretin e Mëkëmbësisë të 2 qershorit 1939, pranë industrive dhe shoqërive kapitaliste shqiptare u vendosën komisarë të shtetit që kishin të drejtë t'i mbyllnin ndërmarrjet shqiptare po që se aktiviteti i tyre do të vinte në kundërshtim me interesat e pushtuesit.⁷⁶ Mes organizimeve të rëndësishme të protestave të punëtorëve shquajnë ato të organizuara në qendrat, ku kishte një përqendrim të fuqisë punëtore si Durrës, Kuçovë dhe Selenicë. Më 12 korrik 1940, punëtorët e Fabrikës së Cigareve «Stamles» në Durrës paraqitën një kërkesë të re për 8 orë punë në ditë dhe për shtimin e pagave në masën prej 25% për specialistët dhe 50% për punëtorët. Kërkesa iu drejtua me shkrim drejtorisë nga një komision i caktuar nga punëtorët. Drejtori, arrogant e brutal, ua grisi para syve kërkesën dhe i dëboi punëtorët nga zyra me të shara dhe të bërtitura. Në shenjë proteste të gjithë punëtorët, mbi 300 veta, lanë punën dhe dolën në oborr... Me kërkesën e drejtorisë së ndërmarrjes ndërhyri karabineria, e cila arrestoi 18 vetë ndër të cilët edhe anëtarët e komisionit drejtues të grevës. Drejtorja shpalli

75. Kristaq Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1970, f. 345.

76. Kristaq Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1970, f. 330.

një listë për pushimin nga puna të 182 punëtorëve. Por megjithatë greva vazhdoi deri sa punëtorëve iu shtuan pagat dhe punëtorët e pushuar u rimorën përsëri në punë. Pas kësaj greve shoqëria “Stamles” u detyrua të nxirrte një rregullore që u njihte punëtorëve disa të drejta.⁷⁷ Autoritetet pushtuese italiane për të siguruar rendin publik ndërmorën masa të karakterit administrativ që reflektonin sa gjendjen e brendshme politike në Shqipëri, po aq dhe zhvillimet ndërkombëtare. Në kuadër të agresionit italian ndaj Greqisë për të pasur prapavija të qeta, Ministria e Punëve të Brendshme nxori një qarkore, me anën e së cilës ndalonte lëvizjen e punëtorëve nga një rreth në tjetrin pa autorizim të posaçëm të autoriteteve kompetente⁷⁸. Pas dy muajsh, më 11 prill 1940, Mëkëmbësia në Tiranë u detyrua të nxirrte dekretin kundër demonstratave, manifestimeve, kortezheve dhe mbledhjeve⁷⁹. Për manifestimet në raste festash zyrtare, sipas këtij dekreti, duhej një leje e posaçme dy ditë përpara festës. Karabinieria do të caktonte vendin dhe modalitetet e tjera. Pikërisht dy muaj më vonë, më 11 qershor 1940, doli dekreti tjetër mbi mobilizimin civil. Sipas nenit 3 të këtij dekreti të gjithë punonjësit në moshë 14 vjet e lart, pa përjashtim, i nënshtroheshin disiplinës, ligjeve ndëshkimore dhe juridiksionit të saj. Sipas nenit 4 të këtij dekreti një punëtor po të mungonte nga puna më tepër se 24 orë ose po të mos kthehej nga leja, brenda kohës që i ishte caktuar, dënohej me ndëshkimin e caktuar prej Kodit Penal Ushtarak për faj arratisjeje. Sipas neneve 5, 6, 7, çdo kundërshtim, mosbindje, fyemje e eprorëve, dënoheshin me burgime të ndryshme. Sipas nenit 9, kushdo që sillte pengime në punime, ose me dashje a me dredhi, kryente gabime në punimet, ose prishte materialin që i ishte besuar, ndëshkohej me burgim të rëndë, sipas fajit, por jo më pak se shtatë vjet. Sipas nenit 10 ata që për t’ju shmangur detyrimeve të mobilizimit civil e kishin bërë veten të sëmurë ose të gjymtuar, dënoheshin sipas Kodit Ushtarak. Sipas nenit 11, në qoftë se aktet indisciplinore ose sabotimet kryheshin në marrëveshje midis tri ose më shumë personash, dënimi shtohet prej gjysmës deri në dy të

77. Kristaq Misha, Lëvizja punëtorë në Shqipëri, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1970, f. 346.

78. AQ i RPSH, Fondi i M. Punëve të Brendshme. Qarkore Nr. 1143, dt. 21.2.1940 cituar sipas Kristaq Misha, Lëvizja punëtorë në Shqipëri, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1970, f.340

79. Fletorja Zyrtare Nr. 67, dt. 16.10.1940.

tretat.⁸⁰Protestat nxiteshin nga komunistët. Kësisoj, grupi komunist i Shkodrës nxiti në fillimvitin 1941 disa protesta, ku përfshiheshin grupe shoqërore të ndryshme. Nga Shkodra, 28 zejtarë kërkonin me anë të një telegrami drejtuar qeverisë që të ndërhynte sepse “rreth 500 familje, që jetonin me zejet e duhanit po kalonin momente të rënda për shkak të mungesave dhe papunësisë; mbi 300 kryefamiljarë kishin 10 ditë pa punë nga qëndrimi neglizhenti i administratorëve dhe sipërmarrësve italianë”.⁸¹ Më tej, 14 nëpunës të Postëtelegrafës së Shkodrës i drejtuan Mëkëmbësit të Mbretit një protestë të gjatë, ku shkruhej se “padrejtësitë janë tue na e shtue në këtë kohë, shtypjet, kërcënimet, sulmi i këshillit të administratës kundër nëpunësve të pambrojtur, shpërndorimet tashmë të njohura me bajrak të drejtuesve të përmendun, inati dhe disorganizimi i administratës që sa vete po shtohet mbi kurriz të shëndetit dhe të jetës sonë, na kanë çue në ato kondita sa mos me mujt me vijue ma si nëpunësa postëtelegrafe”.⁸² Ishte paradoksale që edhe pse PKSHP do ta konsideronte veten si partia e klasës punëtore, gjatë periudhës së pushtimit italian të Shqipërisë, nuk do të arrinte të organizonte greva dhe organizime të mirëfillta sindikaliste. Njoftime të ndryshme historike që janë shënuar në historiografinë e shkruar gjatë regjimit komunist mbi sabotimet e ndryshme në ndërmarrjet industriale në Kuçovë dhe Selenicë ishin larg frymës së sindikalizmit dhe nënvizonin karakterin terrorist që kishte fituar lëvizja komuniste shqiptare si pasojë e ndjekjes së kursit stalinist. Organizim të mirëfilltë sindikalist gjatë kësaj periudhe gjejmë vetëm në qarkun e Korçës. Në fillim të vitit 1943, në mbledhjen e Komitetit të Partisë për qarkun e Korçës, që u bë në Kucakë e pastaj në Vithkuq, mbledhje në të cilën morën pjesë edhe anëtarë të Komitetit Qendror, u vendos që të krijoheshin sindikatat ilegale, sipas degëve të prodhimit: sindikata e punëtorëve rrobaqepës, këpucarë, hekurxhinj, shoferë, punëtorë të tregtisë, sindikata e garsonëve të kafeneve, restoranteve e hoteleve dhe sindikatat e punëtorëve të ndërtimit, të ndara në sindikatën e marangozëve, të

80. Kristaq Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1970, f. 348.

81. Nikollë Loka, Tuk Jakova – Jeta dhe vepra, “Grand Prind”, Tiranë 2017, f. 51.

82. Nikollë Loka, Tuk Jakova – Jeta dhe vepra, “Grand Prind”, Tiranë 2017, f. 51.

bojaxhinjve dhe të suvaxhinjve. Nga ana tjetër punëtorët e qendrave industriale më të rëndësishme, si fabrika e cigareve “Tomorri” dhe “Morava”, fabrika “Birra Korça”, Shoqëria Gjenerale e Elektrikut, fabrikat e trikotazhit, fabrikat e lëkurëve dhe punëtorët e Minierës Mborje-Drenovë formuan organizata të veçanta. Më vonë formuan sindikatat e tyre edhe punëtorët e tregtisë ushqimore (bakejve) punëtorët e punishteve dhe fabrikave të lëkurëve, punëtorët e tregtisë së veshmbathjes (manifakturës). punëtorët teneqexhinj, berberët, etj.⁸³ Disa muaj më vonë, të dielën, më 29 qershor 1943, këshilltarët përfaqësues të 11 sindikatave të para, në prani të të deleguarve të Komitetit qarkor të partisë dhe Këshillit Nacionalçlirimtar të qytetit u mblodhën ilegalisht në një shtëpi në qytetin e Korçës dhe vendosën krijimin e një organi drejtues për qytetin me emrin “Këshilli Administrativ i Sindikatave punëtore për Korçën”. Mbledhja përfundoi me zgjedhjen e këshillit të përbërë prej 7 anëtarësh dhe 3 kandidatësh dhe një komisioni kontrolli (revizioni) prej 3 vetash.⁸⁴ Organizata Sindikale e Korçës ishte një organizatë që kishte një statut dhe rregullore të aprovuar nga Këshilli Administrativ i Sindikatës. Rregullorja përbëhej prej 21 pikash. Statuti dhe rregullorja e organizatës sindikaliste u miratuan më 30 qershor 1943. Sindikatat ilegale të Korçës, me anë të rregullores dhe të statutit, që u shtypën në një broshurë të vogël të shaptilografuar, caktuan si detyrë luftën për kushte pune e jetese më të mira, që do të arriheshin me triumfin e luftës. Rregullorja ndër të tjera caktonte këto kërkesa imediate të punëtorëve:

Rroga të mjaftueshme për t’u bërë ballë nevojave të jetës (neni 1). “Punë për të papunët” (neni 2). Në punëra të rënda nuk kanë për t’u pranuar djelmsha, që nuk kanë mbushur 16 vjeç (neni 6). “Punëtorët, me t’u filluar puna, duhet që t’u paguhet rroga edhe sikur të jenë fillestarë në atë profesion” (neni 7). “Para se padroni të vendosë largimin e ndonjë punëtori lipset të lajmërojë para 15 ditëve, duke i treguar arsyen e largimit nga puna” (neni 8). “Çdo punëtor ka të drejtë të marrë leje nga padroni 2 javë në vit” (neni 9). “Gjithë farët e punëve duhet të kontrollohen nga pikëpamja

83. Kristaq Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1970, f. 366.

84. Kristaq Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1970, f. 366.

higjenike” (neni 10). Çdo punëtor ka të drejtë një ditë pushimi në javë. Në rast se padronit i shfaqet nevoja të punojë dhe ditë pushimi, punëtorit duhet t’i paguhet dubël. Në rast se padronit kjo punë i shfaqet, shpeshherë, punëtori duhet të refuzojë që të shtrëngohet padroni të marrë punëtorë të tjerë (neni 12). “Në rast se sëmuret ndonjë punëtor për një kohë prej 2 muajsh padronit i kërkohet ndihmë sipas fuqisë së tij” (neni 13). “Atje ku është fituar dita e 8 orëve duhet të respektohet nga çdo anëtar me këmbëngulje” (neni 17).⁸⁵

Rregullorja reflektonte zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike në prodhim në Shqipëri që ishin ende një kombinim midis traditës së esnafëve dhe zhvillimit të sipërmarrjeve moderne. Neni 7 ishte qartazi një reagim ndaj punës së papaguar të ndihmësve (çirakëve) në dyqanet e mjeshtërive, por edhe disa nene të tjerë reflektonin probleme që në botën perëndimore ishin zgjidhur që para shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore, siç ishin ditë pushimi në javë ose ndalimi i punës së të miturve. Sindikata punëtorë për Korçën vazhdoi të jetë aktive edhe nën pushtimin gjerman, madje ndërmori dhe aksione sindikaliste për ngritjen e pagave të punonjësve. Duke u mbështetur në nenin 11 të rregullores Këshilli Administrativ i Sindikatës më 2 shkurt 1944 i dërgoi një letër 30 firmave industriale dhe tregtare të qytetit dhe më vonë edhe pronarëve të tjerë, me anën e të cilave, në emër të punëtorëve, kërkonte që të shtoheshin pagat. Letra bënte një analizë të kostos së jetesës dhe provonte faktin që me pagën e ulët që merrte, punëtori nuk arrinte të siguronte jetesën as për disa ditë të muajit. Shumica e punëdhënësve pranuan të bënë shtesën e pagave, por pati edhe të tjerë që ose nuk pranuan ose bënë shtesa fare të vogla. Disa punëdhënës propozuan lidhjen e kontratave kolektive, të cilat nuk u pranuan nga këshilli, për arsye se kushtet e propozuara u gjendën në dëm të punëtorëve. Duke qenë se disa punëdhënës nuk pranuan ngritje pagash. Këshilli administrativ, duke u mbështetur në rregulloren, vendosi, në mbledhjen e 30 prillit 1944, që të lejonte sindikatat të zhvillonin greva për të

85. AQSH, Rregullorja e Sindikatave punëtorë për Korçën, cituar sipas Kristaq Misha, Lëvizja punëtorë në Shqipëri, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1970, f.366.

mbështetur kërkesat ndaj punëdhënësve. Rregullorja përcaktonte se për “punëtorët e çdo sindikate qoftë, pa marrë më parë pëlqimin e këshillit administrativ, nuk mund të lejohej greva” (neni 14)⁸⁶. Më poshtë rregullorja përcaktonte se “për Ditët pa punë, që vazhdonte greva dhe fitohej prej punëtorëve, duhet të paguhej rroga” (neni 15). “Çdo grevëthyes dënohej prej këshillit administrativ” (neni 16) dhe më në fund rregullorja përcaktonte se mund të lejoheshin grevat vetëm atëherë, kur dukej qartë se rroga ishte tepër e ulët. Kështu filluan një sërë grevash në fabrika e punishte, me anën e të cilave punëtorët fituan ngritje të rëndësishme të pagave. Një nga grevat më të gjata ishte ajo e punëtorëve të fabrikës së trikotazhit të Vëllazërisë Kajno, në prill 1944. Kërkesa e punëtorëve për një shtesë prej 50% nuk pranohej nga punëdhënësit, prandaj greva zgjati tri javë deri sa punëdhënësi kapitulloi. Një qëndresë aq e gjatë e një numri relativisht të madh punëtorësh u bë e mundur dhe nga krijimi i fondit të solidaritetit, me anën e të cilit punëtorët u ndihmuan me 1360 fr. shq. dhe sende ushqimore. Të tjera greva të rëndësishme ishin: ajo e punëtorëve të fabrikave të cigareve “Tomorri” dhe “Morava”, në fund të qershorit 1944, me anën e së cilës punëtorët fituan një shtesë të pagës prej 50-60%; greva e punëtorëve të fabrikës “Birra Korça” në gusht 1944, me anën e së cilës punëtorët fituan të drejtën e uljes së orarit të punës në 8 orë në ditë, greva e punëtorëve furrxhinj, gjithashtu, në muajin gusht, me anën e së cilës ata fituan një shtesë të pagave prej 30%, etj. Në sajë të kërkesave të organizuara dhe të grevave, shumica e punëtorëve fitoi shtesa prej 30-60%, një orar pune të kufizuar dhe shumë nga kërkesat e përcaktuara në rregullore. Sindikata i jepte rëndësi edhe parimit tjetër të rëndësishëm sindikalist që kishte të bënte me shprehjen e solidaritetit sindikalist në raste të jashtëzakonshme ose në raste fatkeqësie. Në dhjetor 1943, iu dha ndihma 10 punëtorëve të vobegtë me shumë fëmijë. Muajin tjetër një numri të rëndësishëm punëtorësh iu nda miell. Nga fillimi i vitit 1944 u organizuan ndihma mjekësore edhe me barna falas për familjet e punëtorëve më të varfër.⁸⁷

86. AQSH. Rregullorja e Sindikatave punëtore për Korçën, cituar sipas Kristaq Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1970, f. 367.

87. Kristaq Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1970, f. 368.

Sindikata punëtore për Korçën duke qenë një organizim i mbështetur nga komunistët përveçse aktivitetit të saj sindikalist u përfshi dhe në rezistencën antifashiste në vend. Kjo përfshirje dhe ndihmë ndaj rezistencës antifashiste ishte sanksionuar që në hyrje të programit të organizatës ku thuhej: “Duke marrë parasysh Luftën nacionalçlirimtare, e cila nesër, në një Shqipëri të lirë, demokratike, popullore, do të përmirësojë patjetër të drejtat e klasës punëtore, të ndihmojë sot luftën nacionalçlirimtare ...”⁸⁸ Kjo përfshirje në lëvizjen antifashiste shkonte krah për krah dhe me përkujtimin e datës së rëndësishme të lëvizjes sindikaliste siç ishte dita ndërkombëtare e punëtorëve, data 1 Maj. Gjithsesi ka një dallim mes traktit dhe komunikatës për shtyp që drejtoi Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare dhe atij që drejtoi Këshilli Administrativ i Sindikatave Punëtore për Korçën me rastin e ditës së 1 Majit. Në të parin nënvizohej se “po lind Shqipëria e Re demokratike, por kjo Shqipëri, vetë Liria nuk dhurohet, por fitohet me përpjekje”, duke i referuar parimeve të përgjithshme të organizimit të luftës antifashiste në vend. Ato reflektonin udhëzimet e Kominternit për organizimin e lëvizjeve antifashiste dhe rolin e partive komuniste në këtë rezistencë. Siç dihet lidhjet me Kominternin PKSH i kishte vendosur nëpërmjet PKJ dhe deri në mesin e vitit 1943 kjo e fundit vazhdonte të ndiqte udhëzimet që vinin nga qendra me një besnikëri ortodokse tipike për partitë komuniste. Në mars 1943, PKSH u mbledh në konferencën e parë të saj për gjithë vendin. Në atë konferencë bashkë me një letër të Titos, Blazo Jovanoviç, anëtar i KQ të Partisë Komuniste Jugosllave, solli njohjen nga Kominterni dhe orientimet e këtij të fundit për PKSH. Orientimet thoshin, ndër të tjera, se partia duhej ta vinte theksin në forcimin e “frontit nacional të të gjithë patriotëve shqiptarë” dhe se duheshin shmangur parullat që dilnin “jashtë caqeve të çlirimit nacional të Shqipërisë.”⁸⁹ Ndërsa komunikata e Këshillit Administrativ të Sindikatave Punëtore për Korçën ishte më e drejtpërdrejtë duke zbuluar pak a shumë dhe disa nga tiparet

88. Trakt i PKSH për 1 Majin cituar sipas Kristaq Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1970, f.369

89. Ana Lalaj, Dosjet e luftës, Botimet “Toena”, Tiranë 2014, fq. 52.

e pushtetit të ri komunist që do të instalohet në Shqipëri. Në trakt mes të tjerash thuhej:

Punëtorë të Korçës!

Dita e 1 Majit të Kuq është dita jonë. Në këtë ditë mijëra punëtorë ngrënë krahun e tyre të çelniktë dhe godasin shtypësin...Ata që kanë shtënë dorën dhe kanë rrëmbyer të drejtat tona, ata që kanë vënë dhjamë me gjakun tonë, ata që kanë lojtur shekuj me radhë me jetën tonë, sot kanë nënë thonjtë e tyre dhe atdheun tonë. Shqipëria jonë është e okupuar. E shkeli këmba e hordhive të zeza të Musolinit, të armikut më shtazor të klasës punëtore. Partia jonë Komuniste na mblodhi rreth vetes, na mësoi se pa Shqipëri të lirë s'ka punëtorë të lirë, na mësoi se hallka e mjerimit, e vuajtjes ishte zgjeruar e tash lidhte të tërë popullin shqiptar, që kishte humbur Liri, Pasuri, Nder. Dhe ne, punëtorët, me gjithë Partinë tonë në krye, u hodhëm në luftë kundër bishës fashiste, për të liruuar atdhenë e popullin nga armiku i përparimit. Sot, që lufta jonë arriti në fazën vendimtare, sot që proletariati rus na prin në fitoren më të madhe që ka parë bota, ne, punëtorët shqiptarë, të lidhur e të bashkuar rreth Partisë sonë të shumë dashur, të hidhemi pa rezerva në luftën tonë çlirimtare, ta çlirojmë atdheun më parë, të vëmë thikën në grykën e tradhëtarëve, që shitën nder e atdhe. Ne, punëtorët e punëtorët, sot, ditën e 1 Majit të Kuq, të ngremë zërin e të betohemi mbi gjakun e shokëve tanë të rënë në luftë, se Shqipërinë do ta bëjmë të lirë, demokratike, popullore, tradhëtarët do t'i zhdukim pa mëshirë, okupatorit do t'i dërrmojmë kockat.⁹⁰

Monopolizimi i datës së 1 Majit si 1 Maj i kuq, përmendja e PKSHE si organizatore e vetme e luftës, frymëzimi nga proletariati rus, gjuha e ashpër dhe e urrejtjes ndaj atyre që konsideroheshin tradhëtarë dëshmonin se edhe organizimi sindikalist nuk do të mund të zhvillohej i lirë dhe i pavarur, por ashtu si në Bashkimin Sovjetik do të konsiderohej si një nga organizatat e masave që duhej të përçonte vijën e partisë. Procesi i sovjetizimit do të prekte në këtë mënyrë edhe lëvizjen sindikaliste në Shqipëri duke e politizuar drejt së majtës ekstreme dhe duke mos dhënë shumë shanse që në një Shqipëri demokratike, kapitali dhe klasa punëtore të mos

90. Trakt i Këshillit administrativ i sindikatave punëtore për Korçën, cituar sipas Kristaq Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1970, f.371

konsideroheshin partnerë për përmirësimin e gjendjes ekonomike të pasluftës , por si armiq që duhej të luftonin njëri-tjetrin.

Krijimi i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë

Pas çlirimit të vendit, që në ditët e para u punua për rivënien në punë të ndërmarrjeve dhe për hapjen e vendeve të reja të punës. Shqipëria hyri në organizimin e ri shtetëror të pasluftës në pozita jo fort të favorshme në pikëpamje të edukatës e përvojës sindikaliste. Në vitet 1930 rreth 80 për qind e popullsisë ishin të punësuar në bujqësi, e cila në fakt kishte tipare mesjetare përsa i përket organizimit të punës dhe përdorimit të mjeteve teknike. Rreth 10 për qind e popullsisë ishin të punësuar në administratën shtetërore e publike dhe pjesa tjetër, prej 10 për qindësh, përbëhej nga artizanët e punëtorët e ndryshëm. Në shifra, numri i punëtorëve deri në prag të pushtimit italian nuk i kalonte 15 mijë.⁹¹ Një nga sfidat e para të qeverisë së Enver Hoxhës ishte organizimi i kësaj kategorie të popullsisë, i cili në radhë të parë duhej t'i shërbente ndërtimit të vendit, e më pak vetë punëtorëve. Por shtimi i punëtorëve dhe rritja e rolit të tyre në zhvillimin e vendit shtroi detyrën për organizimin sindikal. Detyrën për themelimin e Sindikatave e mori përsipër Tuk Jakova, njëri nga drejtuesit kryesorë politikë në vend, ish punëtor.⁹² Ai ishte marrë personalisht me punën organizative deri në Kongresin e Parë Sindikal që krijoi institucionet e përhershme të organizatës. Tuk Jakova kishte marrë pjesë në lëvizjen sindikaliste në Shkodër, kishte qenë një nga drejtuesit e Grupit Komunist të Shkodrës dhe e kishte ndjekur nga afër rritjen e lëvizjes sindikale në këtë qytet, që ishte nismëtar i zhvillimeve sindikale në vend. Menjëherë pas çlirimit, me nismën e Tuk Jakovës, në Shkodër ishte krijuar Sindikata e Përbashkët e Punëtorëve dhe Pronarëve të Vegjël. Megjithëse vendi po hynte në rrugën e sistemit një partiak, në Rezolucionin dhe Statutin që miratoi Kongresi i Parë i Sindikatave, theksohej se *“sindikatat duhej të njiheshin si një forcë ligjore, përfaqësuese e pavarur e punëtorëve dhe nëpunësve*

91. Nikollë Loka, Tuk Jakova - Jeta dhe vepra, “Grand Prind”, Tiranë 2017, fq. 127.

92. Tuk Jakova – Jeta dhe vepra, botime “Grand Prind”, Tiranë 2017, këtu: <https://shqiptarja.com/lajm/sifunksionuan-sindikatat-ne-br-shqipërine-e-45-46-tuk-jakova>.

të Shqipërisë. Gjithashtu, theksohej se duhet t'u garantohej me ligj punëtorëve e drejta e shpalljes së kërkesave ekonomike, si dhe e drejta e organizimit të grevës së pjesshme e të përgjithshme".⁹³ Bashkimi i Sindikatave në atë kohë kishte pavarësi relative, se dhe partia komuniste nuk kishte dale ende nga ilegaliteti dhe nuk ishte deklaruar "forcë udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë". Këto të drejta u hoqën më vonë, kur Bashkimet Profesionale dhe të gjithë organizatat e tjera të masave u shndërruan në leva të partisë.

Mbledhja e parë themeluese e Sindikatës

Sikurse u theksua më sipër, nevoja për organizimin e sindikatave ishte urgjente. Në lidhje me këtë organizim, Tuk Jakova do të shprehej se "*me çlirimin e vendit shumë probleme me randësi të madhe na kanë dalë përpara. Një nga këto është edhe organizimi i punëtorve dhe i sindikatave. Sot gjendemi në kohë vuajtjeje dhe nuk mund të vijë përnjëherësh një përmirësim ekonomik i klasës puntore. Sot çështja kryesore është që të organizohet sindikata dhe në këtë organizim të shkojmë paralel me popujt e tjerë, si kemi vajtur edhe në luftë. Në këtë prizëm duhet ta shohim problemin. Organizimi ynë paraqet mjaftë vështirësi dhe është mjaft delikat për ne. Në vendet e tjera borgjeze ka pas dhe ka sindikata, të cilat janë një shkollë ku punëtori mëson të kërkojë të drejtat e tij, pikësëpari kërkon të përmirësojë konditat e tij të vështira ekonomike dhe mëson të luftojë për përmbysjen e sistemeve politike shtypëse*".⁹⁴ Jakova e shpreh shumë qartë se përse është i nevojshëm ky organizim. Po ashtu, ai nuk le shteg për keqkuptime, duke e shprehur qartë se organizimi sindikal i shërben në plan të parë vendit dhe sfidave që ndodhej Shqipëria e sapodalë nga lufta. Në këtë mbledhje, e cila ishte thirrur nga një komision nismëtar, u mor vendimi për shtrirjen e punës organizative në të gjithë qytetet, me qëllim krijimin e sindikatave të punëtorëve në çdo qytet. Që në dhjetor të vitit 1944 filluan zgjedhjet për degët dhe këshillat sindikalë, që u krijuan sipas parimit të profesionit dhe vendit të punës. Mbledhja e parë themeluese u mbajt më 31 janar 1945.

93. Nikollë Loka, Tuk Jakova - Jeta dhe vepra, botime "Grand Prind", Tiranë 2017, f. 136

94. Nikollë Loka, Tuk Jakova - Jeta dhe vepra, "Grand Prind", Tiranë 2017, f. 128.

Në të merrnin pjesë 25 delegatë të sindikatave të sapokrijuara në çdo qytet.⁹⁵ Ajo drejtohej nga Tuk Jakova, Hasan Reçi dhe Vasil Nathanaili. Pra, dy përfaqësues nga Tirana dhe Tuk Jakova, nga Shkodra. Çështjet që u diskutuan në këtë mbledhje ishte parashtrimi i nevojës për organizimin e sindikatave, pra problemi i punëtorëve dhe i sindikatave në Shqipëri, diskutime rreth këtyre problemeve dhe detyrat që dilnin për grupin nismëtar. Nga diskutimet doli në pah organizimi i dobët i lëvizjes sindikaliste në Shqipëri gjatë viteve 30' dhe atyre të Luftës Antifashiste. Kështu për shembull Pavllo Rexha nga Tirana me profesion garson, pranoi në diskutimin e vet se në regjimin e Zogut ka pasë disa sindikata, megjithëse puna e tyre ka qenë e vogël. Në kohën e fashizmit ato mbetën ilegale dhe e ndihmuan Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Edhe Pandi Millona nga Elbasani me profesion garson raportonte, se gjatë regjimit të Zogut, puntoria nuk ka qenë e organizuar, por dhe ka kontribuar në luftë për çlirimin e qytetit. Edhe Gjirokastra dhe Berati dy qendra të mëdha urbane në Shqipërinë e asaj kohe sipas Meto Boi me profesion këpucar nga Gjirokastra dhe Janaq Çobanaçi, me profesion punëtor nga Berati kanë pohuar se në të kaluarën s'ka pasur ndonjë organizim punëtorësh. Në këtë mbledhje nuk mungoi dhe mbështetja e punëtorëve ndaj qeverisë së re, kur Xhoxhi Blushi, me profesion rrobaqepës nga Korça, deklaroi se objektivi jonë nuk është kundër qeverisë, por ne jemi në bashkëpunim me të. Duhet të dëgjohet zëri ynë edhe jashtë, që edhe ne të mund të përfaqësohemi në konferencat e punëtorëve të të gjithë botës.⁹⁶ Thirrja e nismëtarëve dhe përfaqësuesve të sindikatave dukej se ishte përzgjedhur me kujdes nga regjimi pasi një figurë qendrore e sindikalizmit shqiptar si Mafuz Laze nuk foli për ngjarjet për Shoqërinë “Puna” dhe grevën e 21 shkurtit 1936

95. Pjesëmarrësit: Tuk Jakova – Shkodër, profesioni marangoz; Fadil Shporri – Shkodër, këpucar; Hajrullah Lluakaçi – Shkodër, shofer; Hasan Reçi – Tiranë, mësues; Koço Xholi – Tiranë, intelektual; Pavllo Rexho – Tiranë, garson; Kolë Paporisto – Tiranë, intelektual; Muhamer Spahiu – Tiranë, ish-student; Theodor Manxhari – Tiranë, marangoz; Ligor Marange – Tiranë, elektrikist; Fetah Krrutani – Tiranë, tipograf; Vasil Nathanaili – Tiranë, punëtor; Xhoxhi Blushi – Korçë, rrobaqepës; Miço Thimo – Korçë, teneqexhi; Violanda Cicko – Korçë, punëtoare tekstili; Ropi Lazi – Korçë, marangoz; Janaq Çobanaçi – Berat, punëtor; Llambi Maqina – Kuçovë, punëtor; Spiro Pali – Kuçovë, elektrikist; Andon Poro – Fier, garson; Haxhi Progonati – Gjirokastër, këpucar; Meto Bio – Gjirokastër, këpucar; Mafuz Laze – Vlorë, mekanik; Ahmet Ruçi – Elbasan, murator dhe Pandi Milona – Elbasan, garson.

96. Tuk Jakova – Jeta dhe vepra, botime “Grand Prind”, Tiranë 2017, këtu: <https://shqiptarja.com/lajm/si-funksionuan-sindikatat-ne-br-shqipërine-e-45-46-tuk-jakova>.

në Kuçovë, por për një përpjekje të dështuar të organizimit të një greve në Selenicë. Në dallim nga figura të tjera të sindikalizmit shqiptar si Miha Lako dhe Pilo Peristeri që kishin marrë pozicione drejtuese në qeverinë e re, Mafuz Laze shihej me dyshim për shkak të së kaluarës së tij gjatë luftës.⁹⁷ Hija e rëndë e spastrimeve ndaj të ashtuquajturave grupazhe të ndërmarra gjatë viteve të luftës rëndonte mbi fatin politik të figurave të sindikalizmit shqiptar. Në këtë mbledhje u zgjodh edhe një komision iniciator për thirrjen e kongresit. Në përfundim, u ra dakord t'i kërkohej leje qeverisë për të legalizuar krijimin e Sindikatave të Shqipërisë. Në kërkesën e formuluar për këtë qëllim, shkruhet:

“Neve përfaqësuesit e punëtorëve të krahut e të mendjes, të organizuem në sindikata dhe të atyre që akoma janë të paorganizuem, të qarqeve të ndryshme të Shqipërisë të mbledhur këtu në Tiranë me datë 31 janar 1945, duke parë nevojat e organizimit të sindikatave punëtore, zgjodhëm një Komision Iniciator që do të marrë përsipër organizimin e sindikatave në Shqipëri.

Punëtorja shqiptare ka marrë pjesë aktive në Luftën Nacionalçlirimtare për çlirimin e Shqipërisë nga fashizmi dhe me kontributet që ka dhënë, ajo është e lidhur ngushtë me Qeverinë Demokratike të Shqipërisë.

Sot, në gjithë botën, veçanërisht në popujt që kanë qenë shtypur nga fashizmi dhe që kanë marrë pjesë aktive në luftë kundra tij, organizmi i punëtorve në sindikata ka marrë një hov të madh. Edhe këtu, me çlirimin e vendit tonë, problemi i organizimit të sindikatave paraqitet për të gjithë klasën puntore si një nevojë e domosdoshme.

Punëtorja shqiptare që ka qenë kurdoherë e gatshme për të dhënë çdo kontribut dhe sakrificë për vendosjen e pushtetit demokratik popullor; kërkon sot të organizohet me qëllim:

a. Forcimin e shtetit demokratik.

b. Rindërtimin e Shqipërisë.

c. Përmirësimin e konditave ekonomike, politike, shoqërore dhe kulturore të klasës punëtore.

97. Mafuz Laze deri në vitin 1943 kishte qenë anëtar i Grupit Komunist “Zjarri” që nuk kishte pranuar të shkrihej brenda PKS-së në 1941. Shih Enver Lepenica. Eliminimi i Grupit Komunist “Zjarri”. Instituti i Studimeve Politike “Ismail Qemal Vlora”, Tiranë, 2020. f.295.

ç. Të ndihmojë për zhvillimin e ekonomisë kombëtare.

Duke qenë se kërkesa jonë e drejtë do të ketë pëlqimin e qeverisë sonë demokratike mbetemi në pritje të aprovimit të kësaj kërkesë”.⁹⁸

Kërkesa u nëshkrua nga Tuk Jakova, Vasil Nathanaili, Xhoxhi Blushi, Hasan Reçi dhe Mafuz Laze. Pas këtyre masave organizative, më 11 shkurt 1945 u mbajt një konferencë kombëtare, në të cilën u bashkuan përfaqësues të sindikatave të ndryshme nga gjithë vendi dhe u krijua Bashkimi i Sindikatave të Shqipërisë. Detyra e këtij bashkimi ishte organizimi i sindikatave në të gjithë vendin dhe përgatitja e kongresit të parë mbarëkombëtar të sindikatave. Në këtë mënyrë për herë të parë lëvizja sindikaliste u shtri në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe nga një dukuri lokale e qyteteve Shkodër, Korçë, Kuçovë apo Durrës u kthye në një dukuri kombëtare, ku klasa punëtore, zanaçinjtë, esnafët dhe nëpunësit u organizuan në një bashkim të madh sindikal.

Kongresi themelues i Bashkimit të Sindikatave të Shqipërisë

Kongresi i Parë i Bashkimit të Sindikatave të Shqipërisë i filloi punimet me 28-31 shtator 1945 në orën 15.00, në kinemanë “Kosova” në Tiranë. Në të merrnin pjesë 300 delegatë që përfaqësonin 25 000 punëtorë e nëpunës.⁹⁹ Presidenti i Këshillit Qendror të Sindikatave të Shqipërisë Tuk Jakova mbajti referatin politik, ndërsa referatin rreth problemeve organizative e mbajti Kristo Themelko. Nga Kongresi doli Këshilli Qendror i përhershëm i Sindikatave që zgjodhi Kryesinë, të përbërë nga 10 anëtare, ku bënë pjesë Presidenti, një Zëvendës-president, një Sekretar i Përgjithshëm, si dhe anëtarë të ngarkuar me ekonominë, politikën sociale, agjitacionin, kulturën, financën dhe dy anëtarë të tjerë. Në kongres ishin ftuar edhe përfaqësues të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, të Qeverisë, të Frontit Nacionalçlirimtar,

98. AQSH, Fondi Bashkimet Profesionale të Shqipërisë, viti 1945, dosja 2, fl. 5, këtu Nikollë Loka: Tuk Jakova – Jeta dhe vepra, “Grand Prind”, Tiranë 2017. fq. 133-134.

99. Akademia e Shkencave e RPSSH. Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985, f. 508.

të Bashkimit të Gruas Antifashiste dhe të Bashkimit të Rinisë Antifashiste. Në Kongres përshëndeti Enver Hoxha në emër të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë, si dhe nga një përfaqësues të Frontit, të Gruas, të Rinisë dhe të Ushtrisë. Në punimet e Kongresit u ftuan përfaqësues sindikalistë nga Sindikatat Punëtore Ndërkombëtare.¹⁰⁰Përshëndetën dhe delegacionet e huaja, që merrnin pjesë në Kongres nga Jugosllavia, Bullgaria dhe Rumania.

Bashkimi i Sindikatave në vitet 1945-1946

Nën drejtimin e Tuk Jakovës, lëvizja sindikale, si një organizim i ri, pati disa suksese. Para Kongresit kishte përfunduar edhe ngritja e sindikatave sipas profesioneve, që u kurorëzua me themelimin e Bashkimeve Sindikale Profesionale: Të Punëtorëve dhe Nëpunësve të Minierave, Punëtorëve dhe Nëpunësve të Industrisë, Nëpunësve Shtetërorë, Punëtorëve dhe Nëpunësve të Nozullimit, Punëtorëve dhe Nëpunësve të Transportit, Punëtorëve dhe Nëpunësve të Ndërtimit. Në përbërje të administratës së Bashkimit të Përgjithshëm të Sindikatave, në vitin 1946 u krijua Seksioni i Kuadrit dhe Zyra e Statistikave, që krijoi mundësinë e ndjekjes më mirë të punës. Me 25 prill 1945, Tuk Jakova, në emër të Këshillit të Përgjithshëm të Sindikatave të Shqipërisë i kërkoi qeverisë që 1 Maji të shpallet festë zyrtare.

Arritje pati dhe në masat për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Me 24 korrik të vitit 1945, me një qarkore të nënshkruar nga Tuk Jakova, njoftohen Këshillat Sindikale për shpalljen e ligjit për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, që i jepte Sindikatës kompetenca për të rregulluar kohën e punës, pagën, kushtet e punës, punësimin dhe largimin e punonjësve nga puna. Në periudhën e rindërtimit dhe të aksioneve të para, klasa punëtorë sakrifikoi shumë. Punohej me orë të zgjatura dhe në kushte të vështira. Sindikata e mbështeti këtë lëvizje, por kërkoi që të evidentonte kontributet e çdo punëtori. Për këtë qëllim, me 18 gusht 1945, Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm

100. U ftuan të marrin pjesë: Këshilli i Përgjithshëm i Sindikatave të Amerikës; Këshilli Qendror i Sindikatave Sovjetike; Këshilli i Përgjithshëm i Sindikatave të Britanisë së Madhe. Po kështu, Këshilli i Përgjithshëm Sindikal i Shqipërisë u dërgoi ftesën e nënshkruar nga Presidenti Tuk Jakova, organizatave homologe në Jugosllavi, Bullgari, Rumani, Hungari, Çekoslovakia, Itali. Në përgjigje të ftesës së marrë, Konfederata Italiane e Punës i dërgon një letër përshëndetëse Bashkimit të Përgjithshëm të Sindikatave të Shqipërisë.

të Sindikatave të vendit u dërgoi një shkresë këshillave sindikale nëpër qarqe dhe rrethe për evidentimin e punëtorëve që punojnë për llogari të pushtetit jashtë orarit të punës. Më 26 prill, një ditë më vonë, Këshilli i Ministrave, me vendimin Nr. 9 vendosi që dita 1 Maji të jetë festë zyrtare.¹⁰¹

Bashkimi i Sindikatave si përfaqësuese e Shqipërisë në tribunat ndërkombëtare

Gjatë kësaj periudhe Komiteti i Përgjithshëm hodhi hapa të rëndësishëm përpara për pjesëmarrjen në organizatat sindikale ndërkombëtare dhe për të vendosur marrëdhënie dypalëshe me sindikatat e vendeve të tjera. Duhet thënë se ende pa u njohur Shqipëria nga shtetet e ndryshme, u vendosën lidhje me sindikata të vendeve të ndryshme që kishin rol të rëndësishëm në jetën e atyre vendeve. Me 8 shtator 1945, Kristo Themelko, Sekretar i Përgjithshëm i Sindikatave të Shqipërisë i dërgoi një kërkesë Federatës Botërore të Sindikatave, ku i kërkoi që Bashkimi Sindikal i Shqipërisë të pranohet në radhët e asaj Federate.¹⁰² Bashkimi i Sindikatave të Shqipërisë iu bashkua Bashkimit të Sindikatave Botërore në shtator të vitit 1945. Tuk Jakova ishte në krye të delegacionit të Bashkimit të Sindikatave në Konferencën e Sindikatave Botërore në Paris, ku përveç paraqitjes së punës së sindikatave në Shqipëri, ai kishte shfrytëzuar rastin që nga ajo tribunë e lartë të shprehë qëndrimin e Qeverisë së Shqipërisë për problemet më të rëndësishme që e shqetësonin vendin tonë: Marrëdhëniet me Greqinë, problemin e njohjeve ndërkombëtare dhe të dorëzimit të kriminelëve të luftës, të cilët për shkak të fillimit të mosmarrëveshjeve sovjetiko-amerikane, pothuajse ishin amnistuar dhe nuk po i dorëzoheshin Shqipërisë, siç parashikonin marrëveshjet ndërkombëtare që ishin hartuar për këtë qëllim. Tuk Jakova, në fjalën e tij në Kongresin e Konfederatës Botërore të Sindikatave në Paris, shprehu falënderimet në adresë të Konfederatës së Sindikatave Botërore që e kishin pranuar Shqipërinë në radhët e tyre.¹⁰³

101. Tuk Jakova – Jeta dhe vepra, botime “Grand Prind”, Tiranë 2017, këtu: <https://shqiptarja.com/lajm/si-funksionuan-sindikatat-ne-br-shqiperine-e-45-46-tuk-jakova>.

102. Po aty.

103. Më tej, ai prezantoi historikun e lëvizjes sindikale në Shqipëri dhe shprehu, po ashtu, disa shqetësime

Bashkimi i Sindikatave të Shqipërisë u ftua dhe në kongreset e sindikatave të vendeve të ndryshme. Me 13 maj të vitit 1946, një delegacion i Këshillit të Përgjithshëm të Sindikatave të Shqipërisë mori pjesë dhe përshëndeti në Kongresin e Sindikatave të Çekoslovakisë. Po ashtu, Bashkimi i Këshillit të Përgjithshëm Sindikal të Shqipërisë mori pjesë dhe në Kongresin e Sindikatave të Bashkuara të Hollandës, që u mbajt në Amsterdam nga datat 3 deri me 8 shkurt të vitit 1947. Ftesa ishte dërguar me 21 nëntor të vitit 1946.

Jakova e mbajti funksionin e rëndësishëm të Presidentit të Bashkimit të Sindikatave të Shqipërisë deri me 3 mars 1947, kur u emërua Ministër Fuqiptotë i Shqipërisë në Beograd. Gjatë kohës që ishte President i Sindikatave, ai kreu dhe funksione të larta partiake dhe shtetërore, si anëtar i Byrosë Politike të PKSH-së, Kryetar i Asamblesë Kushtetuese, Ministër i Shtetit dhe Kryetar i Delegacionit të Shqipërisë pranë Këshillit të Sigurimit, kur Qeveria Shqiptare po bënte përpjekje për normalizimin e marrëdhënieve me SHBA-në dhe kishte bërë kërkesën për t'u pranuar në OKB. Si politikan i kalibrit të lartë, Tuk Jakova ndihmoi shumë që lëvizja sindikale në Shqipëri të zhvillohej më tej. Viti '48 qe vendimtar për vazhdimësinë e pushtetit komunist në Shqipëri pasi ishte viti i prishjes së marrëdhënieve shumë të ngushta shqiptaro-jugosllave të vendosura që gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore. Kjo prishje u bë me kërkesën e sovjetikëve, të cilët u shpallën si shpëtimtarë të Shqipërisë nga titizmi. Më datën 27 mars 1948, u bë e njohur letra e KQ të PKBS drejtuar KQ të PKJ, ku udhëheqja shqiptare mësoi për kontradiktat e thella midis Stalinit dhe Titos. Mosmarrëveshjet Stalin-Tito dolën në pah. Epilogu i marrëdhënieve të ngushta shqiptaro-jugosllave do të përmbyllej në letër, që Enver Hoxha

të Shqipërisë, që për shkak të mungesës së njohjeve, që Qeveria Shqiptare nuk kishte mundur t'i paraqiste në forumet ndërkombëtare. Tuk Jakova kërkoi të ndërmjetohej për të parandaluar një konflikt në kufirin shqiptaro-grek i cili do të shkaktohte trazira dhe të prishte paqen në Ballkan: "Ne kemi qenë dhe jemi miq me popullin grek; kemi luftuar kundër fashizmit, por mjerisht rezistenca e popullit grek ka pësuar një fat të keq, atje sot sundojnë antidemokratët, reaksionarët dhe terroristët. Ky regjim mundohet të krijojë intriga në Ballkan dhe veçanërisht pretendon mbi tokat që ai i quan "Vorio Epir" dhe, nga ana tjetër, ndjek dhe masakron minoritetin shqiptar në Greqi. Kufijtë e Shqipërisë nuk janë ata që thotë reaksioni grek. Këto kufij që kemi sot dhe që i çliuam me gjak, jemi gati t'i mbrojmë me gjak. Ne dëshirojmë të rrojmë në paqe, në marrëdhënie me popullin grek, me popujt e Ballkanit dhe të të gjithë botës", u shpreh Jakova. (Tuk Jakova – Jeta dhe vepra, botime "Grand Prind", Tiranë 2017, këtu: [https://shqiptarja.com/lajm/sifunksionuan-sindikatat-ne-br-shqiperine-e-45-46-tuk-jakova.](https://shqiptarja.com/lajm/sifunksionuan-sindikatat-ne-br-shqiperine-e-45-46-tuk-jakova))

i dërgoi Titos më 23 maj 1948, si përgjigje e dy letrave të tij të 22 prillit 1948. Ngjarjet që pasuan ishin një vazhdim logjik i konfliktit sovjeto-jugosllav, ku udhëheqja komuniste shqiptare gjeti rastin për t'u rreshtuar në krah të Bashkimit Sovjetik dhe siguruar në të njëjtën kohë vazhdimësinë e qëndrimit të vet në pushtet. Gjithandej në Europën Lindore filluan operacionet e spastrimit nga të ashtuquajturit trockistë dhe mbështetës të Titos. Enver Hoxha shfrytëzoi rastin për të hequr qafe kontrollin e vazhdueshëm bezdisës të udhëheqësve që vinin nga klasa punëtore si Koçi Xoxe, Pandi Kristo, Kristo Themelko dhe që ishin mbështetur që nga viti 1945 prej jugosllavëve. Nga viti 1948 “Jugosllavia titiste” u kthye në armikun kryesor të komunistëve shqiptarë, ndërsa marrëdhëniet e shqiptarëve në të dyja anët e kufirit thuajse u ndërpre në një luftë realisht e ftohtë mes dy vendeve dhe nga përdorimi në shkallë të gjerë i rrjetit agjenturor nga të dyja palët. Më 29 qershor 1948, KQ i PKSH. publikoi komunikatën, me të cilën solidarizohej me rezolutën e Byrosë Informativë “Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave”, ku dënohej rruga e PKJ dhe e udhëheqjes së saj brenda kampit socialist. Prishja e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave në qershor 1948 ndikoi dhe në riorganizimin e Bashkimit të Sindikatave të Shqipërisë që deri atëherë ishin organizuar sipas modelit jugosllav. Në datën 7 qershor 1949 u mbajt mbledhja e Byrosë Politike të PPSH-së që mori në shqyrtim raportin e Kryesisë së Këshillit Qendror të Bashkimit të Përgjithshëm Sindikal mbi gjendjen në sindikata. Në preambulën e vendimit sipas stilit të njohur eufemik komunist, pasi analizoheshin sukseset në organizimin e sindikatave pas çlirimit, nënvizoheshin vështirësitë dhe pengesat, që ishin hasur nga veprimtaria e aktivistëve të ashtuquajtur trockistë. Sukseset e arritura nga sindikatat, thuhej në preambulë, janë bërë të mundshme në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë dhe kujdesit që ka treguar shteti ynë. Këto suksese në punë do të ishin akoma më të mëdha po të mos ishin dëmtuar nga veprimtaria armiqësore e Koçi Xoxes me shokë. Veprimtaria armiqësore e klikës së Titos dhe e agjentëve të saj Koçi Xoxe e Pandi Kristo ka dëmtuar rëndë punën në sindikata. Plenumi IV

i Këshillit Qendror të BPS që u zhvillua në frymën trockiste të Plenumit VIII të PKSH, ka pasur një influencë negative në tërë punën e sindikatave. Nga kjo veprimtari armiqësore kanë rrjedhur një sërë të metash të rëndësishme që konstatohen sot në sindikatat, si tendenca për të shtrembëruar rolin dhe karakterin e sindikatave, për t'i degjeneruar ato në një aparat të thjeshtë burokratik. Po kështu është shkaktuar moskuptimi i drejtë i rolit të madh të sindikatave dhe mospasja e lidhjeve të shëndosha ndërmjet sindikatave e organeve shtetërore.¹⁰⁴Për të luftuar të ashtuquajturin burokratizim të sindikatave mbledhja e Byrosë Politike ndërmorri disa masa organizative që reflektuan në vijueshmërinë e lëvizjes sindikaliste në Shqipëri. Sekretar i Përgjithshëm i Bashkimit Sindikal ishte Kristo Themelko, që kishte luajtur dhe rolin e kryetarit pas largimit të Tuk Jakovës si Ministër Fuqiplotë i Shqipërisë në Beograd, më 3 mars 1947. Kristo Themelko ishte një nga mbështetësit e vijës jugosllave në PPSH dhe pas përjashtimit të tij nga Byroja Politike çdo lloj aktiviteti që kishte kryer si në ushtri dhe në sindikata shihej me dyshim. Masat reflektonin një riorganizim që do të shtrihej në të gjithë vendin por mbi të gjitha do të caktonin kriteret ideologjike mbi të cilat do të punonin sindikatat këndeje e tutje. Me qëllim që të eliminoheshin të metat e konstatuara në çështjet organizative të sindikatave, theksohej në vendimin e Byrosë Politike të datës 7 Qershor 1949, për t'u forcuar këto organizativisht, që të bëhen të afta si duhet për mobilizimin me vrull të klasës punëtore për realizimin e planit dyvjeçar të shtetit, të merren këto masa:

1.- Pasi Statuti i BPS nuk u përshtatet më konditave të tanishme, Këshilli Qendror i Sindikatave të përgatisë brenda datës 30 korrik të këtij viti projektstatutin e ri të sindikatave, i cili të përcaktojë qartë parimet, qëllimet dhe detyrat e sindikatave në situatën e tanishme.

2. - Me qëllim që të korrigjohen disa të meta që kanë ekzistuar në ndërtimin e organizatave sindikale, të merren këto masa të shpejta: Të organizohen grupet sindikalë në organizatat bazë; këshillat sindikalë të rretheve të mos formohen nga përgjegjësit

¹⁰⁴. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH "Mbi punën e sindikatave", 7 qershor 1949, Dokumente kryesore të PPSH, -I Vëllimi II 1949 - 1956, Botimi i dytë, Tiranë, 1972, f. 42.

e këtyre këshillave, por të zgjidhen dhe t'u përcaktohen detyrat si organe koordinues, t'u përcaktohen mirë detyrat që të mos mbeten formalë. Veç këtyre, Këshilli Qendror i Sindikatave, kur të përgatisë projektstatutin, të studiojë përcaktimin dhe ndryshimet e nevojshme në strukturën e organizatave sindikale.

3 - Duhet të punohet për të respektuar principet e centralizmit demokratik. Të luftohen metodat urdhëruese në udhëheqjen e punës sindikale. Të zhvillohet kritika dhe autokritika në baza të shëndosha të marksizëm-leninizmit dhe klasa punëtore e masat punonjëse të vendit tonë të edukohen në shembullin e në frymën e avangardës së tyre. Të rritet ndjenja e përgjegjësisë në anëtarët e sindikatës ndaj organeve drejtuese dhe këto të fundit të japin llogari periodikisht para masës së anëtarëve. Metoda e punës së sindikatave duhet të jetë metoda e bindjes, e edukimit dhe jo e imponimit. Për këto arsye para Kongresit II të Sindikatave të zhvillohen zgjedhjet për organet drejtuese në sindikata.

4 - T'i kushtohet një kujdes i veçantë zgjerimit të radhëve të sindikatave dhe forcimit të tyre me anëtarë të rinj. Të punohet për të organizuar në sindikatë të gjithë punëtorët e nëpunësit që deri tani kanë mbetur jashtë radhëve të sindikatave për shkak të sektarizmit dhe të punës së dobët që është bërë në këtë drejtim. Të shtohet influenca e organizatave sindikale në njerëzit e teknikës, të shkencës dhe të kulturës që të aktivizohen dhe të vënë të gjitha forcat për ndërtimin e bazave të socializmit.

5 - Të vendoset në organet drejtuese udhëheqja kolegjiale, të funksionojnë dhe të mblidhen rregullisht këshillat dhe kryesisht nga qendra deri në bazë. Të luftohet monopolizimi i punës në duart e disa elementëve.

6 - Të riorganizohet aparati pranë Këshillit Qendror të BPS, këshillave sindikale të rretheve, këshillave sindikalë lokalë dhe pranë organizatave bazë sipas skicës që i bashkëngjitet këtij vendimi. Një kujdes i veçantë t'i kushtohet aktivizimit dhe futjes në punë të rrjetit të aktivistëve pa pagesë.

7 - Të merren masa për edukimin dhe lartësimin e kuadrit që punon në sindikatë, të vendosen në postet drejtuese kuadro të

shëndoshë e me eksperiencë në punën sindikale dhe të vendoset kuadri i nevojshëm në vendet e paplotësuara.

8 - Të luftohet për të vendosur rregull në çështjet administrative dhe financiare të sindikatave. Të merren masa serioze për të zhdukur konfuzionin dhe burokracinë, për të vendosur evidenca të rregullta dhe të sakta dhe në administrimin e buxhetit të ketë një orientim më të drejtë, për të pasur sa më shumë të ardhura dhe sa më pak shpenzime të panevojshme.¹⁰⁵ Ideologjizimi i sindikatave duke i quajtur si pararojë e klasës punëtore ishte një aspekt tjetër që u përvijua në vendimin e këtij plenumi. Në nyjën mbi punën edukative theksohej se...duhet të zhvillohet një punë e madhe për edukimin e klasës punëtore në bazë të teorisë marksiste-leniniste, për zhvillimin e patriotizmit, të dashurisë për atdheun, për Partinë dhe shokun Enver, për forcimin e dashurisë ndaj Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike dhe shokut Stalin, për zhvillimin e dashurisë për demokracitë popullore dhe të gjitha forcat përparimtare të botës, për shtimin e urrejtjes kundër imperialistëve dhe të gjithë armiqve të vendit tonë; të mobilizohet klasa punëtore për realizimin e planit të shtetit, t'i bëhet i qartë roli i saj pararojë në aleancën me fshatarësinë e varfër e të mesme për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë. Sindikatat duhet të mobilizohen për të bërë një punë të madhe në këtë drejtim në bazë të vendimeve të veçanta që do të marrë Sekretariati i KQ të PPSH për këtë problem.¹⁰⁶ Gjithsesi pavarësisht ideologjizmit të skajshëm në vendimet e plenumit, mes të tjerash aty kishte disa nja vendimmarrëse që përmirësonin gjendjen ekonomike dhe shoqërore të klasës punëtore dhe lëvizjes sindikaliste në Shqipëri. Kështu në nyjën mbi pagat kuptohej drejt lidhja midis pagave dhe rritjes së prodhimit, tipar që sa do të vijë e do të zbehet në vitet e mëvonshme. Me qëllim që të rregullohet problemi i pagave, thuhej në vendim, dhe të bëhen këto nxitje për shtimin e prodhimit është e nevojshme që të merren këto masa:

105. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH "Mbi punën e sindikatave", 7 qershor 1949, Dokumente kryesore të PPSH, -I Vëllimi II 1949 - 1956, Botimi i dytë, Tiranë, 1972, f. 44-46.

106. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH "Mbi punën e sindikatave", 7 qershor 1949, Dokumente kryesore të PPSH, -I Vëllimi II 1949 - 1956, Botimi i dytë, Tiranë, 1972, f.46.

1 - Për të korrigjuar të metat që ekzistojnë sot dhe për të përcaktuar sa më drejt kategorizimin dhe sistemimin e pagave të punëtorëve e të nëpunësve, Kryesia e BPS duhet me anë të përfaqësuesve të saj, të ndihmojë dhe t'i japë gjithë materialin që disponon komisionit që ka ngarkuar qeveria për të përfunduar këtë problem deri më 30 korrik. Gjithashtu, sindikatat të ndihmojnë komisionin e lartpërmendur dhe organet shtetërore përkatëse për të përcaktuar rregulloret e veçanta për pagat e punëtorëve, teknikëve e nëpunësve të sektorëve të ndryshëm, si dhe për studimin e korrigjimit e urdhëresës për pagën e punëtorëve të mitur e praktikantë. 2.- Organizatat sindikale ngarkohen të merren me çështjen e pagave, të kontrollojnë llogaritë e mëditjeve dhe të pagesës sipas normave, të ndjekin rregullisht ngritjen e aftësive teknike të punëtorëve në punë, duke i ngritur këta në kategorizim. T'u shpjegojnë punëtorëve ligjin e urdhëresat mbi pagat dhe të bëhen këto një nxitje për shtimin e prodhimit.

Në ekonominë e paslutës kishte pasur nevojë për një mobilizim të fuqisë punëtore shpeshherë duke anashkaluar pagesat dhe punën e të miturve, ndaj ishte një rregullim i domosdoshëm jo vetëm për pagat por edhe për Kodin e Punës dhe inspektimin e tij, sigurimet shoqërore, pajisjen me banesa dhe pushimet e punëtorëve. Për të vënë në rrugë të drejtë problemet e ndryshme mbi marrëdhënjet në punë, mbrojtjen e punës dhe funksionet e sindikatave për zbatimin e Kodit të Punës, plenumi sugjeronte që të merreshin këto masa:

1. Të merret parasysh stazhi, meritat, rendimenti në punë. Gjithashtu, sindikatat duhet të ndihmojnë për përgatitjen e urdhëresave të tjera mbi zbatimin e ligjit të sigurimeve shoqërore, mbi funksionet e organeve të tyre, etj.

2. Sindikatat, të cilat ngarkohen me zbatimin direkt të sigurimeve shoqërore, duhet t'i kushtojnë një kujdes të madh vënies në jetë të ligjit të sigurimeve shoqërore, duke goditur shpërdorimet, konfuzionin, burokracinë, abuzimet, etj.¹⁰⁷

Ndërkohë këto vendime nuk realizoheshin jashtë kornizave ideologjike. Kontrolli partiak ishte kudo dhe mbi cilindo organizim përfshi dhe atë sindikal. Rregullimi ligjor i sigurimeve shoqërore

¹⁰⁷ Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH "Mbi punën e sindikatave", 7 qershor 1949, Dokumente kryesore të PPSH, -1 Vëllimi II 1949 - 1956, Botimi i dytë, Tiranë, 1972, f.46.

sigurohej nëpërmjet masave organizative të ndërmarra nëpërmjet forumeve partiake. Pika 3 e njës së Kodit të Punës shënonte se drejtoria e kuadrit e KQ të PPSH të marrë masa për forcimin e aparatit të sigurimeve shoqërore me kuadrot e nevojshëm dhe Kryesia e BPS të marrë masa për ristudimin e këtyre kuadrove.¹⁰⁸ Vëmendje e veçantë në vendimin e këtij plenumi i kushtohej edhe shërbimeve shoqërore që përfitonin sindikatat, si furnizimi me banesa për punëtorët dhe pushimet e punëtorëve. Për Shqipërinë e pasluftës, ku gjysma e qendrave urbane ishin djegur nga lufta, ndërtimi i banesave dhe apartamenteve ishte një hap i madh por edhe shpenzim monetar. Shqipëria që prej shkurtit 1949 ishte anëtare e KNER-it. (Këshillit të Ndhmës Ekonomike Reciproke). KNER-i u krijua që të kontribuonte për realizimin e qëllimeve të zhvillimit dhe të bashkëpunimit ekonomik në zonën e Bllokut Sovjetik, mbi bazën e parimeve të respektimit të sovranitetit dhe interesave kombëtarë, të reciprocitetit, të ndihmës e solidaritetit.¹⁰⁹ Ky formulim ishte thjesht në parim. Koha e tregoi se më shumë se një organizatë ekonomike e ndihmës reciproke dhe e respektimit të sovranitetit të kombeve, qe një organizatë që imponoi modelin sovjetik të ndërtimit dhe të planifikimit të ekonomisë. Gjithsesi intensifikimi i marrëdhënieve ekonomike me vendet e tjera të Europës Lindore që i përkisnin Bllokut Komunist, pati filluar që më herët, që pas prishjeve të marrëdhënieve me Jugosllavinë. Sipas lajmeve të dhëna nga ATSH dhe botuar në gazetën “Bashkimi”, më 2 prill 1949, thuhej se marrëveshjet tregtare për vitin 1949, të firmosura midis Shqipërisë dhe Polonisë, Çekoslllovakisë, Hungarisë dhe Rumanisë parashikonin një vëllim të përgjithshëm prej 12 milionë dhe tetëdhjetë mijë dollarë amerikanë , këto në mallra dhe në hua.¹¹⁰ Një pjesë e këtyre huave u dukën që u përdorën për krijimin e qendrave urbane pranë industrisë minerale dhe asaj të naftës që ishin dhe produktet me të cilat Shqipëria paguante detyrimet e saj financiare të kredive. Qyteti i Memaliajt, qyteti i Maliqit, zgjerimi i Patosit, Kuçovës, ndërtimi i lagjeve

108. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH “Mbi punën e sindikatave”, 7 qershor 1949, Dokumente kryesore të PPSH, -1 Vëllimi II 1949 - 1956, Botimi i dytë, Tiranë, 1972, f. 52.

109. Lisen Bashkurti, Diplomacia shqiptare në fillimet e “Luftës së Ftohtë”, Geer, Tiranë, 2003, f. 198.

110. Lisen Bashkurti, Diplomacia shqiptare në fillimet e “Luftës së Ftohtë”, Geer, Tiranë, 2003, f. 199.

periferike në Tiranë, etj ishin zhvillime urbane që morën hov në këto vite. Ato u kthyen në qendra urbane të klasës punëtore, ku krahas strehimit u ngritën dhe mensa punëtorësh, kinoteatre, kinema , qendra shendetësore, etj. Modeli i ndërtimit të këtyre qendrave të reja urbane u kopjua nga modeli stalinist sovjetik që u eksportua në vendet e Europës Lindore në vitet 1945-1953. Pranë minierave, puseve të naftës, kombineleve u ngritën qytezat, të cilat ishin vendet, ku fshatarët do të shndërroheshin në punëtorë dhe, ku do të farkëtohej aleanca midis dy klasave, siç mësonte ideologjia komuniste. Këto qyteza ishin edhe një hallkë e kontrollit të PPSH-së mbi rrethinat rurale. Analizën më të mirë të ndërtimit të këtyre qendrave urbane punëtore e ka përshkruar historiani amerikan Stiven Kotkin [Stephen Kotkin], në monografinë “Magnetic Mountain: Stalinism as a Civilization” (“Mali Magnetik: Stalinizmi si qytetërim”). Studimi i Kotkinit përqendrohet te ndërtimi dhe zhvillimi i qytetit të Magnitogorskit (Mali Magnetik) në rajonin e Uraleve të Bashkimit Sovjetik. Sikurse lindja e qytetërimeve gjurmohet mbrapsht në histori te krijimi i qyteteve të para, po ashtu edhe Magnitogorski u projektua nga elita komuniste në fund të viteve 1920 jo vetëm si qyteti i parë industrial që do të ngrihej për nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve të hekurit, por edhe si një fillesa e një qytetërimi alternativ modern, i cili do të konkurronte me sukses e do të tejkalonte modernitetin kapitalist. Themelimi i Magnitogorskit shënonte “revolucionin e dytë” në Bashkimin Sovjetik, siç quhet prej shumë studiuesve mobilizimi gjigand i shtetit dhe i shoqërisë sovjetike në fund të viteve 1920 e deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore, për kolektivizimin e bujqësinë dhe industrializimin e shpejtë të vendit. Ky “revolucion”, i drejtuar nga burokracia partiako-shtetërore, u karakterizua nga vdekje të miliona njerëzve nga uria, nga vrasja e burgosja e qindra mijëra të tjerëve, nga jetesa nën terror e pjesës tjetër të popullatës, por njëkohësisht edhe nga një lëvizshmëri e madhe shoqërore, që u dha mundësi shumë njerëzve të nisnin profesione e jetë të reja.

¹¹¹ Gjithsesi Kotkin arrin në përfundimin se pavarësisht nga kjo

111. Enis Sulstarova, Nga Magnitogorski në Maliq: Shënime për “qytetërimin stalinist”, Revista “Shenja”, korrik 2022.

shtypje brutale e të drejtave dhe lirive të njeriut në Bashkimin Sovjetik filloi një periudhë moderniteti, sipas recetave të nxjerra nga ideologjia marksiste-leniniste. Meqenëse eksperimenti social kishte në qendër planifikimin e prodhimit dhe të konsumit me metoda racionale, komunistët sovjetikë pretendonin se varianti i tyre i modernizimit ishte sipëror ndaj “spontaneitetit” kapitalist dhe pasigurisë endemike që ky shkaktonte. Shteti projektoi ndërtimin e fabrikave gjigande për shkrirjen e metaleve dhe prodhimin e çelikut dhe pranë fabrikave lindën qytete të reja, si Magnitogorski, që u populluan më së shumti me ish-fshatarë të shndërruar në minatorë, metalurgë, mekanikë, inxhinierë, drejtues, nëpunës, mësues, aktivistë të organizatave partiake, gazetarë, artistë, etj. Shumë prej tyre, pavarësisht prej mungesave e vështirësive të ndryshme në jetën e përditshme dhe manovrimeve me pushtetarët për hir të mbijetesës, e shihnin veten me krenari si realizuesit e botës së re, për të cilën u fliste pareshtur propaganda shtetërore.¹¹² Ky entuziazëm mbi të ardhmen ishte qartazi i pranishëm në sakrificat dhe reagimet e klasës së porsaformuar në Shqipëri që përkthehej dhe në një mbështetje të rëndësishme të regjimit komunist. Ngjashëm me Magnitogorskin në Bashkimin Sovjetik dhe me veprat e tjera gjigande industriale të socializmit në vende të tjera, tharja e kënetës dhe ndërtimi i kombinatit të Maliqit në Shqipëri do të thoshte më shumë se sa ndryshimi i peizazhit gjeografik dhe i ekonomisë vendore. Ndryshimi i kushteve materiale ishte kushti për ndryshimin shoqëror dhe formimin e “njeriut të ri”. Kompleksi industrial [në Maliq] ishte edhe një qendër civilizuese, që projektonte modelin e vet dhe mënyrën socialiste të jetesës së klasës punëtore mbi hapësirën rurale që e rrethonte atë”.¹¹³ Në këtë kontekst nyja “Mbi furnizimin dhe banesat” në vendimin e Byrosë Politike “Mbi Punën e Sindikatave” shprehte një realitet që kishte filluar të merrte formë nga zhvillimi ekonomik dhe industrial i Shqipërisë në ato vite. Nyja ligjore mbi furnizimin dhe banesat përfshinte katër pika të rëndësishme.

112. Enis Sulstarova, Nga Magnitogorski në Maliq: Shënime për “qytetërimin stalinist”, Revista “Shenja”, korrik 2022.

113. Enis Sulstarova, “Nga Magnitogorski në Maliq: Shënime për “qytetërimin stalinist”, Revista “Shenja”, korrik 2022.; Artan R.Hoxha, “Tharja e kënetës së Maliqit dhe ndërtimi i regjimit komunist në periferi të Shqipërisë”, Onufri, Tiranë, 2021, f. 254-255.

1 - Për sigurimin e furnizimit të punëtorëve dhe të nëpunësve me sendet e nevojshme ushqimore, të shtohet rrjeti i mensave pranë qendrave të punës, të përmirësohet ushqimi, të ulen çmimet.

2 - Të shtohet sipërfaqja e tokave të kopshteve të zarzavateve pranë qendrave të punës dhe të kopshteve individuale të punëtorëve. Të organizohet punimi dhe mirëmbajtja e tyre në mënyrë kolektive dhe vullnetarisht nga punëtorët për të siguruar sa më shumë prodhime me çmime të ulëta. Të ngrihen ekonomitë e vogla ndihmëse me qëllim që të ndihmojnë në furnizimin e mensave të punëtorëve.

3 - Organizatat sindikale të mobilizojnë punëtorët për të ndihmuar në realizimin e planit të ndërtimit të banesave në qendrat e punës dhe të kujdesen për mirëmbajtjen e tyre.

4 - Këshilli Qendror i Sindikatave të marrë në studim dhe t'i propozojë Këshillit të Ministrave çështjen e organizimit të kontrollit të sindikatave mbi rrjetin e mensave, të dyqaneve dhe të ekonomive ndihmëse pranë qendrave të punës.¹¹⁴

Aspekti tjetër i rëndësishëm në masat e marra për përmirësimin e kushteve për punëtorët ishte nyja e vendimit mbi pushimet e punëtorëve. Ky ishte një zhvillim tjetër cilësor përse i përket rritjes së standardit të jetesës për klasën punëtore pasi nuk kishte egzistuar më parë në Shqipëri. Në preambulën e njëjës ligjore “Mbi pushimet e punëtorëve” shkruhej se sindikatat t'i kushtojnë një kujdes të veçantë organizimit të pushimit të punëtorëve në bazë të një plani që duhet të përcaktohet në bashkëpunim me ndërmarrjet para fillimit të çdo viti me qëllim që të gjithë punëtorët të marrin lejet e pushimeve vjetore pa u dëmtuar realizimi i planit të shtetit.¹¹⁵Një rëndësi të veçantë iu dha ndërtimit të shtëpive të pushimit për punëtorët dhe kohëzgjatja e shërbimit të tyre. Nyja ligjore “Mbi pushimet e punëtorëve” e përcaktonte qartë organizimin e pushimeve, periudhat kohore, përzgjedhjen

114. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH “Mbi punën e sindikatave”, 7 qershor 1949, Dokumente kryesore të PPSH, -1 Vëllimi II 1949 - 1956, Botimi i dytë, Tiranë, 1972, f. 52.

115. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH “Mbi punën e sindikatave”, 7 qershor 1949, Dokumente kryesore të PPSH, -1 Vëllimi II 1949 - 1956, Botimi i dytë, Tiranë, 1972, f. 53.

e punëtorëve, pagesat financiare të pjesshme, etj. Nyja ligjore e vendimit të Byrosë Politike të datës 7 qershor përbëhej nga katër pika.

1 - Shtëpitë e pushimit të bëhen të përhershme në mënyrë që punëtorët të mos shkojnë vetëm gjatë verës, por gjatë gjithë vitit. Të shtohen shtëpitë e pushimit dhe të caktohet një sistem i shtëpive dimërore, verore me klimë malore, detare, etj. Sindikatat të përgatisin një plan me afat të gjatë për ndërtimin dhe riparimin e shtëpive të përhershme të pushimit.

2 - Të vendoset një kriter i drejtë në dërgimin e punëtorëve në shtëpitë e pushimit në mënyrë që të shkojnë punëtorët më të mirë, sulmues, novatorë, racionalizatorë dhe ata që kanë më shumë nevojë nga ana shëndetësore.

3 - Të caktohen kategoritë e punëtorëve që meritojnë të kalojnë falas në shtëpitë e pushimit dhe të atyre që duhet të paguajnë pjesërisht shpenzimet.

4 - Të organizohet më mirë jeta, dëfrimi dhe çlodhja e punëtorëve në shtëpitë e pushimit sipas rregulloreve dhe programeve të përcaktuara.¹¹⁶

Sindikatat menjëherë pas themelimit të tyre kishin ndërmarrë lidhje me organizatat e tjera sindikaliste në Europë, përfshi dhe ato të vendeve perëndimore. Pas fillimit të Luftës së Ftohtë bashkëpunimi sindikalist ishte kufizuar brenda vendeve të Bllokut Lindor, por nuk pengonte bashkëpunimin dhe me sindikatat e vendeve përparimtare, një eufemizëm i krijuar nga sektori ideologjisë komuniste për të perifrazuar vendet me të cilat Tirana zyrtare mbante marrëdhënie normale diplomatike. Sindikatat, thuhej në preambulën e nyjes lidhjet ndërkombëtare të sindikatave, të forcojnë në mënyrë të vazhdueshme lidhjet e tyre me sindikatat përparimtare të vendeve të tjera, të edukojnë klasën punëtore në frymën e internacionalizmit proletar dhe të rritin e të zhvillojnë urrejtjen kundër imperializmit, agjentëve të tij dhe tradhëtarëve të

116. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH "Mbi punën e sindikatave", 7 qershor 1949, Dokumente kryesore të PPSH, -I Vëllimi II 1949 - 1956, Botimi i dytë, Tiranë, 1972, f. 53.

klasës punëtore.¹¹⁷ Gjuha e urrejtjes që karakterizonte këtë preambul reflektonte tashmë ndarjet ideologjike Lindje-Perëndim por edhe ndërvarësinë partiake të sindikatave. Sipas Kotkinit, të jetoje e të punoje në Bashkimin Sovjetik në periudhën staliniste do të thoshte të mësoje “të folurën bolshevike”, e cila ishte gjuha e detyrueshme për identifikimin e vetes dhe për të ndjekur interesin tënd në të gjitha fushat. Përdorimi i “të folurës bolshevike” ishte i domosdoshëm që nga autobiografia, që nga mënyrat e tjera të ndërveprimit me pushtetin sovjetik, e deri te lidhja e jetës së përditshme me panoramën më të gjerë shoqërore e politike të kohës.¹¹⁸ Në nyjen mbi lidhjet ndërkombëtare të sindikatave i kushtohet një kujdes i veçantë lidhjeve me sindikatat sovjetike. Partia e Punës e përdori me sukses ligjërimin stalinist për t’iu larguar shtrëngimit jugosllav dhe për të përfituar ndihma të gjithanshme sovjetike.

1 - Të forcohen veçanërisht lidhjet me sindikatat sovjetike. Këshilli Qendror i Sindikatave duhet të marrë masa për forcimin e këtyre lidhjeve, për shkëmbimin e delegacioneve, të materialeve, etj. Të popullarizojë në radhët e klasës sonë punëtore punën dhe rezultatet e klasës punëtore dhe të sindikatave sovjetike.

2 - Të mbahen lidhje të ngushta me Federatat Sindikale Botërore (FSB), të përkrahen aksionet dhe aktiviteti i saj, të vihen në jetë vendimet e saj dhe të popullarizohet ajo në radhët e punëtorëve tanë.

3 - Të forcohen lidhjet me sindikatat e vendeve të demokracisë popullore dhe me sindikatat e tjera përparimtare. T’u bëhen të njohura punëtorëve të vendit tonë, puna dhe rezultatet e tyre.

4 - Të merren masat e nevojshme me qëllim që të forcohet puna për popullarizimin e Republikës Popullore të Shqipërisë, të realizimeve të klasës sonë punëtore, të sindikatave dhe të gjithë aktivitetit të vendit tonë në vendet e tjera. T’u dërgohet material punëtorëve shqiptarë në mërgim të cilët interesohen për t’u

117. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH “Mbi punën e sindikatave”, 7 qershor 1949, Dokumente kryesore të PPSH, -I Vëllimi II 1949 - 1956, Botimi i dytë, Tiranë, 1972, f.53.

118. Enis Sulstarova, “Nga Magnitogorski në Maliq: Shënime për “qytetërimin stalinist” Revista “Shenja”, korrik 2022.

informuar mbi sukseset që arrin Shqipëria e re.¹¹⁹ Ajo që bie në sy në pikën katër është kujdesi që tregohet për klasën punëtore në emigracion. Bëhet fjalë për shqiptarët në Sh.B.A, Argjentinë dhe në Francë që përbënin numrin më të madh të shqiptarëve punëtorë të emigruar gjatë viteve të mbretërisë. Mes këtyre diasporave, regjimi komunist shqiptar do të përpiqej që të gjente mbështetës për të konfirmuar vetveten si një regjim i gjithë shqiptarëve dhe jo regjim ideologjik. Kontaktet mbaheshin nga aktivistët e vjetër sindikalistë si Mafuz Laze, që kishte qenë më parë në Francë dhe tashmë ishte një kuadër i lartë i lëvizjes sindikaliste në Shqipëri. Në fund vendimi i Byrosë Politike i datës 7 qershor 1949 “Mbi punën e Sindikatave” mbyllej me rekomandimin që të thirrej Kongresi II i Sindikatave brenda muajit shtator të këtij viti.(1949)¹²⁰. Përpara mbajtjes së Kongresit të Sindikatave u përcaktua dhe kuotizacioni, që duhej të paguanin punëtorët si anëtarë të sindikatave. Sipas vendimit nr. 503, datë 22.10.1949, kjo shumë duhej të ishte 0.50% në llogari të Këshillave Sindikale mbi shumën e përgjithshme të rrogave.¹²¹

Kongresi i II i Sindikatave u mbajt në 28.10.1949 prej nga u mor vendimi që të emërtoheshin Bashkimet Profesionale të Shqipërisë. Kongresi i II i Sindikatave hodhi bazat për shndërrimin e lëvizjes sindikaliste në Shqipëri nga një lëvizje me tipare sindikaliste në një lëvizje këshillash punëtorësh të nënshtruar ndaj PPSH dhe shtetit totalitar komunist. Duke qenë se PPSH karakterizohej si parti punëtore revolucionare, marksiste dhe radikale reformat që ndërmori në jetën sociale, tregun e punës dhe politikën e jashtme reflektonin antagonizmin e papajtueshëm me sistemin kapitalist. Për këto parti, sistemi kapitalist jo vetëm i përkeqësoi kushtet e jetesës dhe të drejtat e punëtorëve, por përmes shfrytëzimit të vazhdueshëm të tyre edhe i tjetërsoi dhe i la prapa ata shoqërisht, kulturalisht, etj. Po ashtu, problem parësor i klasës

119. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH “Mbi punën e sindikatave”, 7 qershor 1949, Dokumente kryesore të PPSH, -I Vëllimi II 1949 - 1956, Botimi i dytë, Tiranë, 1972, f. 53-54.

120. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH “Mbi punën e sindikatave”, 7 qershor 1949, Dokumente kryesore të PPSH, -I Vëllimi II 1949 - 1956, Botimi i dytë, Tiranë, 1972, f.54.

121. Vendim nr. 503, datë 22.10.1949. Mbi derdhjen 0.50% në llogari të Këshillave Sindikale mbi shumën e përgjithshme të rrogave.- Gazeta Zyrtare Nr. 84, 17 Nëntor 1949, f. 2.

punëtore nuk është vetëm keqpagimi apo kushtet në punë, por njëkohësisht edhe ndarja e punëtorit nga mjetet e prodhimit, dhe për pasojë sundimi i tij në qendrën e punës nga pronarë të cilët padrejtësisht zotërojnë këto mjete.¹²²Për këtë arsye pronarët e fabrikave të vogal të duhanit, sapunit, miellit, blajës, etj ishin shpronësuar dhe tatuarpërtë ashtuquajtura fitime të jashtëzakonshme gjatë luftës. Reforma agrare në 1946 zgjidhi problemin e tokës për fshatarësinë, por nuk lejoi transaksionet e shitjes dhe të blerjes. Që në momentin që filloi reforma iu nënshtrua kolektivizimit sipas shembullit sovjetik. Fshatarësia konsiderohej si klasa aleate me klasën punëtore që kjo e fundit duhet ta ndërjegjësonte për rolin e saj në shoqëri. Meqenëse kapitalizmi në botëkuptimin komunist konsiderohej si i pashërueshëm, partitë revolucionare synojnë kapërcimin e tij dhe ndërtimin e një shoqërie të re në rastin e Shqipërisë, shoqëri socialiste.¹²³

Organizimi i ri i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë iu nënshtrua pikërisht këtij prizmi ideologjik, ndaj dhe ato u drejtuan nga personalitete të profilit të lartë të politikës shqiptare të kohës të ardhur kryesisht nga radhët e klasës punëtore, si Pilo Peristeri (1952-1958) Gogo Nushi (1958-1970) dhe Rita Marko (1970-1982). Është paradoksale që disa nga veprimtarët e hershëm të lëvizjes sindikaliste si Mafuz Laze apo punëtorë nga Korça dhe Shkodra nuk u gjendën në pozitat e larta drejtuese por vazhduan aktivitetin si aktivistë së bashku me aktivistë të tjerë burokratë si Qimo Kocani, Llambi Kudra, Qamil Peshqeshi, Hasan Alimerko, Nebahete Bakiri, Viollanda Cicko, Vangjel Mëhilli, Idriz Dhrami, Fahrije Saliçaj, Nimet Cani, etj.

Pavarësisht kombinimit të brezave mes sindikalistëve të vjetër dhe atyre të rinj me udhëheqjen politike, në organizimin e BPSH-së mbizotëruan parimet leniniste të të kuptuarit të lëvizjes sindikaliste. Koncepti leninist mbi organizatat e pavarura klasore

122. Arlind Qorri, "Vendi i sindikalizmit në lëvizjet punëtore dhe format kryesore të lëvizjeve sindikale", Teza 11, 22 Mars 2013, vizituar site-in në 25 maj 2022. <https://teza11.org/vendi-sindikalizmit-ne-levizjet-punetore-dhe-format-kryesore-te-levizjeve-sindikale/>.

123. Arlind Qorri, "Vendi sindikalizmit në lëvizjet punëtore dhe format kryesore të lëvizjeve sindikale", Teza 11, 22 Mars 2013, vizituar site-in në 25 maj 2022. <https://teza11.org/vendi-sindikalizmit-ne-levizjet-punetore-dhe-format-kryesore-te-levizjeve-sindikale/>

të proletariatit, është i lidhur pazgjidhshmërisht me domosdoshmërinë e një ideologjie të caktuar dhe pikërisht me ideologjinë e proletariatit, marksizëm-leninizmin. Jashtë kësaj ideologjie, çdo organizatë mund të jetë çfarëdo e mund të ketë nga mbrapa njëqind herë epitetin “proletare”, por vetëm organizatë klasore proletare ajo nuk mund të jetë. Këtu e kishte fjalën Lenini kur theksonte: “Të punojmë me këmbëngulje në bashkimet profesionale, të punojmë në të gjitha fushat për përhapjen e teorisë revolucionare të marksizmit në radhët e proletariatit dhe për krijimin e një “kështjelle” të organizatës së klasës”¹²⁴. U braktis modeli teorik i sindikalizmit që kishte filluar në vitet 20’-30’ pasi ai i përshtatej partive punëtore të tipit reformuese dhe jo revolucionare si ishte PPSH. Sindikalizmi i përshtatet më shumë karakterit të lëvizjeve punëtore reformuese. Pavarësisht se e konsideron kapitalizmin si sistem ekonomik, ku të drejtat dhe interesat e punëtorëve nëpërkëmben, sindikalizmi i qëndron idesë se përmes formave të larmishme të organizimeve dhe rezistencës kapitalizmi është i reformueshëm në të mirë të klasës punëtore. Njëlloj si partitë reformuese, sindikalizmi nuk e konsideron zhveshjen e punëtorëve nga pronësia mbi mjetet e prodhimit si kusht të emancipimit punëtor. Ndryshe nga partitë reformuese, fushëbeteja e sindikalizmit nuk është sfera politike (zgjedhjet politike, parlamenti, etj), por sfera ekonomike. Po ndryshe nga të mësipërmet, sindikalizmi i grupon punëtorët në bazë të qendrës së punës, profesioneve apo edhe më gjerë duke përfshirë krejt klasën punëtore, por pa përfaqësuar interesat e grupeve të tjera shoqërore afër vetes.¹²⁵

Ndërkohë me sovjetizimin e saj të plotë, Shqipëria në vitet ‘50 kishte kaluar nga statusi i vendit gjysmësatelit në statusin e vendit satelit. Shkëmbimet dhe ndihma politike, ekonomike dhe kulturore e Bashkimit Sovjetik për Shqipërinë ishin intensifikuar shumë. Nuk kishte fushë të jetës, ku të mos ndihej prania sovjetike. Në politikën e jashtme: Shqipëria ndiqte hap pas hapi politikën

124. V. I. Lenin, Vepra, vëll. 13, f. 186.

125. Arlind Qorri, “Vendi sindikalizmit në lëvizjet punëtore dhe format kryesore të lëvizjeve sindikale”, Teza 11, 22 Mars 2013, vizituar site-in në 25 maj 2022. <https://teza11.org/vendi-sindikalizmit-ne-levizjet-punetore-dhe-format-kryesore-te-levizjeve-sindikale/>

dhe diplomacinë sovjetike duke iu përshtatur në çdo drejtim gjeostrategjisë së saj, po ashtu në organizimin e strukturës shoqërore përfshi dhe Bashkimet Profesionale. Pas vdekjes së Stalinit në datën 5 mars 1953 filloi periudha e quajtur si “shkrirja e akujve” që nënkuptonte liberalizimin e sistemit komunist sovjetik. Moska zyrtare u kërkoi qeverive satelite që buxhetet e tyre të shkonin më shumë për plotësimin e nevojave të popullsisë me produkte ushqimore dhe mallra konsumi, qeveritë të aplikonin politika më liberale tregu dhe shërbimesh për qytetarët, të ndërprisnin për një kohë ngritjen e kooperativave në fshat, etj.¹²⁶ Në këtë mënyrë, Moska kërkoi që pakënaqësitë e ndryshme në Europën Lindore t’i zbuste përmes një politike më liberale në ekonomi. Këtë lloj liberalizimi Kremlini kërkoi ta shtrinte edhe në politikën e brendshme të vendeve të Bllokut Lindor duke ndërprerë politikat e terrorit stalinist dhe promovuar një politikë më liberale lidhur me trajtimin e kundërshtarëve politikë dhe përmirësimin e të drejtave themelore të njeriut, si e drejta e lëvizjes, e drejta e punës dhe e drejta e fjalës. Moska kërkoi po ashtu amnisti të gjera për të arratisurit dhe të burgosurit politikë, liberalizimin e kufijve midis vendeve socialiste, prishjen e kampeve të punës ose të qendrave të internimit.¹²⁷ E gjithë kjo politikë e re sovjetike u emërtua Kursi i Ri Sovjetik. Formalisht ai u pranua dhe në Tiranë, por gjatë zbatimit u frenua hap pas hapi.¹²⁸ Pjesë e këtij frenimi ishte edhe vazhdimësia ideologjike e shoqërisë shqiptare ku një peshë të rëndësishme e forcimit të ndikimit të PPSH-së zinin edhe kontrolli mbi të ashtuquajturat organizatat e masave. PPSH, përse i përket organizmit të Bashkimeve Profesionale mbështetej mbi parimin leninist që ishte aplikuar dhe në shoqërinë sovjetike dhe nënvizonte faktin, se tendenca për t’i afruar dhe për t’i lidhur Bashkimet Profesionale me partinë; kjo duhet të jetë politika jonë”¹²⁹. Në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, të mbledhur me datën 1-2 prill 1958, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, Enver Hoxha, pasi dëgjoji dhe

126. Ana Lalaj, Pranverë e rrejtshme e ‘56, Infobotues, Tiranë, 2015, f. 32.

127. Ana Lalaj, Pranverë e rrejtshme e ‘56, Infobotues, Tiranë, 2015, f. 32.

128. Po aty, fq. 32.

129. V. I. Lenin, Veprat, vëll.13, f.113.

shqyrtoi raportin e Byrosë Politike “Mbi masat për përmirësimin e mëtejshëm të punës në Bashkimet Profesionale të Shqipërisë” - mbajtur nga Pilo Peristeri, u theksua edhe njëherë tjetër vizioni dhe roli që PPSH kishte për Bashkimet Profesionale. Në rezolutë mes të tjerash thuhej se Bashkimet Profesionale të Shqipërisë, si organizata më e gjerë e klasës punëtore dhe e masave punonjëse, të krijuara me nismën dhe kujdesin e Partisë, sipas mësimëve leniniste dhe eksperiencës së Bashkimeve Profesionale Sovjetike, kanë luftuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e programit të Partisë në të gjitha etapat e ndërtimit socialist të vendit tonë: në luftën për konsolidimin e rendit të ri popullor, në forcimin e aleancës me fshatarësinë punonjëse, në perfeksionimin e aparatit shtetëror, në forcimin e miqësisë dhe bashkëpunimit me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të kampit socialist.¹³⁰ Ideologjizimi dhe varësia e Bashkimeve Profesionale nga PPSH tashmë pranohej si një realitet dhe klasës punëtore i visheshin detyra mesianike përveç objektivave standardë të një lëvizjeje sindikaliste. Në rezolucion theksohej se Ato (Bashkimet Profesionale) zbatuan drejt parullën “fytyrën nga prodhimi” dhe u bënë një nga levat më të rëndësishme për të tërhequr masën e punëtorëve, të intelektualëve, nëpunësve në administrimin e ekonomisë, në luftën për rritjen e rendimentit të punës dhe të prodhimit, për zgjerimin e nismës dhe aktivitetit krijues të klasës punëtore nëpërmjet zhvillimit të emulacionit socialist dhe përhapjes së përvojës së përparuar, për zbatimin e kontratave kolektive, sistemit të pagave, kategorizimit dhe normimit të punës.¹³¹ Termat si emulacioni socialist dhe rritja e rendimentit në punë pa u reflektuar në rritjen e rrogave që në ekonominë socialiste caktoheshin fiks dëshmonin se Bashkimet Profesionale para se të përmbushnin detyrimet e tyre sindikaliste mbi të gjitha i shërbenin ideologjisë marksiste-leniniste që Partia-Shtet kishte instaluar në Shqipëri. Bashkimet Profesionale – citohej në rezolutë- kanë punuar për edukimin e klasës punëtore me mësimet e Marksizëm-Leninizmit, për ngritjen e nivelit të saj

130. Plenumi IX i KQ të PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958. Dokumente kryesore të PPSH, vëllimi III (1957-1961), f. 170-184; Gazeta “Zëri i Popullit”, Nr. 82, datë 6 prill 1958.

131. Plenumi IX i KQ të PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958, Dokumente kryesore të PPSH, vëllimi III (1957-1961), f. 170-184, Gazeta “Zëri i Popullit”, Nr. 82, datë 6 prill 1958.

kulturor dhe teknik.¹³² Gjithsesi pavarësisht faktit të ndërvarësisë nga PPSH, si pjesë e aparatit centralizues qeveritar Bashkimeve Profesionale u njihej e drejta e kontrollit mbi legjislacionin që rregullonte marrëdhëniet e punëtorëve me ndërmarrjet shtetërore dhe detyrimet që u lindnin këtyre të fundit për t'i respektuar të drejtat themelore të punëtorëve. Madje moskontrolli efikas nga Bashkimet Profesionale konsiderohesh një dobësi në punën e tyre të përditshme. Në udhëheqjen e PPSH kishte pakënaqësi për mënyrën e organizimit të Bashkimeve Profesionale, ndaj në rezolutë thuhej se... në punën e Bashkimeve Profesionale vërehen ende shumë dobësi. Influenca e tyre në zgjidhjen e problemeve të prodhimit dhe në përmirësimin e punës së ndërmarrjeve nuk ndihet sa duhet dhe kudo. Ato nuk ushtrojnë kurdoherë të gjitha të drejtat që u janë dhënë përsa i përket zbatimit të legjislacionit të punës, kontratave kolektive dhe dispozitave të tjera mbi kushtet e punës dhe të jetesës së punonjësve.¹³³ Sipas mendimit të gjerë të Plenumit të IX të KQ të PPSH-së... këto dobësi e kishin burimin në punën e pamjaftueshme të vetë forumeve dhe kuadrove që punojnë në Bashkimet Profesionale në qendër dhe në bazë. Këshilli Qendror i BPSH nuk ka luftuar si duhet për të zbatuar plotësisht direktivat e Partisë për rritjen e rolit të organizatave profesionale në radhë të parë në prodhim, për gjallërimin e tyre. Ai kontrollon dobët vendimet që merr, nuk studion si duhet dhe nuk sjell mirë e në kohën e duhur në Komitetin Qendror të Partisë dhe në qeveri probleme të rëndësishme që dalin në punë e sipër. Organizatave në rrethe dhe në bazë u jepet një ndihmë e pakët dhe jo sa duhet e kualifikuar nga qendra.¹³⁴ Dëshira për të rritur këtë kontroll punëtor jo vetëm në efikasitetin e Bashkimeve Profesionale por edhe mbi fusha të tjera do të sillte gradualisht 10 vjet më vonë lindjen e kontrollit punëtor dhe fshatar mbi të gjitha segmentet e shoqërisë shqiptare. Kontrolli punëtor e fshatar ishte formë e organizuar kontrolli që

132. Plenumi IX i KQ të PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958, Dokumente kryesore të PPSH, vëllimi III (1957-1961), f. 170-184, Gazeta "Zëri i Popullit", Nr. 82, datë 6 prill 1958.

133. Plenumi IX i KQ të PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958, Dokumente kryesore të PPSH, vëllimi III (1957-1961), f. 170-184, Gazeta "Zëri i Popullit", Nr. 82, datë 6 prill 1958.

134. Plenumi IX i KQ të PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958, Dokumente kryesore të PPSH, vëllimi III (1957-1961), f. 170-184, Gazeta "Zëri i Popullit", Nr. 82, datë 6 prill 1958.

drejtohej nga komitetet e PPSH-së së rretheve. Në to merrnin pjesë përgjithësisht njerëz me nivel të ulët arsimor të cilët kërkonin llogari për zbatimin e normave komuniste në sferat e jetës. Në një raport të vitit 1977, thuhej se ishin aktivizuar në kontrollin punëtor e fshatar plot 74.921 persona. Tërhiqte vëmendjen shifra se 30.845 prej tyre ishin gra dhe 53.949 persona pa parti. Kontrollohet në bazë të vendimeve të Këshillit të Ministrave merrnin dieta për ditët e “shërbimeve”. Më mirë paraqiteshin grupet e kontrollit punëtor e ushtar. Parime të organizimit të këtij kontrolli hasen të paktën nga viti 1968. Gjithnjë operohej në bazë të vendimeve të Byrosë Politike, ndërsa në fillim të vitit 1990, duke mos kuptuar fare ndryshimet që po vinin, udhëheqja e PPSH-së kaloi për miratim një projektligj për kontrollin punëtor e fshatar. Nuk u miratua për shkak të zhvillimeve politike që erdhën.¹³⁵

Një nga aspektet e rëndësishme të zhvillimit ekonomik gjatë sistemit njëpartiak me ekonomi të centralizuar ishte realizimi i planeve vjetore dhe rritja e rendimentit në prodhim. Këto dy aspekte ishin kthyer në dy shtylla kryesore edhe të aktivitetit të Bashkimeve Profesionale dhe llogaridhënies së tyre ndaj organeve partiake në bazë dhe në qendër. Modeli ekonomik shqiptar që një model që karakterizohej nga masat shtrënguese ndaj fshatarësisë dhe sforcimit për të ndërtuar baza industriale të papërbalueshme nga buxheti i shtetit. Pas shkrirjes së akujve dhe fillimit të Kursit të Ri Sovjetik në ekonomi më 1953, udhëheqësit e rinj të Kremlinit ia thanë hapur udhëheqjes shqiptare se ju e vidhni, e grabisni fshatarësinë. Me të filluar fshatari të mëkëmbë ekonominë, ju menjëherë nxirrni ligje e urdhëresa dhe ia rrëmbeni. Në 200.000 tonë prodhim, t'i marrësh 50.000 tonë fshatarësisë si taksë në natyrë, kjo është vjedhje.¹³⁶ Në të njëjtin kontekst, për të përmirësuar jetesën dhe furnizuar popullin me mallra të konsumit të përditshëm dhe ushqime, Moska ndërhyri në vitin 1953 të hiqeshin nga plani një fabrikë për shkrirjen e çelikut, një fabrikë letre, fabrikë qelqi, si dhe të shtyhej për pesë vitet e ardhshëm ndërtimi i hidrocentralit

135. Kastriot Dervishi, Kontrolli punëtor e fshatar me 75 mijë veta. E premte, 05.11.2021, <http://www.zem-rashqiptare.net/neës/58637/kastriot-dervishi-kontrolli-punetor-e-fshatar-me-75-mije-veta.html>

136. AQSH, F.14/AP-OU, V.1953, L. 1, D.23, “Procesverbal i mbledhjes së Byrosë politike të KQ të PPSH, 20 qershor 1953. Cituar sipas Ana Lalaj, Pranverë e rrejtshme e '56, Infobotues, Tiranë 2015, f. 23.

mbi lumin e Matit dhe i një rafinerie naftë.¹³⁷ Këto reduktime në shpenzime për investime u kërkua që të shkonin në furnizimin e popullsisë me mallra konsumi dhe në ndihmë të ekonomisë së fshatit. Udhëheqja komuniste shqiptare i mori parasysh këto udhëzime dhe bëri përmirësimet e këshilluara në mbledhjen e Byrosë Politike, më 22 qershor 1953: mori një vendim nr 227 që shprehte politikën e re në ekonomi dhe në planin e brendshëm. Gjithsesi pavarësisht këtyre masave ideologjizimi në ekonomi vazhdoi me ritme të larta duke reflektuar edhe në gjendjen ekonomike të klasës punëtore të porsaformuar në Shqipëri. Nga popullsia aktive shqiptare kërkoheshin sakrificat në emër të rindërtimit të vendit dhe ndërtimit të socializmit duke anashkaluar detyrimet sociale dhe përmbushjen shpeshherë të kushteve bazë në punë dhe prodhim. Garat socialiste midis ndërmarrjeve me emulacionet socialiste të fryra u kthyen shpeshherë në makthin e klasës punëtore që në kushte të vështira dhe me stimuj moralë të pakët i kërkoheshin për rritjen e rendimentit të punës, “*për realizimin e planeve ekonomike si detyrën e tyre të parë, të përhershme dhe me përgjegjësi*”.¹³⁸ Plenumi në të njëjtën kohë përveçse shënimit të arritjeve ekonomike dhe kërkesave për rritjen e prodhimit pranonte se kishte probleme përse i përket kontratave kolektive, caktimit të pagave dhe normimit të punës. Mirëpo ato nuk shiheshin vetëm si detyrime për t’u plotësuar nga shteti për të rritur mirëqenien e punëtorëve, por edhe në prizmin ideologjik në funksion të realizimit të planeve ekonomike qeveritare. Kontratat kolektive-thuhej në rezolutën e Plenumit të KQ të PPSH-së më 1-2 prill 1958- janë një mjet me shumë rëndësi në mobilizimin e punonjësve për realizimin e planeve të prodhimit dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës së tyre. Kontratat kolektive të hartohen njëkohësisht me projektin e planit në ndërmarrje, në mënyrë që të përfshihen aty propozimet e drejta të punëtorëve. Ato të hartohen në përputhje me ligjet dhe planin e shtetit, në bazë të kushteve, të nevojave dhe të mundësive të çdo ndërmarrjeje, duke pasur për qëllim shfrytëzimin e të gjitha

137. Ana Lalaj, Pranverë e rrejtshme e '56, Infobotues, Tiranë, 2015, f. 22.

138. Plenumi IX i KQ të PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958. Dokumente kryesore të PPSH, vëllimi III (1957-1961), f.170-184, Gazeta “Zëri i Popullit”, Nr. 82, datë 6 prill 1958.

rezervave të brendshme. Bashkimet Profesionale dhe organet shtetërore të forcojnë kontrollin, me qëllim që kontratat kolektive të realizohen plotësisht nga të dy palët.¹³⁹ Po njëlloj mendohej edhe për caktimin e pagave dhe normimin e punës, ku ato nuk caktoheshin sipas tregut dhe ofertës, por në bazë të orientimeve ideologjike dhe mbledhjeve burokratike mes Bashkimeve Profesionale dhe dikastereve të ndryshme ekonomike. Në udhëheqjen partiake dhe qeveritare shqiptare ndihej shqetësimi i mosnjohjes mirë nga ana e Bashkimeve Profesionale të proceseve ekonomike dhe shpërdorimit të fondeve ekonomike në paga, moscaktimit të drejtë të normave, etj. Ky shqetësim reflektonte frikën se për shkak të rritjes së volumit të punës, për shkak të investimeve dhe kredive të marra në kuadër të KNER-it, klasa punëtore paguhej më mirë dhe kjo sipas ideologjisë marksiste mund të nxiste krijimin e një aristokracie të mundshme të klasës punëtore në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, si industria minerare, kantieret e ndërtimit të veprave industriale, etj. Për këtë arsye kërkohej që kontrolli ekonomik dhe ideologjik të ishte i dyfishtë si nga ana e dikastereve qendrore po aq dhe nga Bashkimet Profesionale. Në rezolutën përfundimtare të Plenumit të lartpërmendur thuhej: Të forcohet edhe më shumë bashkëpunimi midis dikastereve, organeve ekonomike shtetërore dhe Bashkimeve Profesionale. Të respektohet rregulli i caktuar që problemet e pagave, të normimit të punës dhe të jetës së punonjësve të shqyrtohen dhe të vendosen në mbledhje të përbashkëta të kolegjumeve të dikastereve dhe të Presidiumit e Sekretariatit të Këshillit Qendror të BPSH. Bashkimet Profesionale dhe organet ekonomike shtetërore të merren më shumë e më konkretisht me problemet e rëndësishme të pagave, kategorizimeve dhe normimit të punës. Sipas porosive të Partisë, organet e shtetit dhe Bashkimet Profesionale kanë punuar për të përsosur sistemin e pagave dhe të normimit të punës; por në zbatimin praktik vërtetohen edhe gabime. Organet shtetërore dhe ato të Bashkimeve Profesionale nuk i njohin mirë, nuk i çmojnë si duhet dhe merren ende pak me këto probleme. Me qëllim që të zhduken të metat dhe të perfeksionojmë

139. Plenumi IX i KQ të PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958. Dokumente kryesore të PPSH, vëllimi III (1957-1961), f.170-184, Gazeta "Zëri i Popullit", Nr. 82, datë 6 prill 1958.

sistemin e pagave dhe të normimit të punës, plenumi porositi të merren këto masa:

a) Të punohet vazhdimisht për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të pagave. Të zgjerohet sistemi i stimuljeve materiale për kursimin e lëndës së parë dhe të materialeve kryesore, duke forcuar edhe kontrollin për zbatimin e tyre. Të merren masa në mënyrë që sistemi i punës me akord të zbatohet në ata sektorë ku praktikisht është i vështirë caktimi dhe kontrolli i normave ditore, si p.sh. në ndërtime, sharra, kumitë. Në sektorët e tjerë të zgjerohet puna me norma si një sistem më progresiv.

b) Të përmirësohet puna për përgatitjen e kuadrove të reja dhe të bëhet një shpërndarje më e drejtë e punëtorëve të kualifikuar. Bashkimet Profesionale dhe organet shtetërorë të jenë të kujdesshëm në kategorizimin e punëtorëve, për të mos lejuar përsëritjen e gabimeve të kaluara.

c) Komisioni i Planit të Shtetit dhe dikasteret të planifikojnë drejt fondin e pagave, të mos lejojnë fonde të tepërta që çojnë në përdorimin pa vend të fuqisë punëtore, punën suplementare, etj. Ministria e Financave dhe Komisioni i Kontrollit të Shtetit të jenë më të rreptë në këtë çështje.

ç) Normat statistikore eksperimentale fshehin rezerva të mëdha për rritjen e rendimentit të punës. Rritja e kualifikimit të punëtorëve, perfeksionimi i proceseve teknologjike, zbatimi i metodave të reja duhet të çojnë në zëvendësimin e normave të vjetra me norma të reja më të larta. Pra, është e nevojshme që organizatat profesionale dhe organet ekonomike të shqyrtojnë normat, kur krijohen mundësitë në përputhje me ndryshimet që ndodhin në procesin teknologjik dhe në kualifikimin e punonjësve. T'i kushtohet më shumë kujdes regjistrimit të saktë të punës me norma. Të merret mirë në dorë nga ministritë çështja e vendosjes së normave teknike, për të zbatuar me kohë vendimin e Kongresit III të Partisë. Të vihet më shumë rregull në hartimin, interpretimin dhe kontrollin e sistemit të pagave dhe të normimit të punës. Këshilli i Ministrave të studiojë mundësinë e krijimit të komitetit shtetëror

të pagave dhe të punës për të centralizuar më mirë këtë problem.¹⁴⁰ Sigurisht që ndihma ekonomike sovjetike dhe e vendeve të KNER-it përgjatë këtyre viteve kishte përmirësuar jetesën në Shqipëri dhe në këtë kuadër edhe klasa punëtore kishte përfituar në përmirësimin e trajtimit të saj ekonomik e shoqëror sipas skemave të organizimeve të tipit sovjetik, si mensa punëtorësh me çmime të ulta, pushime në shtëpi punëtorësh të ndërtuara në plazhet dhe zonat malore të Shqipërisë, kreditë e buta për strehim, si dhe ndërtimi i apartamenteve të reja, zbatimi i 8 orarëshit në punë, përmirësimi i sigurimeve shoqërore, kontrolli dhe përgjegjësia për sigurimin teknik në punë, luftën kundër epidemive, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, etj. Organeve ligjzbatuese dhe ndërmarrjeve ekonomike u kërkohet me rigorozitet përmirësimi i punës së tyre.

Rezoluta e Plenumit të IX të KQ të PPSH-së, që u mbajt në datë 1-2 Prill 1958 e bënte të qartë se Bashkimet Profesionale duhet të përsosnin aparatën e tyre burokratik për kontrollin e legjislacionit të punës, si më poshtë:

1. Vendosja e 8-orëshit në punë është një fitore e madhe për punonjësit tanë. Bashkimet Profesionale dhe organet ekonomike, duke punuar për një organizim më të mirë të punës, të luftojnë rastet e panevojshme, që shfaqen aty - këtu, për zgjatjen e kohës së punës jashtë orarit. Lufta për të kufizuar punën jashtë orarit është lufta për rregull në punë, për realizimin e planit sipas grafikut, për mbrojtjen e ligjeve të nxjerra në interes të shtetit dhe të punonjësve. Këshilli Qendror i BPSH, organet e drejtësisë dhe ato të kontrollit të shtetit duhet të tregohen më të rrepta në këtë drejtim.

2. Të shtohet kujdesi, kontrolli dhe përgjegjësia për sigurimin teknik në punë. Kryesorja është ruajtja e jetës së njerëzve. Ndërmarrjet tona janë të reja dhe kanë të gjitha kushtet për të mënjeluar rreziqet në punë. Por ka ende të meta. Drejtuesit e disa ndërmarrjeve tregohen shumë herë të pakujdesshëm për plotësimin e masave mbrojtëse në punë dhe ka dikastere ekonomike që nuk sigurojnë si duhet mjetet mbrojtëse të

140. Plenumi IX i KQ të PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958. Dokumente kryesore të PPSH, vëllimi III (1957-1961), f.170-184, Gazeta "Zëri i Popullit", Nr. 82, datë 6 prill 1958.

nevojshme. Bashkimet Profesionale, nga ana e tyre, bëjnë mjaft lëshime në këtë drejtim. Është e domosdoshme që drejtuesit e ndërmarrjeve dhe të dikastereve të punojnë më seriozisht për të mbyllur të gjitha shtigjet, nga mund të vijnë rreziqet në punë, dhe të mos lejojnë të punohet jashtë rregullave të caktuara. Komisioni i Planit të Shtetit dhe Këshilli Qendror i BPSH të studjojnë më me kujdes nevojat e ndërmarrjeve dhe të sigurojnë mjetet përkatëse për mbrojtjen në punë. Këshilli Qendror së bashku me dikasteret të rishikojë rregulloret e vjetra të sigurimit teknik dhe të hartojë rregullore për ato degë, ku nuk ka të tilla. Organizatat profesionale, në bashkëpunim të ngushtë me organet ekonomike, të organizojnë mirë propagandën e sigurimit teknik në çdo ndërmarrje.

3. Nga viti në vit po shtohen investimet për banesat e punonjësve. Me kursimet e tyre dhe me kredinë shtetërore shumë punonjës kanë ndërtuar banesa personale. Gjithashtu, me shtesat e planit të dytë pesëvjeçar investimet për banesa rriten shumë. Por me gjithë këto problemi i strehimit paraqet akoma disa vështirësi, të cilat vijnë edhe për faktin që ndërmarrjet nuk realizojnë plotësisht e me kohë ndërtimin e banesave. Prandaj organizatat profesionale dhe organet ekonomike duhet të tregojnë më shumë kujdes për ndërtimin në kohë dhe me cilësi të mirë të banesave... Komitetet ekzekutive të ndajnë fondin e banesave për çdo ndërmarrje pasi të kenë marrë më parë edhe mendimin e këshillave profesionale të rretheve. Ndarja e banesave në ndërmarrjet të bëhet me vendim të përbashkët të drejtorisë dhe të komitetit profesional. Është e domosdoshme të aktivizohen më shumë punëtorët për administrimin e banesave, për zbulimin e tyre me punë vullnetare. Të formohen në apartamentet dhe në ndërtesat kolektive këshillat e banesave dhe të forcohet kontrolli shoqëror i Bashkimeve Profesionale.

4. Përmirësimi i mëtejshëm i shërbimit të sigurimeve shoqërore është një nga detyrat më të rëndësishme të Bashkimeve Profesionale. Ne kemi një sistem të plotë të sigurimeve shoqërore. Punonjësit janë materialisht të garantuar në të gjitha rastet e paaftësisë së përkohshme, të invaliditetit, të pleqërisë e të tjera. Nga sigurimet shoqërore janë shpenzuar çdo vit miliona lekë për shtëpitë e pushimit të punëtorëve dhe të pionierëve,

për sanatoriumet e mensat dietetike. Bashkimet Profesionale nuk luftojnë si duhet për uljen e paaftësisë së përkohshme, për organizimin e ndihmës shoqërore për të siguruarit. Ato duhet të marrin masa që ta përmirësojnë më tej shërbimin e sigurimeve shoqërore për punonjësit, duke pasur parasysh:

a) Të shtojnë luftën e tyre kundër epidemive, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, me qëllim që të ulen paaftësia e përkohshme në punë. Është e nevojshme që të shtohet puna për edukatën sanitare me punonjësit dhe për shërbimin shëndetësor profilaktik në ndërmarrje. Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Këshillin Qendror dhe me ministritë përkatëse, të pregatisin një plan me afat të gjatë për zgjerimin e rrjetit shëndetësor në qendrat e punës dhe për plotësimin e tij me kuadrot e domosdoshëm. Organet e planifikimit dhe Ministria e Shëndetësisë t'u japin precedencë qendrave të punës, e në radhë të parë atyre jashtë qyteteve, në shpërndarjen e kuadrove shëndetësore të lartë e të mesëm. Ministria e Shëndetësisë dhe organizatat profesionale të shtojnë kontrollin në institutet shëndetësore, me qëllim që të përmirësohet shërbimi për punonjësit. Bashkimet Profesionale të kuptojnë se detyrë kryesore në lëmin e sigurimeve shoqërore është ruajtja e shëndetit të punonjësve, shërbimi për të sëmurët. Ato duhet të zgjerojnë edhe më shumë rrjetin e shtëpive të pushimit të punëtorëve dhe të pionierëve në qendrat kryesore klimaterike të vendit tonë dhe të sigurojnë në to një shërbim më të mirë dhe të kulturuar.

b) Bashkimeve Profesionale u janë besuar mjete të shumta financiare dhe ato duhet të jenë mjaft të kujdesshëm që të përdoren me vend në interes të punonjësve. Të forcojnë kontrollin dhe revizionin, me qëllim që të mënjanojnë shpërdorimet. Për kontrollin e veprimtarisë financiare të sigurimeve shoqërore në ndërmarrjet të ndihmojnë edhe revizionet e Komisionit të Kontrollit të Shtetit, të Ministrisë së Financave, të dikastereve dhe të komiteteve ekzekutive. Fondet që krijohen nga kontributi i sigurimeve shoqërore të përdoren drejt dhe më me nikoqirllëk për këto qëllime. Bashkimet Profesionale të sigurojnë që punonjësit të

marrin drejt dhe në kohë shpërblimet që u takojnë, të zgjidhin me kohë kërkesat e tyre të ligjshme.

c) Me qëllim që të rregullohen disa boshllëqe dhe të perfeksionohet Ligja e sotme e Sigurimeve Shoqërore, Këshilli Qendror i BPSH të fillojë hartimin e Ligjës së re të Sigurimeve Shoqërore, duke përfshirë këtu edhe pensionet, i cili, përpara se t'i dërgohet për aprovim Kuvendit Popullor, të diskutohet me punëtorët. Të hiqen pensionet nga administrimi i Ministrisë së Financave dhe të kalojnë në Bashkimet Profesionale.

5. Të studiohen masat për forcimin dhe zgjerimin e ekonomisë ndihmëse, të cilat, sipas konditave të ndërmarrjeve, mund të jenë edhe të specializuara: bujqësore, blegtorale, etj. Dikasteret të marrin masa që ekonomitë ekzistuese të bëhen të gjitha rentabile dhe të forcohet mbi to kontrolli për të mënjeluar shpërdorimet.

6. Kontrolli shoqëror mbi rrjetin e tregtisë, të mensave, të depove, të magazinave, të dyqaneve është një mjet i fuqishëm për të përmirësuar punën e rrjetit të tregtisë dhe të ushqimit social. Në këtë drejtim roli i Bashkimeve Profesionale është i madh dhe ato duhet të kujdesen më shumë për aktivizimin e kontrollit shoqëror. Autoriteti dhe forca mobilizuese e Bashkimeve Profesionale varet shumë nga sa ato kujdesen për nevojat e jetës së punonjësve. Ato, në bashkëpunim me organizatat e gruas, të njohin më thellë nevojat e jetës së njerëzve, t'i ndihmojnë ata për të zgjidhur çështjet e familjes dhe personale. Realizimi i planit në ndërmarrje dhe përmirësimi i konditave të jetës së punonjësve janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën dhe prandaj Bashkimet Profesionale të luftojnë me të gjitha forcat për zbatimin e legjislacionit të punës, të kontratave kolektive, për të zgjidhur me kohë dhe drejt kërkesat dhe ankesat e punonjësve, për t'i ngritur këto probleme përpara Partisë dhe organeve shtetërore".¹⁴¹

Bashkimet Profesionale fituan në këtë mënyrë një peshë më të madhe politike dhe ekonomike brenda skemës drejtuese Parti-Shtet por si ndodhte zakonisht në regjimet njëpartiake, ku

141. Plenumi IX i KQ të PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958. Dokumente kryesore të PPSH, vëllimi III (1957-1961), f.170-184, Gazeta "Zëri i Popullit", Nr. 82, datë 6 prill 1958.

nuk ishin përcaktuar qartë kompetencat e institucioneve, kjo gjë krijoi burokratizëm dhe mbivendosje administrative, të cilat shpesh rëndonin mbi klasën punëtore. Deri në vitin 1961 për shkak të përfshirjes së Shqipërisë në skemat ekonomike të KNER-it si dhe vijueshmërisë së Kursit të Ri Sovjetik në ekonomi pati relativisht një rritje të mirëqenies së klasës punëtore në Shqipëri. Dalja e Shqipërisë nga Blloku Lindor më 1961, kokëfortësia për të vazhduar me ndërtimin e industrisë së rëndë përgjatë viteve në vazhdim, si dhe rritja e shpenzimeve ushtarake sollën ngadalësimin e rritjes ekonomike që u reflektua edhe në gjendjen ekonomike të klasës punëtore. Sërish dolën në skenë sakrificat dhe e ardhmja e ndritur për të cilën duhej punuar shumë dhe pa ndërprerje. Gjatë kësaj kohe u formësua “Njeriu i Ri” në epruvetën ideologjike të socializmit shqiptar, një reflektim i nacionalkomunizmit shqiptar si citohej dhe në Rezolutën e Plenumit të IX të KQ të PPSH-së, ku Bashkimeve Profesionale u kërkohesh të shtonin dhe të përmirësonin punën për edukimin politik dhe ideologjik të punëtorëve, të nëpunësve dhe të inteligjencies. “Heroizmat që tregon klasa jonë punëtore në ndërtimin e vendit, - thuhej në Rezolutën e Plenumit të IX të KQ të PPSH-së 1-2 Prill 1958, dëshmojnë për formimin e pikëpamjeve të reja të njerëzve tanë mbi punën, se po lind njeriu i ri, që mbi të gjitha vë interesat e atdheut e të popullit”.¹⁴²

142. Plenumi IX i KQ të PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958. Dokumente kryesore të PPSH, vëllimi III (1957-1961), f.170-184, Gazeta “Zëri i Popullit”, Nr. 82, datë 6 prill 1958.

Përfundime

Lëvizja sindikaliste në Shqipëri nisi në kushtet e një paraekonomie kapitaliste që mbizotëronte atëherë në territoret shqiptare si provinca perëndimore e Perandorisë Otomane. Kjo ekonomi karakterizohej nga dominimi i tejzgjatur i strukturave feudale dhe esnafore deri në gjysmën e shek XIX. Për shkak të dobësimit të vazhdueshëm të Perandorisë Osmane dhe për të mundësuar mbijetesën e vet, Perandoria Osmane veprroi në dy mënyra: Së pari, u detyra që t'u lejonte një regjim preferencial mallrave që borgjezia Europiane eksportonte në perandori. Këto të drejta që tregtarët e më vonë shoqëritë monopoliste Europiane gëzonin njihen si kapitulacione. Së dyti, Porta e Lartë ndërmoi një sërë reformash që synonin nga njëra anë rimëkëmbjen e makinës burokratike shtetërore sipas modelit perëndimor e nga ana tjetër shkatërrimin e strukturave tradicionale ekonomiko-shoqërore, si edhe nxitjen e zhvillimit të një ekonomie kapitaliste.¹⁴³ Pikërisht këto dy politika patën rezultatet e tyre edhe në Shqipëri dhe shërbyen si faktorë për shfaqjen e ekonomisë së tregut. Natyrisht në këto kushte lëvizja sindikaliste, ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit, që kishin hyrë vrullshëm në ekonominë kapitaliste, do të reflektonte në qëllimet e saj së pari luftën ndaj strukturave esnafore dhe arritjen gradualisht të të drejtave të klasës punëtore që në të shumtën e rasteve nuk ishte e ndërjegjishme për rolin e vet. Kjo fuqi punëtore e kishte origjinën kryesisht nga fshati dhe shtresat e rrënuara zejtare si pasojë e vërshimit të kapitalit të huaj. Në fushën e tregtisë së jashtme partneri kryesor, që mbulonte rreth 50% të kësaj tregtie me territoret shqiptare ishte Perandoria Austro-Hungareze. Shkodra si kryeqendra e veriut, qendra më e madhe urbane me popullsi kompakte shqiptare nën protektoratin kulturor dhe fetar të Austrisë që nga viti 1689, qyteti me marrëdhënie tradicionale tregtie me portet italiane të Adriatikut, u kthye në kryeqendrën e depërtimit të ekonomisë kapitaliste prej nga depërtuan idetë socialiste dhe sindikaliste në Shqipëri. Prej këndeje lindën edhe organizimet dhe shoqëritë e para, statutet e të cilave reflektonin ato të organizimeve të qyteteve italiane. Si dhe

143. Anelmo Spahija, "Në fillimet e lëvizjes sindikaliste shqiptare", Teza 11, 3 shtator 2016, vizituar site-in në 25 maj 2022. <https://teza11.org/ne-fillimet-e-levizjes-sindikaliste-shqiptare/>.

më herët kur çdo lëvizje politike dhe kulturore, që kishte ndodhur në Itali, fladi i tyre frynte edhe në territoret shqiptare, edhe lëvizja sindikaliste do të reflektonte modelin dhe strukturën prej shoqërive italiane, por tipologji të ndryshme që përcaktoheshin nga territori dhe zhvillimi i marrëdhënieve kapitaliste. Kontakti i Shqipërisë me vendet perëndimore u përforcua në vitet e Luftës së Madhe ku forcat austro-hungareze, franceze dhe italiane u dislokuan në pjesë të ndryshme të vendit. Mes këtyre forcave kishte disa veprimtarë socialistë kryesisht mes forcave shumëkombëshe austro-hungareze si aktivistë, si dhe atyre italiane që tërthorazi ndikuan në përhapjen e këtyre ideve.¹⁴⁴Të udhëhequr nga interesat e veta ushtarake, politike dhe ekonomike forcat austro-hungareze, italiane dhe franceze u kushtuan rëndësi të madhe qendrave urbane dhe zonave përreth tyre. Në këto qytete ata ndërtuan çdo gjë, që duhej nevojave të frontit. Në radhë të parë ata bënë një sërë punimesh drenazhimi në periferi të qyteteve dhe ngritën institucionin e shteteve përkatës të postë-telegrafës. Gjithashtu, me shpenzimet e prefekturave të qyteteve, ngritën spitalet civile të qyteteve me kapacitet 50-60 shtretër. Komandat për nevojat e ushtrive të tyre bllokuan gjithë lokalet me pronësi shtetërore. Italia ndërtoi edhe disa pallate e barka për të sistemuar ushtarët në Vlorë. Në të njëjtën kohë italianët montuan edhe një central elektrik për ndriçimin e limanit dhe të rrugëve kryesore të qytetit. U montuan tubacione të ujit të pijshëm, si dhe ujrave të zeza. Mullinjtë e blojës me motor edhe preset hidraulike të vajit, të vetmet njësi industriale të trashëguara në vitet e mëparshme, u vunë në shërbim të luftës. Në shpinë të godinës së bashkisë u ndërtuan edhe një sërë magazinash dhe furrash. Për qëllimet e saj komanda italiane ndërtoi edhe një oficinë mekanike. Ata ndërtuan edhe një fabrikë tullash dhe një punishte lëkurësh. Shoqëria italiane “SIMSA”, me qendër në Romë, bleu

144. Antonín Zápotocký (19 dhjetor 1884 – 13 nëntor 1957) ishte një politikan dhe burrë shteti komunist çek, i cili shërbeu si kryeministër i Çekoslovakisë nga viti 1948 në 1953 dhe president i Çekoslovakisë nga 1953 deri në 1957. Babai i tij ishte Ladislav Zápotocký, një nga themeluesit e Partisë Social Demokratike Çeke (ČSSD), së bashku me Josef Boleslav Pecka-Strahovský dhe Josef Hybeš. Gjatë Luftës së Parë Botërore (1916-1918) shërbeu në Elbasan i inkuadruar në trupat austro-hungareze. Xhovani Valencia, socialist italian. Gjatë viteve 1916-1920 shërbeu në Vlorë. Gjatë viteve 1916-1920 shërbeu në Vlorë dhe ndihmoi lullëtarët shqiptarë në Luftën e Vlorës (1920). Shih Dorian Koçi. Tokat Çeke dhe Shqiptare. Toena, Tiranë, 2021, f.52-53 dhe Berndard Zotaj. Epopeja e Luftës në Vlorë, M & B, Tiranë, 2020, f.187.

minierën e Selenicës së Vlorës kundrejt një shpërblimi prej 1 700 000 liretash. Gjithashtu, u ndërtua edhe një fermë bujqësore. Të gjithë këto zhvillime urbane sollën si pasojë edhe ritjen në numër të fuqisë punëtore, çka bëri të mundur që në vitet e para '20 pas rithemelimit të shtetit shqiptar, pas Kongresit të Lushnjës, të kishte dhe organizime të reja sindikaliste dhe pikëpamje të majta rreth gjendjes së klasës punëtore në Shqipëri. Në gjirin e parlamentit të parë shqiptar kishte përfaqësues dinjitozë të së majtës si Stavro Vinjahu, anëtar i Partisë Socialiste Italiane, Ali Këlcyra i ndikuar nga idetë sociale në Stamboll gjatë kohës së studimeve të tij, Fan Noli dhe Luigi Gurakuqi të cilët në përgatitjen e Lëvizjes së Qershorit përfshinë dhe një fraksion të majtë të përfaqësuar nga Zija Dibra, Sejfulla Malëshova, Koço Tashko, Selim Shpuza, etj, të cilët në vitet 30' do të kthehen në eksponentë të rëndësishëm të së majtës komuniste. Kthimi në pushtet i Ahmet Zogut në dhjetor 1924 legjitimoi edhe njëherë triumfin e stratimit latifondist, si dhe vazhdimësinë e strukturave esnafore në ekonomi, çka solli si reagim krijimin e shoqërive sindikaliste brenda një profesioni siç ishte ajo e rrobaqepsëve apo këpucarëve në Korçë në 1934. Sigurisht që në qendrat industriale të përpunimit të naftës dhe bitumit si në Kuçovë dhe Selenicë, ku kishte një përqëndrim të klasës punëtore, organizmi sindikalist arriti në stadi të tjera të krahasueshme me ato në Europë. Mes këtyre organizimeve u shqua organizata "Puna" në Kuçovë e pasurur me eksperiencën e organizimit sindikalist francez të sjellë nga Mafuz Laze që kishte punuar dhe kishte qenë një aktivist sindikalist në Lion. Organizata "Puna" arriti që disa nga kërkesat bazë të një greve sindikaliste të realizohen duke dhënë shembullin pozitiv sesi brenda vetë sistemit mund të fitohen të drejtat legjitime të klasës punëtore. Ky është momenti kur në Shqipëri, pas një organizimi të brishtë komunist, grupet komuniste zgjerohen dhe vendosin kontakte të gjera edhe me klasën punëtore në qendrat industriale. Viti 1936 është një vit i rëndësishëm në historinë e Europës pasi ardhja në fuqi në Francë e qeverisë së Frontit Popullor të Leon Blumit, shpërthimit të Luftës së Spanjës, kërcënimit nazi-fashist ndaj paqes në Europë dhe riorganizimit

të Kominternit për të përçarur teza të reja të krijimit të fronteve popullorë në vende ku partitë komuniste ishin në minorancë, ndikuan dhe në politikat e së majtës dhe organizmit sindikalist edhe në vende periferike përsa i përket zhvillimit ekonomik si Shqipëria. Nga leximi i dokumentacionit të viteve ‘30 vihet re se komunizmi në Shqipëri synonte depërtimin në shkollat e mesme dhe në organizimet sindikaliste. Kjo lidhje midis modernitetit dhe komunizmit kishte rënë në sy dhe në raportet sekrete të xhandarmërisë zogiste, që ndiqte nga afër situatën në shkollat e e mesme të Shqipërisë. Në raportin mbi tendencat komuniste në shoqëri që Komandanti i Përgjithshëm i Xhandarmërisë, Shefki Shatku, i drejtonte Mbretit Zog në datën 5 korrik 1936 shkuhej se djalëria komuniste ndahet në tri kategori: 1. Komunistët e vërtetë; 2. Djemtë që thonë që janë komunistë vetëm për modernizëm dhe për t’u dukur intelektualë (reklamistë); 3. Të rinjtë që spekulojnë duke u hequr komunistë për interesa materiale.¹⁴⁵

Në vitin 1936 dolën udhëzimet e reja të Kominternit që e vinin theksin mbi organizimin e luftës popullore kundër rrezikut fashist dhe krijimin e frontit popullor. Këto udhëzime i solli në Shqipëri Koço Tashko në vitin 1937 dhe filluan të propagandoheshin nga Grupi Komunist i Korçës. Për shkak të zhvillimit të ngadaltë industrial në Shqipëri pati edhe grupe komuniste siç ishte ai i “Të Rinjve”, një fraksion i Grupit Komunist të Korçës, që mendonin se komunizmi ishte një doktrinë e importuar në Shqipëri, e nuk kishte një zhvillim të kushteve ekonomike e sociale të shoqërisë. Lëvizja komuniste kryhej nga intelektualët dhe veçanërisht nga studentët. Shqipëria ishte një vend i prapambetur agrar, pa industri, nuk kishte proletariatin industrial dhe rrjedhimisht as organizata proletare, ose të paktën asnjë si këto me qëllime ekonomike.¹⁴⁶Për më tepër progresi kolonial, që solli pushtimi i Shqipërisë nga Italia Fashiste në 7 prill 1939 i zbehu shpresat për një zhvillim të lëvizjes sindikaliste në Shqipëri. Për herë të parë shteti shqiptar hyri në një etapë të re moderniteti të manifestuar në zhvillim

145. Kastriot Dervishi, Lëvizja komuniste në vitet 1924-1944 dhe formimi i PKSH-së, Shëpia Botuese 55, Tiranë 2016, f. 117.

146. Kastriot Dervishi, Lëvizja komuniste në vitet 1924-1944 dhe formimi i PKSH-së, Shëpia Botuese 55, Tiranë, 2016, f. 171.

urban, modernizim administrate, kujdes shëndetësor e zhvillim social duke përfshirë dhe zmadhimin e tij në territore të banuar nga shqiptarë etnikë dhe në anën tjetër ishte suprimimi i shtetit shqiptar dhe lirive individuale nën një regjim fashist që drejtonte me dorë të hekurt gjithçka në Shqipëri. Gjithsesi antagonizmi midis komunistëve, lëvizjes sindikaliste dhe fashizmit ishte në një papajtueshmëri të plotë dhe sigurisht që do të sillte shumë shpejt dhe kontradiktat e para. Fashizmi, shkruante udhëheqësi i Kominternit Gjergj Dimitrovi, është ofensiva më e përgjakshme e kapitalit mbi masat punonjëse; fashizmi është shovinizmi i pa frenuar dhe lufta zaptuese; fashizmi është reaksioni i tërbuar dhe kundërrevolucioni, fashizmi është armiku më i egër i klasës punëtore dhe i mbarë popullit punonjës.¹⁴⁷Në këtë kontekst gjatë viteve 1939-1942, reagimet e para ishin spontane, sindikaliste dhe kërkonin kushte themelore për punonjësit si ngritje page, respektimi i tetë orarëshit, të drejtat për t'u organizuar në një sindikatë, etj. Pas hyrjes në politikën shqiptare të PKSH lëvizjet punëtore fillojnë e marrin karakter politik disa herë dhe sabotues ndaj mirëqenies siç ishin aksionet e derdhjes së rubinetave në Kuçovë apo hedhjen në lumë të bitumit në Selenicë. Rasti më flagrant ishte krijimi i Sindikatave Punëtore për Korçën në fillim të vitit 1943 ku krahas kërkesave të drejta për përmirësimin e mirëqenies së klasës punëtore dhe zejtarëve dilnin në pah dhe ideologjizimi komunist i sindikatës. Karakteri antifashist i sindikatës kaloi drejt një ideologjizimi të skajshëm duke lidhur fatin e vet me proletariatin rus dhe duke vendosur në këtë mënyrë bazat e sovjetizimit të idesë sindikaliste në Shqipëri. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, zhvillimit të zgjedhjeve të 2 dhjetorit, dështimit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe SH.B.A-së, si dhe Mbretërisë së Bashkuar sollli sovjetizimin e shpejtë të Shqipërisë në të gjitha fushat. Sovjetizimi i Shqipërisë u krye me asistencën e udhëheqjes jugosllave, aleatë të ngushtë të PKSH-së gjatë Luftës së Dytë Botërore. Menjëherë pas çlirimit të vendit filluan të dalin në pah synimet e komunistëve shqiptarë me Enver Hoxhën në krye për të

147. Kristaq Misha, Lëvizja punëtore në Shqipëri, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1970, f.341.

ecur përkrah Jugosllavisë së Titos deri në bashkimin me të në Konfederatën Ballkanike. Tendencat e para të këtij bashkëpunimi të ngushtë ideologjik u shprehën në mënyrë të hapur dhe shtetërore që në ndërtimin e shtetit të ri shqiptar. Institucionet kryesore u vendosën nën një diktat dhe këshillim të drejtpërdrejtë të këshilltarëve jugosllavë, që ishin atashuar pranë çdo dikasteri të rëndësishëm. Kryeministria, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë, Drejtoria e Sigurimit të Shteti, sipas dokumentacionit përkatës korrespondojnë dhe raportojnë në Beograd, duke vazhduar një traditë që kishte filluar që gjatë luftës. Të gjitha vendimet kryesore të politikës së jashtme dhe të brendshme të qeverisë shqiptare merreshin me dijeni dhe në bashkëpunim të plotë me autoritetet jugosllave në Beograd, duke krijuar *de facto* tiparet e një shteti nën protektorat. Këtij centralizimi ideologjiko-burokratik komunist nuk do t'i shpëtonte dhe organizimi i sindikatave, të cilat sipas modelit sovjetik duhet të ishin organizata të masave, që mbështesnin dhe zbatonin vijën e Partisë-shtet. Për të justifikuar numrin e ulët të klasës punëtore si klasë në minorancë në Shqipëri për shkak të zhvillimit të ulët ekonomik të Shqipërisë, PKSH në organizimin e sindikatave bënë për vete parimin leninist të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë. Kongresi i Parë i Bashkimit të Sindikatave të Shqipërisë i filloi punimet me 28 tetor 1945 në orën 15.00, në kinemanë “Kosova” në Tiranë. Presidenti i Këshillit Qendror të Sindikatave të Shqipërisë Tuk Jakova mbajti referatin politik, ndërsa referatin rreth problemeve organizative e mbajti Kristo Themelko. Nga Kongresi doli Këshilli Qendror i përhershëm i Sindikatave që zgjodhi Kryesinë, të përbërë prej 10 anëtarësh, ku bënë pjesë Presidenti, një Zëvendës-president, një Sekretar i Përgjithshëm, si dhe anëtarë të ngarkuar me ekonominë, politikën sociale, agjitacionin, kulturën, financën dhe dy anëtarë të tjerë. Nën drejtimin e Tuk Jakovës, lëvizja sindikale, si një organizim i ri, pati disa suksese. Para Kongresit pati përfunduar edhe ngritja e sindikatave sipas profesioneve, që u kurorëzua me themelimin e Bashkimeve Sindikale Profesionale:

si ajo e Punëtorëve dhe Nëpunësve të Minierave; Punëtorëve dhe Nëpunësve të Industrisë; Nëpunësve Shtetërorë, Punëtorëve dhe Nëpunësve të Nozullimit; Punëtorëve dhe Nëpunësve të Transportit; Punëtorëve dhe Nëpunësve të Ndërtimit. Në përbërje të administratës së Bashkimit të Përgjithshëm të Sindikatave, në vitin 1946 u krijua Seksioni i Kuadrit dhe Zyra e Statistikave, që krijoi mundësinë e ndjekjes më mirë të punës. Me 25 prill 1945, Tuk Jakova, në emër të Këshillit të Përgjithshëm të Sindikatave të Shqipërisë i kërkoi qeverisë që 1 Maji të shpallet festë zyrtare. Me 26 prill, një ditë më vonë, Këshilli i Ministrave, me vendimin Nr. 9 vendosi që dita e 1 Majit të jetë festë zyrtare.¹⁴⁸Për herë të parë lëvizja dhe organizimi sindikalist u shtri në mënyrë kapilare në të gjithë vendin. Shanset e reja që u paraqitën për zhvillimin progresist të lëvizjes sindikaliste u zbehën shpejt, kur u vërejt se në Shqipëri u instalua një regjim totalitar komunist, miqësor ndaj klasës punëtore por ndrydhës përsa i përket lirive individuale. Ideologjizimi i skajshëm u shtri edhe në organizimin sindikalist në Shqipëri, kryesisht mes vendimeve dhe rezolutave të hartuara në mbledhjet e Byrosë Politike dhe plenumet e Komitetit Qendror të PPSH-së. Mes tyre shquajnë Vendimi i Byrosë Politike të KQ të PPSH-së “Mbi punën në Sindikata”, 7 qershor 1949 dhe Komunikata e Plenumit të IX të KQ të PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958, të cilat hodhën bazat e konceptit leninist të organizimit të sindikatave të klasës punëtore në Shqipëri. Nga viti 1949 deri në vitin 1958 si rezultat i zhvillimeve ekonomike të ndërtimit të bazave të industrisë së rëndë, numri i klasës punëtore u rrit në Shqipëri dhe regjimi komunist i kushtoi një rëndësi të veçantë edukimit ideologjik komunist të saj. Përpjekjet e institucionalizuara, të cilat filluan që herët në themelimin e Bashkimit Sindikal në 1945, u intensifikuan në Vendimin e Byrosë Politike të KQ të PPSH-së “Mbi punën në Sindikata” të datës 7 qershor 1949, dhe u kthyen në një platformë të vërtetë në Plenumin e IX të KQ TE PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958. Me fitoren e revolucionit popullor,- thuhej në Plenumin e IX të KQ TE PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958, klasa

148. Tuk Jakova – Jeta dhe vepra, botime “Grand Prind”, Tiranë 2017, këtu: <https://shqiptarja.com/lajm/si-funksionuan-sindikatat-ne-br-shqipërine-e-45-46-tuk-jakova>.

punëtore u bë forcë kryesore dhe udhëheqëse e shoqërisë sonë. Në aleancë me fshatarësinë punonjëse. nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, ajo po kryen misionin e saj historik: të transformojë atdheun tonë nga një vend i prapambetur në një vend socialist të përparuar, të fuqishëm ekonomikisht, të pasur e të kulturuar. Bashkimet Profesionale të Shqipërisë, si organizata më e gjerë e klasës punëtore dhe e masave punonjëse, të krijuara me nismën dhe kujdesin e Partisë, sipas mësimave leniniste dhe përvojës së Bashkimeve Profesionale Sovjetike, kanë luftuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e programit të Partisë në të gjitha etapat e ndërtimit socialist të vendit tonë: në luftën për konsolidimin e rendit të ri popullor, në forcimin e aleancës me fshatarësinë punonjëse, në perfeksionimin e aparatit shtetëror, në forcimin e miqësisë dhe të bashkëpunimit me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të kampit socialist.¹⁴⁹ Në vitet 1940-1950, breza fshatarësh u shndërruan në punëtorë e intelektualë dhe gjatë procesit mësuan “gjuhën” e socializmit për të interpretuar botën dhe veten e tyre në të. Mbi të gjitha, socializmi u ofronte një horizont të modernizimit: autoritetet partiake sovjetike dhe shqiptare binin dakord se Shqipëria e viteve 1950 i ngjante Bashkimit Sovjetik në vitet 1930, dhe ky pohim do të thoshte se vendi më i varfër i kampit socialist në Europë mund të bëhej një vend industrial, duke ndjekur rrugën e përshkuar nga Bashkimi Sovjetik. Partiakët dhe specialistët shqiptarë dërgoheshin për ta marrë përvojën sovjetike në Gjeorgji, Armeni, Azerbaixhan, Dagestan e deri Uzbekistan, sepse, sipas këndvështrimit perandorak të komunistëve në Moskë, Shqipëria kishte elementë të përbashkët me këto republika periferike sovjetike.¹⁵⁰

Për më tepër Bashkimet Profesionale nga organizatë aktive për të drejtat e punëtorëve u kthye në organizatë ndihmëse të Partisë-Shtet. BPSH, si shkolla të komunizmit, shkruhej në statutin e BPSH-së-zhvillojnë një punë të gjithanshme për edukimin ideopolitik, klasor dhe revolucionar të anëtarëve që të armatosen

149. Plenumi IX i KQ të PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958. Dokumente kryesore të PPSH, vëllimi III (1957-1961), f.170-184, Gazeta “Zëri i Popullit”, Nr. 82, datë 6 prill 1958.

150. Elidor Mëhilli, “From Stalin to Mao”, Ithaca, Cornell University Press, 2017, fq. 54-61.

punonjësit me bindje të qëndrueshme për vitalitetin dhe epërsinë e rendit tonë socialist, të edukohen me frymën e patriotizmit socialist dhe të internacionalizmit proletar, të bëhen sa më të aftë nga ana profesionale, të pajisen me kulturë të gjerë e virtyte të larta komuniste. BPSH punojnë që të ngrihet më tej vetëdija e klasës punëtore për rolin dhe misionin e saj në shoqërinë socialiste si klasë në fuqi, BPSH i kushtojnë kujdes të veçantë mobilizimit të gjerë dhe pjesëmarrjes aktive të punëtorëve dhe punonjësve të tjerë në zhvillimin e ekonomisë, në hartimin e plotësimit të planeve ekonomike e shoqërore të shtetit, në zgjidhjen e problemeve të prodhimit.¹⁵¹ Ndryshimet kushtetuese në vitin 1950 pavarësisht faktit se sanksionuan udhëheqjen e klasës punëtore në qeverisjen e vendit e zbehën karakterin sindikalist të saj, pasi çdo kërkesë apo nevojë për përmirësimin e standardeve kalonin përmes filtrit ideologjik marksist. Parimi stalinist i ndërtimit të industrisë së rëndë në planet fillimisht 2 vjeçare dhe më vonë pesë vjeçare bëri të mundur që të rritej numri i klasës punëtore në Shqipëri por gjithsesi ajo nuk mund të shprehte lirisht vullnetin e vet politik pasi paradoksisht e ashtuquajtura diktatura e proletariatit vepronte si shpata e Demokleut edhe për të. Deviza e shoqërisë totalitare shqiptare përsa i përket pavarësisë së organizatave politike-profesionale ishte thënia e Enver Hoxhës se në shoqëri, sa kohë vazhdon lufta e klasave, asnjë njeri e jo më organizatë nuk mund të qëndrojë mbi klasat, mbi partitë, jashtë politikës dhe i pavarur nga politika.¹⁵² Në këtë mënyrë lëvizja sindikaliste shqiptare humbi sindikatat dhe konceptet sindikaliste të evolucionit dhe përmirësimit të gjendjes së vet ekonomike përmes instrumenteve sindikalistë si greva dhe u kthye në një këshillë punëtorësh sugjerues, që përmbante brenda statutit të vet disa koncepte sindikaliste si e drejta e tetë orarëshit dhe kontrata kolektive. Me zgjerimin e ekonomisë shtetërore dhe caktimin e pagave dhe normave fikse karakteri sindikalist erdhi duke zbehur dhe predominoi organizimi sovjetik i Bashkimeve Profesionale, organizatë ndihmëse e Partisë-Shtet.

151 Akademia e Shkencave e RPSSH. Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985, fq.70.

152. Spiro Dede, Kundërrevolucioni në kundërrevolucion, Shtëpia Botuese "8 nëntori", Tiranë, 1983, fq.206.

Shtojcë: Portrete sindikalistësh shqiptarë

Në këtë shtojcë po japim portretet e disa personazheve, të cilët me punën e tyre kanë ndihmuar në krijimin dhe zhvillimin e sindikalizmit në Shqipëri. Ndonëse sindikalizmi është një fenomen që u shfaq relativisht vonë në Shqipëri, në fillimshkullin XX dhe mori një trajtë më të plotë në vitet 1920-1930, me organizimin e lëvizjes punëtore, ai u ndikua nga protagonistët, përkrahësit dhe drejtuesit e kësaj lëvizjeje, të cilët ndikuan në zhvillimin e saj që ishte revolucionare për kohën. Të tillë ishin Shtjefën Ingrizi, Veli Hashorva, Mafuz Laze etj. Sikurse është theksuar edhe në këtë studim, pas çlirimit të vendit dhe me ardhjen e pushtetit komunist, lëvizja sindikale u vendos tërësisht nën tutelën e shtetit dhe u kthye në një instrument të Partisë-Shtet. Për të kuptuar më mirë këtë fenomen, vijnë në ndihmë edhe portretet e drejtuesve të BPSH, si Tuk Jakova, Pilo Peristeri, Gogo Nushi, etj, të cilët ishin funksionarë të lartë e të besuar të PKSH. Pra, në këto portrete po trajtojmë përfaqësues të gjithë niveleve të sindikalizmit shqiptar, qysh prej krijimit të tij e deri në vitet 1961, kohë që rrok në trajtim edhe ky studim.



Nikollë Ivanaj (1879-1951)

Nikollë Ivanaj i njohur edhe si Nikollë bej Ivanaj (1879 - 1951) ka qenë një gazetar, botues dhe shkrimtar shqiptar. Konsiderohej një nga “personalitetet më të dalluara i nacionalizmit shqiptar më të ndërgjegjshëm” dhe u përfshi në stafin e kryengritësve shqiptarë gjatë 1911. Në vitet 1905-1908 ai botoi gazetën “Shpnesa e Shqypnisë” në Dubrovnik, Trieste dhe Romë, duke marrë ndihmë financiare nga anë të ndryshme. Për veprimtarinë e tij si botues Ivanaj arriti të fitonte mbështetjen financiare të Albert Ghicës, një anëtar i familjes fisnike Ghica që mëtonte fronin shqiptar. Ai ishte një nga liderët e Komitetit Kombëtar, që u themelua në Podgoricë në fillim të vitit 1911 dhe ka marrë pjesë në organizimin e kryengritjes shqiptare. Fjalimi e tij i mbajtur për Shoqërinë Italiane të Shtypit më 26 janar, 1911 çmohet nga disa burime si

“një dokument historik me rëndësi jetike”. Ivanaj ishte edhe një nga pjesëmarrësit e Kongresit të Trieshtës të mbajtur në 1913, po atë vit ktheu në Shkodër, ku mori pjesë në klubin Lidhja Kombëtare të formuar rishtazi. Në janar të vitit 1919, filloi botimin e një tjetër gazete “Koha e Re” në Shkodër. Gjatë Konferencës së Paqes më 1919, përfaqësoi Partinë Politike nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në vitin 1923 së bashku me kushëririn e tij Mirash Ivanaj, botoi gazetën “Bashkimi” në Shqipëri dhe të përjavshmen “Republika” nga 1923 deri më 1925, po në Shkodër. Gjendej në Paris me mërgimtarët antizogistë kohën, kur shkoi Mbreti Zog dhe iu thur atentati dhe, pas dëbimit të mërgimtarëve shqiptarë në sajë të atentatit, shkoi në Paris po me antizogistët në prillin e atij viti. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Ivanaj botoi një libër autobiografik “Historija e Shqipëniës së Re”. “Vuejtjet e veprimet e mija” në dy pjesë, në vitin 1943 dhe 1945 përkatësisht, ku përqendrohet në rolin e klerit katolik. Pas marrjes së pushtetit nga Fronti Nacional-Çlirimtar, u mor me përkthime dokumentesh nga sllavishtja në shërbim të Institutit të Historisë. Gjithashtu, la një vëllim me poezi para se të vdiste më 1951 në Tiranë.¹⁵³

153. Bazuar në Akademia e Shkencave e RPSSH, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985.



Shtjefën Ingrizi (1882-1956)

Një nga veprimtarët dhe sindikalistët e parë të klasës punëtore shqiptare. Vinte nga një familje punëtori këpucar të qytetit të Shkodrës. Kreu shkollën fillore dhe shkollën teknike tregtare të qytetit dhe më pas ndoqi një shkollë për mekanik në Itali. Atje punoi si punëtor në kantierin detar të Venedikut. Më 1902 ai me shokë krijuan në Shkodër shoqërinë e parë punëtore (Shoqëria ndihmëtare). Në vitin 1905, punëtorët, shkodranë, të drejtuar prej saj, festuan për herë të parë në Shqipëri ditën e 1 Majit. Shtjefën Ingrizi u shkishërua si ateist dhe përkrahës i ideve socialiste. Pas Luftës së Dytë Botërore edhe pse ishte në moshë të thyer, shkriu energjitë si veteran me përvojë për organizimin e sindikatave të para (Bashkimeve profesionale). Vdiq në Shkodër.¹⁵⁴

154. Bazuar në Akademia e Shkencave e RPSSH , Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985.

Abdyl Jashari (1880-1963)

Ishte një nga bashkëpunëtorët e ngushtë të Shtjefën Ingrizit në Shkodër, gjithashtu ka qenë një nga organizatorët kryesorë të lëvizjes sindikale në qytetin e Shkodrës qysh prej fillimit të kësaj lëvizjeje. Ishte anëtar i shoqërive të ndryshme punëtore, që ishin formuar në të kaluarën në atë qytet dhe luftonte për të drejtat e punëtorëve.

Ndër radhët e sindkalistëve të vjetër që kanë dhënë kontribut të vlefshëm në organizimin e lëvizjes punëtore sindikale dhe që kanë marrë pjesë aktive në shoqëritë punëtore gjatë dy dekadave të para të shekullit XX janë edhe Filip Boshko, Simon Ranxi, Gaspër Gjon Alimhilli dhe shumë të tjerë.



Veli Hashorva (1892-1975)

Patriot demokrat dhe gazetar i dalluar. Veprimtarinë patriotike e filloi në qytetin e lindjes, në Gjirokastrë si anëtar i klubit «Drita» i themeluar atje më 1908. Më 1911 shkoi në Stamboll për studimet e larta dhe u kthye në Shqipëri më 1912. Si veprimtar i Lëvizjes Kombëtare, u ndoq dhe u persekutua nga forcat greke kur ato pushtuan Gjirokastrën, më 1913. Për t'u shpëtuar ndjekjeve të mëtejshme, në maj 1915 mërgoi në SHBA, ku punoi pranë Federatës «Vatra». Më 1916 botoi në Nju-Jork gazetën «Vjosa» me frymë politike kombëtare. U kthye në Shqipëri më 1919. Mori pjesë në Kongresin e Lushnjës si një nga përfaqësuesit e Gjirokastrës, në luftën e Vlorës më 1920, si edhe në lëvizjen demokratike që shpuri në Lëvizjen e Qershorit 1924. Në Gjirokastrë u themelua shoqëria «Drita», që ishte klub demokratik, arsimor, kulturor e politik. Ndryshe u quajt edhe klubi i «Opingarëve», meqë kishte për simbol një palë opinga, që personifikonin njerëzit e thjeshtë. Organi i saj ishte gazeta «Drita» që drejtohej nga Veli Hashorva. Shoqëria

“Drita” duket se ishte frymëzuar nga ide socialiste që kishin filluar dhe kishin zënë rrënjë në mjedisin shqiptar. Ka shumë të ngjarë që ashtu, si dhe studentë të tjerë në Stamboll, Veli Hashorva të lexonte idetë socialiste në gazetën Turk Huku (Drejtësia turke) që propagandonte ide socialiste. Për këtë arsye u bë edhe zëdhënësja e zërit të esnafëve dhe çirakëve të qytetit duke arritur rezultate të mira gjatë fushatave të zgjedhjeve për organet e larta të pushtetit më 1921 dhe më 1923. Me fitoren e Legalitetit në dhjetor të vitit 1924 mërgoi jashtë atdheut. Vdiq në Turqi.¹⁵⁵

155. Bazuar në Akademia e Shkencave e RPSSH , Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985.



Mafuz Laze (1899-1985)

Një nga organizatorët e parë të lëvizjes punëtore shqiptare. Lindi në Vlorë. Që në moshë të re hyri punëtor në Minierën e Serës së Selenicës. Më 1929 mërgoi në Francë ku punoi deri më 1934. Atje u përfshi në veprimtarinë e Komitetit të Çlirimit Nacional . Më 1931 u pranua anëtar i Partisë Komuniste Franceze. Në maj 1934 erdhi në Shqipëri me porosi të komunistëve shqiptarë në mërgim për organizimin e punëtorëve në Kuçovë . Me nismën e tij u formua atje më 1935 Shoqëria «Puna» e naftëtarëve . Mori pjesë në organizimin e drejtimin e grevës së përgjithshme të naftëtarëve të

11 shkurtit kundër kapitalistëve italianë dhe u përdoq nga qeveria zogiste. Pas pushtimit të Shqipërisë, u hodh në Luftën ANÇ dhe më 1943 hyri në radhët e PKSH. Kongresi Antifashist i Përmetit (maj 1944) e zgjodhi anëtar të Këshillit ANÇ. Pas çlirimit ka dhënë ndihmesë për krijimin e Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë dhe ka kryer gjithashtu detyra partie e shtetërore.¹⁵⁶

156. Bazuar në Akademia e Shkencave e RPSSH , Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985.



Tuk Jakova (1914-1959)

Veprimtar i lëvizjes komuniste, një ndër drejtuesit e Luftës ANÇ, funksionar i lartë i PKSH (PPSH) dhe i shtetit, Hero i Popullit. Lindi në Shkodër në një familje me origjinë nga Gjakova. Për arsye ekonomike, ndërpreu shkollën e mesme dhe punoi zdrukthtar. Antar i Grupit Komunist të Shkodrës. Në gjyqin kundër komunistëve në shkurt 1939 u dënua me burgim. U arratis nga burgu pas agresionit fashist të 7 prillit dhe u hodh në ilegalitet. Mori pjesë në mbledhjen themeluese të PKSH si përfaqësues i Grupit të Shkodrës dhe u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror Provizor. Në Konferencën e Parë të vendit të PKSH (1943) u zgjodh anëtar i KQ, Komisar Politik i Brigadës së I Sulmuese; Komisar Politik i Divizionit të I Sulmues. Në Kongresin e I Antifashist Nacionalçlirimtar (Përmet, Maj 1944) u zgjodh anëtar i Këshillit ANÇ dhe iu dha grada kolonel.

Në nëntor 1944 u emërua komisar i Korparmatës III. President i Sindikatave të Punëtorëve dhe Nëpunësve të Shqipërisë. Kryesoi delegacionin e parë shqiptar në sesionin e OKB-së (qershor 1946), më pas u emërua ambasador i RPSH në RF të Jugosllavisë (1946-1948). Në Kongresin e I të PKS (1948) u zgjodh anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ. Gjeneralmajor në korrik 1949; ministër i Financave dhe zv.kryeministër (1950-1955). Deputet që nga viti 1945 dhe kryetar i Asamblesë Kushtetuese të Kuvendit Popullor (1946-1950). Për shkak të qëndrimeve të kundërta me udhëheqjen e PPSH-së, në Plenumin e KQ më 17 qershor 1955 u përjashtua nga KQ dhe Partia dhe u shkarkua nga të gjitha detyrat shtetërore. Në vitin 1956 u arrestua dhe u dënua me 20 vite burg. Vdiq në spitalin e burgut të Tiranës pas një ndërhyrjeje kirurgjikale.¹⁵⁷ Si një politikan i kalibrit të lartë, por edhe si pasojë e përvojës së tij që para lufte më lëvizjen sindikale, Tuk Jakova ndihmoi shumë që lëvizja sindikaliste në Shqipëri të zhvillohej më tej. Prej atëherë e në vazhdimësi, Bashkimin e Sindikatave, i cili më vonë u quajt Bashkimet Profesionale të Shqipërisë e drejtuan personalitete të profilit të lartë politik.

157. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vëllimi II, Tiranë 2008, fq.1060.



Pilo Peristeri (1909- 2009)

Veprimtar i lëvizjes komuniste dhe veteran i lëvizjes punëtore shqiptare. Lindi më 10.12.1909 në Korçë në një familje punëtorësh. Anëtar aktiv i Grupit Komunist të Korçës (1932), një nga themeluesit e shoqërisë «Puna» (1934) dhe drejtues i saj. Mori pjesë në mbledhjen e grupeve komuniste që në themelimin e PKSH (1941). Anëtar i PKSH me themelimin e saj. Gjatë Luftës ANÇ zhvilloi aktivitet të gjerë në terren dhe në reparte partizane, komisar politik i çetës së Mokrës (1942). Nënkryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Ka qenë në krye të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë në vitet 1952-1958. Gjatë këtyre viteve lëvizja sindikaliste shqiptare u shndërrua në një lëvizje këshillash punëtorësh sipas parimit leninist dhe në një levë të PPSH-së¹⁵⁸

158. Bazuar në Akademia e Shkencave e RPSSH , Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985.



Gogo Nushi (1913-1970)

Veprimtar i lëvizjes komuniste dhe sindikaliste në Francë, një nga drejtuesit e PKSH dhe të Luftës ANÇ. Lindi në Vuno të Himarës. Në moshën 14 vjeç emigroi në Francë, ku punoi 12 vjet si punëtor dhe u përfshi në lëvizje revolucionare e sindikaliste. Më 1935 u pranua anëtar i Partisë Komuniste Franceze. U kthye në Shqipëri në vitin 1940 për të marrë pjesë në luftë për çlirimin e vendit. Anëtar i PKSh menjëherë pas krijimit të saj. Gjatë Luftës ANÇ u zgjodh Sekretar Politik i Komitetit Qarkor të PKSH-së për Tiranën. Pas çlirimit kreu detyra të rëndësishme në organet udhëheqëse të PPSH: Ministër i Industrisë dhe Minierave (1948), sekretar i KQ të PPSH (1952-1956), zv. Kryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH (1956-1958) dhe President i Këshillit të Përgjithshëm të BPSH (1958-1970).¹⁵⁹

159. Akademia e shkencave e Shqipërisë, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vëllimi III, fq. 1858.



Xhafo Poshi (1885-1953)

Xhafo Poshi lindi në Gjirokastrë më 1885 në një familje patriotike dhe arsimdashëse, (i ati, Mustafai, me të vëllanë, Naimin, kishin mbaruar studimet për mjekësi në Stamboll). Mësimet e para dhe Shkollën Qytetëse (Ruzhdie Turke) i mbaroi në qytetin e lindjes rreth viteve 1913-1914. (në këto vite mban lidhje me Çerçiz Topullin dhe çetën e tij dhe bëhet një nga aktivistët e tij më të besuar). Në vitin 1916 vijoi studimet në shkollën Zosimea të Janinës, por për arsye familjare dhe ekonomike nuk mundi t'i mbarojë deri në fund dhe kthehet në Gjirokastrë, ndërsa rreth vitit 1917, në lidhje me Fanolistët në Boston emigron në SHBA. Aktivizohet në shoqërinë Vatra dhe bandën muzikore të saj dhe merr pjesë në veprimtaritë e kësaj bande në tetor të 1920 në Vlorë. Nuk kthehet me në Amerikë dhe zhvillon veprimtari patriotike në Gjirokastrë

si anëtar i shoqërisë “Liria” e më vonë asaj “Drita”. Shtatori i vitit 1921 e gjen mësonjë në shkollën plotore (5 klasë) “Drita” dhe më vonë drejtor i saj. Në këtë vit, në korrik zgjidhet kreu i “Lidhjes së Mësuesve të Gjirokastrës”, organizmi i parë sindikal në Shqipëri në fushën e arsimit. Bashkëpunon me Jani Mingën, Dine Qadhimin dhe të tjerë patriotë për lëvizjen teatrore në qytet duke qenë në role dhe regjisor për pjesët “Vdekja e Pirros”, “Fe e kombësi”, “Lulja e kujtimit”, “Besa”, etj. Drama Besa e vënë në skenë në vitet 1928-30, së pari në Gjirokastrë e më pas në Përmet, Delvinë e Sarandë luajti rol edukativ në popull. Xhafo Poshi ka marrë pjesë në shumë konferenca kombëtare e mbledhje për problemet e arsimit dhe shkollës. Ka qenë instruktor në kursin për mësonjësi i çelur rreth viteve 1924-1925 në fshatin Labovë të Gjirokastrës dhe ka përkthyer nga turqishtja libra pedagogjike, të cilat mbetën dorëshkrime që më pas u dogjën bashkë me shtëpinë në gusht të 1944. Në veçanti ai kishte korespondencë të vijueshme me Aleksandër Xhuvanin, Beqir Sinanin, Lef Nosin, At Gjergj Fishtë, Faik Konicën, Avni Rustemin, etj. Në vitin shkollor 1931 Xhafua u transferua nga Gjirokastra në Libohovë ku punoi 2 vjet dhe nga viti 1933 u kthye përsëri në Gjirokastrë, ku vijoi punën e tij si mësues deri në vitin shkollor 1943-1944. Në gusht të 1944, forcat gjermane i dogjën shtëpinë në Gjirokastrë me gjithë bibliotekën e tij të pasur, ku ai bashkë me Myrtezanë, vëllain e madh, ishin strehuar në Kala. Kur panë që ajo po digjej, prej asaj dite u detyruan të shpërngulet familjarisht në Vlorë. Në Vlorë në fillim të vitit 1945 filloi punë si mësues në shkollën “Naim Frashëri të qytetit dhe në vitin shkollor 1946-1947 u transferua në fshatin Bishan, më pas dhe në shkollë të tjera të fshatrave Armen, Picar e Lubonjë deri në mars të vitit 1953, vit në të cilin mbylli sytë përgjithmonë.¹⁶⁰

160. Xhafo Poshi nga Dunavati që Kishte Korespondencë me Aleksandër Xhuvanin, Beqir Sinanin, Lef Nosin, At Gjergj Fishtë, Faik Konicën, Avni Rustemin etj, vizituar 14.06.2022 në <https://gjirokastraonline.com/personazh/xhafo-poshi-nga-dunavati-qe-kishte-korespondence-aleksander-xhuvanin-beqir-sinanin-lef-nosin-gjergj-fishten-faik-konicen-avni-rustemin-etj/>.



Kol Mjeda (1895-1951)

Kol Mjeda ka lindur në Shkodër më 4 dhjetor 1895. Mbaroi në Shkodër shkollën fillore, ndërsa shkollën e mesme teknike e kryen në Drezden të Gjermanisë, ku më pas mbaron edhe shkollën teknike superiore në Stilistikë (Moda e veshjeve për burra). Ndonëse larg atdheut, mban lidhje rregullisht me familjen, të afërmit dhe shokët e tij, pa përjashtuar edhe miq, të rinj e të huaj. Me kthimin në Shqipëri, Kol Mjeda fillon të ushtrojë profesionin e stilistit në zëjen e rrobaqepësisë, duke hapur një sallon mode për burra, ku qepeshin me nivel stilistik të lartë veshje për burra: “Bonjeure”, “Rontigeau”, fraqe të modës së fundit, etj. Kol Mjeda arriti ta zmadhojë aktivitetin e tij me një punëtori të madhe për atë periudhë, deri në 60-80 punëtorë. Duke qenë i diplomuar në

Gjermani në këtë fushë, si dhe duke shfrytëzuar referencat nga Drezdeni, Kola arriti që nga Shkodra, të lidhë kontrata pune me sipërmarrës austriakë për qepjen e veshjeve me porosi të klientelës së huaj.

Në vitin 1920 Kolë Mjeda zgjidhet kryetari i “Shoqëria ndihmëtare e punëtorisë” në Shkodër, harton statutin e saj sipas rregullave perëndimore dhe demokratike. Kjo shoqëri krijoi bordin e saj, me nënkryetarin dhe dy sekretarë, llogaritarin dhe mjekun. Kjo shoqatë u vinte në ndihmë anëtarëve të saj në raste hidhërimesh (vdekje) e gëzimesh (martesa); në raste sëmundjesh, e deri në kriza falimentimi apo në rast fatkeqësie, si zjarr e përmytje. Aktiviteti i kësaj shoqërie, me ndërprerje të vogla, sipas kushteve politiko-shoqërore, vazhdoi deri me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste në vitin 1939. Për të sensibilizuar opinionin publik, aktiviteti i kësaj shoqërie është pasqyruar edhe në shtypin e kohës. Kol Mjeda ka qenë një nga themeluesit kryesorë të Lëvizjes Sindikaliste të Shkodrës dhe, në periudha të ndryshme ka qenë edhe sekretar, nënkryetar dhe kryetar i kësaj shoqërie. Ai është iniciatori i veprimeve dhe aktiviteteve dobiprurëse, sikurse është rasti i krijimit të Shoqërisë Artistike Muzikore “Rozafa”. Kol Mjeda, qysh në vitin 1924, filloi t’i përkushtohet edhe politikës dhe të merret edhe me qeverisjen e shtetit shqiptar, në detyra të ndryshme. Në fillim ai kreu funksionin e Kryetarit të Bashkisë së Shkodrës. Për disa legjislatura ai ka qenë deputet i Shkodrës dhe arrin të zgjidhet deri zv/president i Asamblesë Kombëtare. Vdiq në Burgun e Burrelit, më 24 prill 1951, i akuzuar si “Armik i popullit”. Familja e tij u persekutua për gjysmë shekulli nga diktatura komuniste dhe, as sot e kësaj dite, nuk ka mundur të gjejë eshtrat e babait atdhetar.¹⁶¹

161. Doc Dr Zyhdi Zekja dhe Namik Kruja. Historia e shkodranit të njohur që vdiq në burgun e Burrelit. vizituar site-in në 28 qershor 2022. vizituar në 14.6.2022 në <https://memorie.al/i-diplomuar-ne-gjermani-ai-ishte-sindikalist-muzikant-publicist-poliglot-politikan-deputet-prefekt-dhe-historia-e-shkodranit-te-njo->



Miha Lako (1901-1985)

Militant komunist, veteran dhe figurë e shquar e lëvizjes punëtore e komuniste shqiptare. Lindi më 1.6.1901 në fshatin Hoçisht të rrethit të Korçës. Punoi si këpucar qysh në moshë të vogël e deri më 1940 në Korçë. Përqafoi që në rini idetë komuniste dhe u hodh në veprimtari revolucionare. Më 1928 së bashku me punëtorë të tjerë revolucionarë organizoi celulën e parë komuniste në Korçë. Mbledhja e përfaqësuesve të celulave komuniste (1929) e zgjodhi kryetar të komitetit drejtues të Grupit Komunist të Korçës. U shqua për punë të palodhur midis punëtorëve, zanatçinjve dhe shtresave të varfra. Anëtar i PKSHE që në themelimin e saj. Gjatë

Luftës ANÇ punoi me të gjitha forcat për organizimin e fitoren e saj. Mori pjesë në Kongresin e I Antifashist të Përmetit (1944), i cili e zgjodhi anëtar të KANÇ. Pas Çlirimit është ngarkuar me detyra të rëndësishme partie e shtetërore, si dhe me organizimin e Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë.



Petro Papi (1911-1967)

Militant komunist, veteran i lëvizjes punëtores komuniste shqiptare. Lindi në Korçë më 15.5.1911. Anëtar i Grupit Komunist të Korçës (1933), u zgjodh kryetar i shoqërisë «Puna» të rrobaqepësve (1934). Për veprimtari antizogiste e revolucionare dhe për pjesëmarrje në organizimin e Demonstratës së Bukës (1936) u arrestua e u internua nga regjimi i Zogut. U zgjodh anëtar i Komitetit Qarkor të Partisë

për Korçën (1941). Mori pjesë aktive në Luftën NÇ, u dallua si kuadër i aftë e i vendosur në detyrën si zëvendëskomisar i Brigadës IV S (1944) dhe anëtar i Shtabit të Korparmatës së II NÇ (1944). Pas Çlirimit ka kryer detyra të rëndësishme partie dhe shteti, duke dhënë ndihmesë për organizimin e Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë.¹⁶²

*Fotot në këtë botim janë marrë nga A.Q.SH dhe Fjalori
Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985.*

162. Bazuar në Akademia e Shkencave e RPSSH , Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985.

Bibliografi:

- Ana Lalaj, *Dosjet e luftës*, Tiranë: Botimet “Toena”, 2014.
- Ana Lalaj, *Pranverë e rrejshme e 56’*, Tiranë: Infobotues, 2015.
- Akademia e Shkencave e RPSSH. Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 2009.
- Arlind Qorri, “Vendi i sindikalizmit në lëvizjet punëtore dhe format kryesore të lëvizjeve sindikale”. Teza 11, 22 Mars 2013, vizituar site-in në 25 maj 2022. <https://teza11.org/vendi-sindikalizmit-ne-levizjet-punetore-dhe-format-kryesore-te-levizjeve-sindikale/>
- AQ i RPSH Fondi i M. Punëve të Brendshme. Qarkore Nr. 1143, dt. 21.2.1940.
- AQ i RPSH. Fondi i M. Ekonomisë. Raport i Odës së tregëtisë së Durrësit, dt. 12.12.1939
- AQ i RPSH. Fondi i Ministrisë së Ekonomisë. Raport i Odës së tregëtisë në Elbasan, dt. 8.2.1940.
- AQSH, Dëftesë, Shoqërisë Robaqepësvet, 8/XI/1927.
- AQSH, Nga historia e lëvizjes të punëtorisë s’onë...
- AQSH, Statuti i Shoqërisë së robaqepësve, qyteti Korçë.
- AQSh, Statuti i Shoqërisë “Puna” – Kuçovë.
- Anelmo Spahija “Në fillimet e lëvizjes sindikaliste shqiptare. ”. Teza 11, 3 shtator 2016, vizituar site-in në 25 maj 2022. <https://teza11.org/ne-fillimet-e-levizjes-sindikaliste-shqiptare/>.
- Artan R. Hoxha. “Tharja e kënetës së Maliqit dhe ndërtimi i regjimit komunist në periferi të Shqipërisë”, Onufri, Tiranë, 2021.
- Barbara Jelavich, *Historia e Ballkanit*, Përpjekja, Tiranë, 1999.
- Buchmueller, Th. C., J. DiNardo., & Valetta, R.G. (2002). Union Effects on Health Insurance Provision and Coverage in the United States. Sage Journals, 55, 4.
- Dorian Koçi. *Patrioti liberal Veli Hashorva dhe Gazeta “Drita” e Gjirokastrës 1920-1924*, Gazeta Dita, viti 2020.
- Dorian Koçi, *Jeta e një ish-anëtari të Grupit Komunist të të Rinjve nën regjimin totalitar*, në “E majta – Mendimi politik/

profile biografike”, Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë, 2020.

E majta – Mendimi politik/ profile biografike, Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë, 2020.

E. Mëhilli, “From Stalin to Mao”, Ithaca, 2017.

Enis Sulstarova, “Nga Magnitogorski në Maliq: Shënime për ‘qytetërimin stalinist’”, Revista “Shenja”, korrik 2022.

Fletorja Zyrtare Nr. 67. dt. 16.10.1940.

Galeazzo Çiano di Cortellazo, *Misioni historik i Shqipërisë së Madhe*, Botime “Distapur”, Tiranë 1942.

Gazeta “Drita”-Sofje, Nr 90, dt 15.06.1907.

Gazeta “Shpresa e Shqypnisë”-nr 41, nëntor 1905; Kristaq Misha. *Lëvizja punëtore në Shqipëri*. Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1971.

Gazeta “Puna”, dt. 30.04.1957.

Gazeta “Zëri i Popullit”, Nr. 82 datë 6 prill 1958.

Illir Kalemaj, *Hyrje në “E majta – Mendimi politik/ profile biografike”*, Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë 2020
J. W. Budd. *Employment with a Human Face: Balancing Efficiency, Equity, and Voice*, Cornell University Press. 2004.

Kastriot Dervishi. *Lëvizja komuniste në vitet 1924-1944 dhe formimi i PKSH-së*. Tiranë, 2016, Shëpia Botuese 55.

Klodian Gega, *Studim – Perceptimi i publikut dhe i sindikalistëve mbi performancën e sindikatave në Shqipëri*, Qendra për shërbime dhe Praktika Ligjore të Integruara – Fondacioni Friedrich Ebert, 2018

Komunikatë e Plenumit të IX të KQ të PPSH, Tiranë, 1-2 Prill 1958.

Kristaq Misha, *Lëvizja punëtore në Shqipëri*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1970.

Kristo Frashëri, *Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH-së 1878 – 1941 (vështrim historik me një*

shtojcë dokumentare), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Ilar, Tiranë 2006

Kristo Frashëri, *Historia e qytetërimit shqiptar*, Akademia e Shkencave: Tiranë, 2008.

Lisen Bashkurti, *Diplomacia shqiptare në fillimet e “Luftës së Ftohtë”*, Tiranë: Geer, 2003.

Musine Kokalari, *Si lindi Partia Social-Demokrate (1972)*, Vepra II, përgatitur nga N. XH. Shehu, Tiranë: Geer, 2009.

Nikollë Loka, *Tuk Jakova – Jeta dhe vepra*, botime “Grand Prind”, Tiranë 2017.

Paskal Milo, *Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore*, Toena, Tiranë, 2014, f. 70.

Plenumi IX i KQ të PPSH, Tiranë 1-2 Prill 1958. Dokumente kryesore të PPSH, vëllimi III (1957-1961).

Sami Frashëri, Tercuman-i Shark, Istanbul 10 qershor 1294 (22 qershor 1878).

Spiro Dede, *Kundërrevolucioni në kundërrevolucion*, Shtëpia Botuese “8 nëntori”, Tiranë, 1983.

Stilian Adhami: *Kronikë e lëvizjes punëtore e sindikale në Shqipëri*, Tiranë 1969.

Shpresa e Shqypnis-Nr 9, dt. 22.5.1907.

Trakt i Këshillit administrativ të sindikatave punëtore për Korçën.

Trakt i PKSH

Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH “Mbi Punën e sindikatave”, 7 qershor 1949,

Dokumente kryesore të PPSH, -1 Vëllimi II 1949 - 1956, Botimi i dytë, Tiranë, 1972.

V. I. Lenin, Vepra, vëll. 13.

Doc Dr Zyhdë Zekja dhe Namik Kruja. Historia e shkodranit të njohur që vdiq në burgun e Burrelit. vizituar site-in në 28 qershor 2022.

<https://memorie.al/i-diplomuar-ne-gjermani-ai-ishte-sindikalist-muzikant-publicist-poliglot-politikan-deputet-prefekt-dhe-historia-e-shkodranit-te-njohur-qe-vdiq-ne-burgun-e-burrelit/>.

<https://gjirokastraonline.com/personazh/xhafo-poshi-nga-dunavati-qe-kishte-korrespondencë-aleksandër-xhuvanin-beqirsinanin-lef-nosin-gjergj-fishtën-faik-konicen-avni-rustemin-etj/>.

www.zemrashqiptare.net

www.memorie.al

www.gjirokastraonline.com

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Koçi, Dorian

Historia e sindikalizmit shqiptar : 1905-1961 / Dorian Koçi,
Marenglen Kasmi. - Tiranë : Turdiu, 2022

137f. : me foto ; 21 x 14.85cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-4691-6-8

I.Kasmi, Marenglen

1.Sindikalizmi 2.Sindikata 3.Historia 4.Shqipëri

331.105.44(496.5) "1905/1961"

ISBN 9789928469168



9 789928 469168



Prisnim
Angjellim Jeli

Prisnim e organizimit prur e nent 1927
nukje tupa segrimi i Topit

- 1 Lohi Tukesani Patogjese
- 2 Dete Camelia jorgjevici
- 3 Jozefi Camelia P. dertes
- 4 N. J. Jekovic, Krijate
- 5 Oshko Tocka, Mirovica
- 6 Ito Kadica, Kujavice
- 7 Balta Garcia, Kujavice
- 8 Gjeo Baranica, Kujavice
- 9 Sed Mirovica, Kujavice
- 10 Zefi Jeli, Kujavice (Kujavice)
- 11 Luvani Rancic, Kujavice (Kujavice)
- 12 Hil Jeli, Kujavice
- 13 Hal Jeli, Kujavice (Kujavice)
- 14 Zefi Rancic, Kujavice
- 15 Juri Jeli, Kujavice

BIROTEKA SHKOLLE
NR 2292
KUVIQA 8-IV-4

SHKOPTIAN FOTO 1942